



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 04/L-109

PËR KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE

KREU I
DISPOZITAT E PERGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është rregullimi i aktiviteteve të komunikimeve elektronike bazuar në parimin e neutralitetit teknologjik dhe kornizën rregullatore të BE-së për komunikimet elektronike, duke promovuar konkurrencën dhe infrastrukturën efikase në komunikimet elektronike, si dhe garantimin e shërbimeve të duhura e të përshtatshme në territorin e Republikës së Kosovës.

Neni 2
Fushëveprimi

Ky ligj rregullon marrëdhëniet shoqërore që kanë të bëjnë me rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike, shërbimet dhe facilitetet shoqërore, përdorimin e resurseve të komunikimeve elektronike, si dhe marrëdhënieve shoqërore që kanë të bëjnë me radio pajisjet, pajisjet fundore dhe përputhshmërinë elektromagnetike, siguron nivel të

barabartë të mbrojtjes së të drejtave për të dhënat personale, veçanërisht të drejtën e privatësisë së procesimit të të dhënave personale në sektorin e komunikimeve elektronike.

Neni 3

Parimet për rregullimin e aktiviteteve të komunikimeve elektronike

1. Rregullimi i aktiviteteve të komunikimeve elektronike duhet të bazohet në parimet e menaxhimit dhe përdorimit efektiv të burimeve të kufizuara, neutralitetit teknologjik, ekuivalencës funksionale, proporcionalitetit, rregullimit minimal të domosdoshëm, sigurisë ligjore në një treg dinamik, zhvillimit ekonomik, duke siguruar konkurrencë efektive, mbrojtje të të drejtave të konsumatorit, objektivitet të kriterëve, kushteve dhe procedurave rregullatore, transparencë dhe mosdiskriminim.

2. Parimi i neutralitetit teknologjik do të thotë që normat ligjore duhet të aplikohen duke marrë në konsideratë objektivat që duhen arritur dhe për të siguruar, në një masë të arsyeshme, që aplikimi i tyre nuk inkurajon ose diskriminon përdorimin e teknologjive të veçanta, si dhe duke siguruar që normat juridike zbatohen, për aq sa është e mundur, pa marrë parasysh teknologjitë e përdorura në ofrimin e shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike të lidhura me një marrëdhënie të veçantë ligjore.

3. Parimi i ekuivalencës funksionale do të thotë që aplikimi i normave ligjore duhet të jetë sa më i njëtrajtshëm që të jetë e mundur për të gjitha rrjetet e komunikimeve elektronike ose shërbimet me funksione të ngjashme.

4. Kur aplikohen normat ligjore që rregullojnë aktivitetet e komunikimeve elektronike, duhet të merren në konsideratë parimet përkatëse të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni. Këto parime duhet të harmonizohen pa u dhënë përparësi ndonjëres prej tyre dhe ato duhet të zbatohen për arritjen e qëllimit dhe objektivave të përcaktuara në nenin 1 të këtij ligji.

Neni 4

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:

1.1. **Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare** – (më poshtë Autoriteti) është organi rregullator, i cili zbaton dhe mbikëqyrë kornizën rregullatore të përcaktuar nga ky ligj, nga ligji për shërbimet postare, si dhe nga politikat e zhvillimit të fushës së komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, të përcaktuara nga Qeveria, bazuar në dispozitat e paragrafit 1 të nenit 6 të këtij ligji dhe paragrafit 1 të nenit 7 të këtij ligji;

1.2. **Autorizim i përgjithshëm** – akt i natyrës së përgjithshme, që përbëhet nga korniza ligjore, e përcaktuar nga ky ligj dhe rregullat e nxjerra nga Autoriteti, në zbatim të tij, për të siguruar të drejtat për ofrimin e rrjeteve ose të shërbimeve të komunikimeve elektronike, duke vendosur edhe detyrimet specifike, të cilat mund të zbatohen ndaj të gjitha ose ndaj disa prej rrjeteve dhe/ose shërbimeve specifike të komunikimeve elektronike;

1.3. **Facilitete shoqëruese** – shërbime të lidhura, infrastruktura fizike dhe objektet tjera ose elementet që lidhen me një rrjet dhe/ose me një shërbim të komunikimeve elektronike të cilat mundësojnë dhe/ose mbështesin ofrimin e shërbimeve nëpërmjet këtij rrjeti dhe/ose shërbimi ose që kanë potencialin për ta bërë këtë dhe përfshijnë, ndër të tjera, edhe ndërtesat apo hyrjen në ndërtesa, kabllot e ndërtesave, antenat, kullat dhe konstruksionet tjera mbështetëse, kanalet, përçuesit, shtyllat, pusetat, dhe kabinetet;

1.4. **Identifikimi i linjës së thirrur** – funksioni që i mundëson të thirrurit të identifikojë pikën fundore të rrjetit ku terminohet thirrja, bazuar në numrin ose kodin që i është caktuar kësaj pike fundore të rrjetit;

1.5. **Integriteti i Rrjetit** – i referohet aftësisë së sistemeve të ndërlidhura për të ruajtur dhe mbajtur në masë optimale gjendjen e tyre të punës dhe të të mbeturit të pandikuar nga interkoneksionet me rrjetet e tjera. Sigurimi i integritetit të rrjetit (QoS – kualiteti i shërbimit, obligimet e konfidencialitetit dhe besueshmërisë). P.sh. integriteti i të dhënave (të dhënat janë pikërisht ato që janë dërguar: asgjë e shtuar, asgjë e ndryshuar, asgjë e fshirë);

1.6. **Interferencë e dëmshme** – ndërhyrja, e cila rrezikon funksionimin e shërbimit të radionavigimit, ose shërbimeve të tjera të sigurisë, ose të cilat në forma të ndryshme seriozisht përkeqësojnë, pengojnë ose ndërprejnë, në mënyrë të përsëritur, shërbimet e radiokomunikimeve, funksionojnë me këtë ligj dhe aktet tjera nënligjore;

1.7. **Interkoneksioni** – lidhja fizike dhe logjike e rrjeteve publike të komunikimit, të cilat përdoren nga i njëjti apo nga ndërmarrës të ndryshëm, në mënyrë që t'i lejojë përdoruesit e një ndërmarrësi të komunikojnë me përdoruesit e të njëjtit ose të një ndërmarrësi tjetër, ose të lejojë qasjen për shërbimet e ofruara nga një ndërmarrës tjetër. Interkoneksioni është një lloj i veçantë i qasjes, që zbatohet ndërmjet operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit;

1.8. **Komunikimi** – shkëmbimi ose bartja e çfarëdo informacioni ndërmjet një numri të caktuar pjesëmarrësish përmes një shërbimi të komunikimeve elektronike në dispozicion të publikut. Kjo nuk përfshin asnjë informacion që bartet si pjesë e shërbimeve transmetuese radio-televizive nëpërmjet një rrjeti të komunikimeve elektronike, përveç në rastin kur informacioni mund të jetë i lidhur me një parapagues ose shfrytëzues të identifikueshëm, i cili merr këtë informacion;

1.9. **Linja me qira** – linjë e pakomutuar e komunikimeve elektronike që lidhë pikat terminuese të një rrjeti të komunikimeve elektronike;

1.10. **Ministria** – ministria përgjegjëse për sektorin e komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve postare;

1.11. **Ndërmarrës** – çdo person fizik dhe/ose juridik, ose një grup personash të bashkuar në bazë të kontrollit apo të varësisë, të cilët janë të përfshirë në një veprimtari të komunikimeve elektronike në Republikën e Kosovës ose veprimet e të cilave, nëse realizohen, kanë qëllim ose mund të kenë ndikim në aktivitetin ekonomik në Republikën e Kosovës;

1.12. **Numër** – seri alfa-numerike emër ose adresë e përcaktuar në planin e numeracionit, që shërben për adresim në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike;

1.13. **Numërat gjeografik** – numra nga plani kombëtar i numeracionit telefonik ku një pjesë nga përbërja e shifrave të saj përmban domethënien gjeografike që përdoret për rutinimin e thirrjeve drejt vendndodhjes fizike të pikës fundore të rrjetit;

1.14. **Numër jogjeografik** – numri nga plani kombëtar i numeracionit telefonik që nuk janë numërgjeografik. Ata përfshijnë, ndër të tjera, numrat mobilë, të hapur dhe të kategorisë së 'numrave premium;

1.15. **Ofruesi i shërbimit universal** – ndërmarrësi që ofron shërbimin universal;

1.16. **Operator** – ndërmarrës që ofron, ose që është i autorizuar të ofrojë një rrjet të komunikimeve elektronike ose faciliteteve shoqëruese;

1.17. **Pajisje fundore** – pajisja, ose pjesë relevante e saj, në gjendje që të marrë dhe/ose dërgojë informacion dhe e menduar që të jetë e lidhur në çfarëdo mënyre dhe për çfarëdo rrjeti publik të komunikimeve;

1.18. **Parapagues** – cilido person fizik ose person juridik që ka lidhur një kontratë me një ndërmarrës që ofron shërbime të komunikimeve elektronike, të disponueshme për publikun, për përfitimin e shërbimeve të ofruara;

1.19. **Pika fundore e rrjetit** – pika fizike, në të cilën një parapagues ka qasje në rrjetin e komunikimeve publike. Në rastin e rrjeteve, që përfshijnë komutimin ose rutinimin pika fundore e rrjetit identifikohet si një adresë specifike e rrjetit, e cila mund të lidhet me numrin ose emrin e një parapaguesi;

1.20. **Plani kombëtar i numeracionit** – struktura e numrave dhe e serive të numrave, emrave ose adresave si dhe përcaktimi i tyre për sigurimin e qasjes në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike publike;

1.21. **Plani kombëtar i Radio-frekuencave** – dokument që përcakton brezet frekuencore për shërbime të ndryshme dhe vendos kushtet bazë për ndarjen dhe dhënien e frekuencave, me qëllim të përdorimit efektiv të spektrit të radio frekuencave dhe shmangien e interferencave;

1.22. **Postë elektronike** – çdo mesazh në formë të tekstit, tingullit apo imazhit, i dërguar nëpërmjet rrjetit publik të komunikimeve, i cili mund të ruhet në rrjet ose në pajisjen fundore të marrësit derisa atë ta marrë ai;

1.23. **Qarku lokal** – qarku fizik që lidhë një fundore të rrjetit me kutinë shpërndarëse, ose me pajisjen ekuivalente në rrjetin publik fiks të komunikimeve elektronike;

1.24. **Qasje** – bërja e disponueshme e faciliteteve dhe/ose shërbimeve të një ndërmarrësi tjetër, sipas kushteve të përcaktuara, në baza ekskluzive ose joekskluzive,

për sigurimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, përfshirë këtu edhe ofrimin e shërbimeve të shoqërisë së informacionit, ose shërbimeve të transmetimit të përmbajtjes. Qasja, ndër të tjera, përfshinë qasje në elementet e rrjetit dhe faciliteteve shoqëruese, të cilat mund të përfshijnë lidhjen e pajisjeve në mënyrë fikse ose jofikse (në veçanti kjo përfshin qasje të hapur në rrjetin lokal dhe qasje në facilitetet dhe shërbimet e nevojshme, për të ofruar dhe mundësuar shërbimet e bazuara në rrjetin lokal); qasje në infrastrukturën fizike, përfshirë ndërtesat, tubacionet dhe kullat; qasje në sistemet e softuerëve përkatëse, përfshirë sistemet mbështetëse operationale; qasje në sistemet e informacionit, apo bazave të të dhënave për qëllime të administrimit, kyçjes, bërjes së kërkesave për riparim dhe mirëmbajtje dhe të faturimit; qasje në përkthimin e numrit apo në sistemet që ofrojnë funksion të njëjtë; qasjen në rrjetet fikse apo mobile, në veçanti për roaming-un; qasje në sistemet me qasje të kushtëzuar për shërbimet e televizionit digjital dhe qasjen në shërbimet e rrjeteve virtuale;

1.25. **Radio interferencë** – degradimi i performancës së pajisjeve dhe/ose mjeteve, radio-komunikimeve, ose radio-sistemeve për shkak të radio-çrregullimeve;

1.26. **Resurse të komunikimeve elektronike** – radio-frekuencat (kanalet), numrat telefonikë dhe identifikuesit tjerë të rrjeteve të komunikimeve elektronike, të tilla si shenjat e radio-thirrjeve, resurset orbitale, duke përfshirë edhe pozitën në një orbitë gjeostacionare dhe burimet tjera të nevojshme për kryerjen e aktiviteteve të komunikimeve elektronike, për përdorimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike, ose radio-pajisjeve, apo pajisjeve fundore dhe për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike;

1.27. **Rrjet i komunikimeve elektronike** – sistemi i transmetimit dhe, nëse ekzistojnë, pajisjet e komutimit ose rutinimit dhe resurset tjera, duke përfshirë elementete rrjetit që nuk janë aktive, të cilat lejojnë përcjelljen e sinjaleve nëpërmjet përcjellësve, radios, mjeteve optike ose mjeteve të tjera elektromagnetike, duke përfshirë rrjetet satelitore, rrjetet fikse (me komutim të qarqeve ose me komutim të paketave, përfshirë internetin), rrjetet mobile tokësore, sistemet e kabllave elektrike në raste kur ato përdoren për transmetimin e sinjaleve, rrjetet e përdorura për transmetimet radiotelevizive dhe të televizionit kabllor, pavarësisht nga tipi i informacionit të bartur;

1.28. **Rrjet i komunikimeve publike** – një rrjet i komunikimeve elektronike që përdoret, tërësisht ose pjesërisht, për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, të disponueshme për publikun, të cilat përkrahin transferimin e informacionit në mes të pikave fundore të rrjetit;

1.29. **Rrjeti publik fiks** – rrjeti, në të cilin pikat fundore janë të vendosura në vende të fiksuara;

1.30. **Rrjet publik i komunikimeve mobile** – rrjeti në të cilin pikat fundore nuk janë të vendosura në vende të fiksuara;

1.31. **Spektri i radio-frekuencave** – përfshin valët elektromagnetike në diapazonin e frekuencave 9 KHz deri 3000 GHz, të cilat përhapen në hapësirë pa nevojën e linjave të veçanta;

1.32. **Shërbim i komunikimeve elektronike** – shërbimi që zakonisht ofrohet me pagesë, i cili përftohet, tërësisht ose pjesërisht, nga përcjellja e sinjaleve përmes rrjeteve të komunikimeve elektronike, që përfshin shërbimet e telekomunikacioneve dhe shërbimet e transmetimit në rrjetet e përdorura për transmetime radiotelevizive dhe në rrjetet e televizionit kabllor, por duke përjashtuar shërbimet, të cilat ofrojnë përmbajtje nëpërmjet rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, ose që ushtrojnë kontroll redaksional ndaj përmbajtjes së ofruar për transmetimin, duke përdorur rrjetet ose shërbimet e komunikimeve elektronike. Ai nuk përfshin shërbimet e shoqërisë së informacionit, të cilat nuk përbëhen, tërësisht ose pjesërisht, nga përcjellja e sinjaleve në rrjetet e komunikimeve elektronike;

1.33. **Shërbim me vlerë të shtuar** – është, për aq sa ka të bëjë me përpunimin e të dhënave personale dhe mbrojtjen e privatësisë, çdo shërbim që kërkon përpunimin e të dhënave për trafikun ose të dhënave për vendndodhjen e të tjera nga të dhënat për trafikun përtej asaj që është e nevojshme për transmetimin e një komunikimi ose faturimit të tij;

1.34. **Shërbim telefonik i disponueshëm për publikun** – shërbim i disponueshëm për publikun për gjenerimin dhe marrjen e thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtare dhe qasjen në shërbimet e emergjencës nëpërmjet një numri nga plani i numeracionit telefonik. Ky shërbim mund të përfshijë ofrimin e një, ose më shumë shërbimeve si më poshtë:

1.34.1. shërbimin e operatorit;

1.34.2. rubrikën e shërbimeve të kërkimit të informacionit, numërorin telefonik;

1.34.3. ofrimin e telefonave publikë me pagesë;

1.34.4. shërbimet në kushte të veçanta, sipas nenit 75 të këtij ligji;

1.34.5. ofrimin e pajisjeve fundore të veçanta të telekomunikacioneve për konsumatorë me aftësi të kufizuara, ose nevoja sociale të veçanta;

1.34.6. qasjen në shërbimet me numra jodgeografikë.

1.35. **Shërbime shoqëruese** – shërbime që lidhen me një rrjet të komunikimeve elektronike dhe/ose me një shërbim të komunikimeve elektronike, të cilat mundësojnë dhe/ose mbështesin ofrimin e shërbimeve nëpërmjet këtij rrjeti dhe/ose shërbimi, ose që ka potencialin për të bërë këtë dhe përfshijnë, ndër të tjera, edhe përkthimin e numrit apo sistemeve që ofrojnë funksion të njëjtë, sistemeve me qasje të kushtëzuar dhe të udhëzuesve të programeve elektronike, si dhe të shërbimeve tjera të tilla si shërbimet e identitetit, vendndodhjes dhe prezencës;

1.36. **Shërbimet e radio-komunikimeve** – veprimtaritë që mbulojnë komunikimet, që përfshijnë transmetimin, emetimin dhe marrjen e sinjaleve nëpërmjet radio-valëve;

1.37. **Shërbimet e shoqërisë së informacionit** – shërbime që ofrohen përkundrejt pagesës, në distancë, nëpërmjet mjeteve elektronike dhe me kërkesë individuale të

marrësit të shërbimit. “Në distancë” nënkuptohet që shërbimi ofrohet pa qenë e nevojshme që të dyja palët të jenë të pranishme në të njëjtën kohë. “Nëpërmjet mjeteve elektronike” nënkuptohet që shërbimi dërgohet nga pika e origjinës dhe merret në destinacionin përfundimtar, nëpërmjet pajisjeve elektronike të përpunimit (duke përfshirë edhe kompresimin digjital) dhe ruajtjes së të dhënave. Dërgimi, transmetimi dhe marrja e plotë bëhen nëpërmjet kabllave, radiovalëve, mjeteve optike dhe mjeteve të tjera elektromagnetike. “Me kërkesë individuale të marrësit të shërbimit” nënkuptohet që shërbimet ofrohen nëpërmjet transmetimit të të dhënave me kërkesën individuale të marrësit. Shërbimet e shoqërisë së informacionit përfshijnë, në veçanti, shitjen e mallrave dhe të shërbimeve, shërbimet e qasjes në informacionet apo reklamat në internet dhe qasjes në shërbimet e rrjeteve publike të komunikimit, në transmetimin e të dhënave ose ruajtjen e të dhënave të marrësit në rrjetin publik të komunikimeve;

1.38. **Shërbimi universal** – një minimum i përcaktuar shërbimesh, të një cilësie të caktuar, i mundshëm për të gjithë shfrytëzuesit në territorin e Republikës së Kosovës, pavarësisht nga vendndodhja gjeografike, me çmime të përballeshme;

1.39. **Shfrytëzues** – cilido person fizik ose person juridik që shfrytëzon ose kërkon të shfrytëzoj shërbime të komunikimeve elektronike, të disponueshme për publikun;

1.40. **Shfrytëzues fundor** – shfrytëzuesi, i cili nuk ofron rrjete dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike publike, të disponueshme për publikun;

1.41. **Telefon publik me pagesë** – telefoni i disponueshëm për publikun, shfrytëzimi i të cilit paguhet me mjete, si monedha dhe/ose kartë krediti, debiti dhe/ose karta të parapaguara, përfshirë dhe kartat me kod qasjeje;

1.42. **Të dhënat për trafikun** – ato të dhëna të përpunuara me qëllim të transmetimit të komunikimit në një rrjet të komunikimeve elektronike, ose për faturimin e tij;

1.43. **Të dhënat për vendndodhjen** – ato të dhëna të përpunuara në një rrjet të komunikimeve elektronike, që tregojnë pozicionin gjeografik të pajisjes fundore të një shfrytëzuesi të shërbimit të komunikimeve elektronike të disponueshëm për publikun;

1.44. **Transmetim radioteleviziv** – shërbimi i transmetimit të programeve të radios dhe televizionit nëpërmjet një antene tokësore, rrjeti të komunikimeve elektronike ose satelitore, në formë të koduar ose jo, për t’u marrë nga publiku;

1.45. **Thirrje** – lidhja e vendosur përmes një shërbimi të komunikimeve elektronike në dispozicion të publikut që mundëson komunikimin e dyanshëm me zë.

1.46. **Person** – cilindo person fizik, juridik apo publik, duke përfshirë këtu edhe korporata, partneritete, truste, organizata të painkuadruara, ofrues të shërbimeve, Qeverinë apo çfarëdo institucioni që ka të bëjë me të.

1.47. **Thirrjet në Shërbime të Emergjencës** – thirrjet në institucione që ofrojnë shërbime të emergjencës.

KREU II

ORGANET KOMPETENTE NË FUSHËN E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE KOMPETENCAT E TYRE

Neni 5

Organet kompetente në fushën e komunikimeve elektronike

1. Organet kompetente në fushën e komunikimeve elektronike janë Ministria dhe Autoriteti.
2. Qeveria miraton politikat dhe strategjitë kombëtare për aktivitetet në fushën e komunikimeve elektronike në Republikën e Kosovës, të hartuar sipas nenit 7 paragrafi 1 të këtij ligji.
3. Komunikimet elektronike të përdorura për qëllime të mbrojtjes kombëtare, sigurisë kombëtare, ruajtjes së rendit publik, ruajtjes së kufirit shtetëror, sigurisë së trafikut hekurudhor dhe të aviacionit civil, si dhe sigurimit të funksionimit të qëndrueshëm dhe të besueshëm në sistemin e energjisë, do të rregullohen nga institucionet përkatëse shtetërore brenda fushës së tyre të përgjegjësi. Puna e këtyre institucioneve do të koordinohet nga institucioni kompetent shtetëror.

Neni 6

Përgjegjësitë e Qeverisë në fushën e komunikimeve elektronike

1. Për qëllim të formulimit të politikave dhe të strategjive kombëtare në fushën e komunikimeve elektronike, Qeveria do t'i vendosë objektivat politike dhe strategjike për sigurimin e zhvillimit ekonomik dhe konkurrencës në sektorin e komunikimeve elektronike.
2. Qeveria miraton:
 - 2.1. planin Kombëtar të Radio-Frekuencave dhe i propozon Kuvendit për aprovim;
 - 2.2. politikat dhe strategjitë kombëtare në sektorin e komunikimeve elektronike.

Neni 7

Kompetencat e Ministrisë në fushën e komunikimeve elektronike

1. Ministria ka këto kompetenca:
 - 1.1. harton dhe paraqet në Qeveri propozimet për politikat dhe strategjitë kombëtare për sektorin e komunikimeve elektronike, duke u mbështetur në objektivat e paraqitura në nenin 1 të këtij ligji;
 - 1.2. koordinon dhe mbikëqyrë zbatimin e politikave dhe strategjive kombëtare të Qeverisë në sektorin e komunikimeve elektronike;

1.3. koordinon dhe mbikëqyrë zhvillimin e programeve të investimeve shtetërore në fushën e komunikimeve elektronike, bën vlerësime ekonomike, financiare dhe teknike të programeve të tilla dhe ushtron kontroll mbi zbatimin e tyre;

1.4. harton dhe miraton aktet nënligjore të përcaktuara më këtë ligj, veçanërisht për zhvillimin e sektorit të komunikimeve elektronike.

1.5. përfaqëson Republikën e Kosovës në organizatat ndërkombëtare dhe institucionet në fushën e hartimit të politikave dhe strategjive për komunikime elektronike brenda fushës së saj të përgjegjësisë;

1.6. harton dhe nënshkruan marrëveshje ndërkombëtare dypalëshe dhe shumëpalëshe në fushën e komunikimeve elektronike në emër të Republikës së Kosovës, brenda fushëveprimit të kompetencave të saj;

1.7. koordinon zbatimin e detyrimeve për fushën e komunikimeve elektronike, që rrjedhin nga traktatet dhe/ose marrëveshjet ndërkombëtare, ku aderon Republika e Kosovës;

1.8. bashkëpunon me Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Agjencinë Kosovare të Inteligjencës për çështje të fushës së komunikimeve elektronike, që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare;

1.9. në rastet e forcës madhore, situatave ekstreme, apo rrethanave tjera të jashtëzakonshme, si dhe me qëllim të përgatitjes për mobilizim të përgjithshëm ose të mbrojtjes kombëtare, apo garantimit të sigurisë kombëtare dhe rendit publik, në përputhje me procedurat e përcaktuara me ligje dhe akte të tjera ligjore, jep udhëzime të detyrueshme, detyra dhe obligime për ndërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike, si dhe për pronarët ose përdoruesit e pajisjeve dhe mjeteve;

1.10. cakton organe certifikuese dhe inspektuese, si dhe laboratorë testues përgjegjës për vlerësimin e konformitetit të pajisjeve dhe aparateve, në përputhje me procedurat e vendosura nga Ministria në përputhje me legjislacionin në fuqi;

1.11. kryen edhe funksione të tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Neni 8

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

1. Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare është autoriteti rregullator kombëtar në fushën e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe atyre postare, i cili kryen detyrat e përcaktuara nga ky ligj dhe nga legjislacioni tjetër në fuqi, si dhe zbaton politikën dhe strategjinë kombëtare të sektorit të komunikimeve elektronike, të përcaktuara nga Ministria.

2. Autoriteti është person juridik, publik, vetëfinancues jofitimprurës, i pavarur, i cili e zhvillon veprimtarinë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autoriteti në punën dhe në marrjen e vendimeve brenda kompetencave të tij është i pavarur.
3. Aktet nënligjore të miratuara nga Autoriteti, ose mosmiratimi i tyre mund të ankimohet në gjykatën kompetente brenda afatit të përcaktuar dhe në përputhje me procedurat e vendosura nga ky ligj dhe ligjet tjera.

Neni 9

Objektivat rregullatore

1. Autoriteti ushtron funksionet në përputhje me këtë ligj dhe me aktet e tjera ligjore dhe nënligjore, si dhe në përputhje me politikat sektoriale kombëtare dhe strategjitë kombëtare të zhvillimit të komunikimeve elektronike dhe me marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e komunikimeve elektronike, ku aderon Republika e Kosovës.
2. Rregullimi në fushën e komunikimeve elektronike duhet të respektojë parimet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji, teknologjitë dhe shërbimet e reja, si edhe tregjet e sapokrijuara do të jenë subjekt i rregullimit, sipas këtij ligji, deri në masën e nevojshme për t'i parandaluar deformimet e konkurrencës dhe për t'i arritur objektivat e këtij ligji.
3. Autoriteti siguron dhe nxit konkurrencën efektive në ofrimin e shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike, facilitetet shoqëruese dhe shërbimet e tjera duke:
 - 3.1. siguruar kushtet që çdo kategori e përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike, përfshirë përdoruesit me nevoja të veçanta, të përfitojnë maksimalisht shërbime alternative, cilësore dhe në përputhje me standardet e miratuara nga Autoriteti;
 - 3.2. mbrojtur interesat e shfrytëzuesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike, për t'i mbrojtur të dhënat personale dhe privatësinë e tyre;
 - 3.3. promovuar dhe siguruar konkurrencë të lirë dhe efektive në sektorin e komunikimeve elektronike;
 - 3.4. siguruar integritetin dhe sigurinë e rrjeteve të komunikimeve elektronike publike;
 - 3.5. nxitur investimet efektive në infrastrukturën e komunikimeve elektronike dhe zhvillimet e reja teknologjike për një cilësi të lartë të produkteve të tyre;
 - 3.6. nxitur përdorimin efikas të frekuencave dhe të hapësirës numerike si burime të fundme, në mënyrë që procedurat dhe planet e numeracionit të zbatohen në atë mënyrë që i jep trajtim të barabartë të gjithë ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike në dispozicion të publikut, e në veçanti të sigurojë që ndërmarrjet me një varg të ndarë të numrave të mos diskriminojnë ofruesit tjerë të shërbimeve të komunikimeve elektronike në lidhje me sekuencat e numrave të përdorura për të dhënë qasje në shërbimet e tyre;

3.7. siguruar mosdiskriminimin dhe barazinë në trajtimin e ofruesve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike;

3.8. siguruar, brenda fushës së kompetencave të tij, që pajisjet dhe mjetet e përdorura janë në përputhje me kërkesat e detyrueshme në fuqi në Republikën e Kosovës dhe për të siguruar përputhshmërinë elektromagnetike të pajisjeve dhe mjeteve.

Neni 10

Kompetencat e Autoritetit

1. Përgatit në bashkëpunim më ministrinë Planin Kombëtar të Radio-Frekuencave dhe punon për harmonizimin e këtij plani me politikat ndërkombëtare mbi zhvillimin e spektrit të radio-frekuencave.

2. Mbledhë dhe përpunon të dhënat statistikore nga ndërmarrësit që kryejnë veprimtarinë e tyre në fushën e komunikimeve elektronike.

3. Publikon çdo informacion të nevojshëm për zhvillimin e një tregu të hapur dhe konkurrues. Rregullat për publikimin e informacionit të tillë, duke përfshirë qëllimin e tij, do të përcaktohen nga Autoriteti, duke marrë parasysh normat ligjore që rregullojnë mbrojtjen e informacionit konfidencial, përfshirë sekretet shtetërore, të biznesit apo ato komerciale, apo informacionin privat në lidhje me një person fizik.

4. Miraton legjislacionin sekondar lidhur me këtë ligj, të cilat janë në kompetencë të Autoritetit, mbështetur në dispozitat e këtij ligji.

5. Miraton vendimet në lidhje me përcaktimin e tregjeve përkatëse, kryen analizat e tregut dhe imponimin, si dhe tërheqjen e obligimeve të rregullatorit tek operatorët me fuqi të ndjeshme tregu.

6. Miraton vendimet lidhur me përcaktimin e ofruesve të shërbimeve universale dhe përcaktimin e obligimeve dhe të drejtave të tyre.

7. Monitoron dhe rregullon dispozitat e komunikimeve elektronike publike të rrjetave dhe shërbimeve.

8. Zgjidhë mosmarrëveshjet, duke përfshirë ato që lidhen me çështjet e përdorimit të përbashkët të faciliteteve dhe pasurive në mes të ndërmarrësve.

9. Zgjidhë mosmarrëveshjet në mes të përdoruesve fundorë dhe operatorëve të shërbimeve publike të komunikimeve elektronike.

10. Monitoron dhe rregullon përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe pasurive.

11. Miraton Planin Kombëtar të numeracionit, Planin për përdorimin e Radio-Frekuencave (kanaleve) dhe planet e zhvillimit të radio komunikimit.

12. Menaxhon resurset e fundme – spektrin e radio-frekuencave dhe hapësirën e numeracionit në komunikimet elektronike.
13. Performon detyrat që lidhen me kompatibilitetin elektromagnetik, përdorimin e pajisjeve dhe mjeteve, radio monitorimin dhe eliminimin e Interferencave (ndërhyrjeve) të Radios.
14. Lëshon autorizime dhe akte të tjera në pajtueshmëri me dispozitat e këtij ligji, si dhe rregulloret e miratuara, duke u bazuar në këtë ligj.
15. Miraton vendimet lidhur me grantet, transferet dhe revokimin e licencave individuale për përdorimin e spektrit të radio-frekuencave në bazë të tenderit publik dhe procedurave të Ankandit publik.
16. Kontribuon në përgatitjen e propozimeve të strategjive kombëtare, politikave duke u referuar në paragrafët 1.1 dhe 1.3 të nenit 7 të këtij ligji.
17. Brenda fushëveprimit të kompetencave të veta, bashkëpunon dhe participon në punën e organeve punuese administrative dhe ndërkombëtare, regjionale, si dhe organizatave dhe institucioneve në fushën e komunikimeve elektronike aty ku aderon Republika e Kosovës.
18. Në bazë të autorizimeve të marra, lidhë marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale në fushën e komunikimeve elektronike.
19. Autoriteti do të publikojë informatat lidhur me zbatimin e këtij ligji brenda fushës dhe duke iu nënshtruar procedurës dhe kushteve të vendosura nga vetë Autoriteti.
20. Aktet nënligjore të miratuara nga Autoriteti, ose mos miratimi i tyre mund të ankimohen në gjykatë brenda afatit të përcaktuar dhe në përputhje me procedurat e vendosura nga ky ligj dhe ligjet tjera.
21. Kryen funksionet e qendrës kompjuterike për reagime emergjente me qëllim të ballafaqimit me rreziqet për sistemet publike të komunikimeve elektronike.
22. Bën konsultime lidhur me zbatimin e këtij ligji, si dhe rregulloret e nxjerra në pajtim me këtë ligj.
23. Kryen detyra tjera të definuara në këtë ligji, në legjislacionin në fuqi, si dhe në Statutin e Autoritetit.

Neni 11 **Raportimi i Autoritetit**

1. Autoriteti është përgjegjës për punën e tij përpara Kuvendit të Republikës së Kosovës.
2. Në përfundim të çdo viti, Autoriteti paraqet në Kuvend, brenda gjashtë mujorit të parë të vitit pasardhës, raportin vjetor të veprimtarisë së vitit paraprak.

3. Raporti vjetor, i përmendur në paragrafin 2. të këtij neni, duhet të përmbajë në mënyrë të veçantë:

- 3.1. raportin e punës së Autoritetit për vitin paraprak;
- 3.2. programin vjetor të punës për vitin në vazhdim;
- 3.3. raportin për statusin e shërbimit universal;
- 3.4. raportin për realizimin e treguesve financiarë vjetorë të Autoritetit;
- 3.5. të dhënat për gjendjen në tregun e komunikimeve elektronike.

4. Raporti vjetor i Autoritetit, si dhe raporti tremujor i tregut të Komunikimeve Elektronike duhet të jetë i disponueshëm për publikun.

Neni 12 **Sigurimi i informacionit për Ministrinë**

Autoriteti i siguron Ministrisë çdo informacion që e gjykon Ministria si të nevojshëm për realizimin e objektivave të politikave zhvillimore sektoriale dhe për përmbushjen e obligimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në Ligjin për shërbimet postare.

Neni 13 **Kompetencat e Komisionit të Pavarur për Media (KPM)**

Komisioni i Pavarur i Medieve është organ i pavarur që rregullon spektrin e Frekuencave Transmetuese në Republikën e Kosovës, licencën transmetuesit publik e privat, përcakton dhe zbaton politikën e transmetimit si dhe ushtron kompetenca tjera të përcaktuara me ligj për Komisionin e Pavarur të Mediave.

Neni 14 **Bashkëpunimi**

1. Autoriteti bashkëpunon me organet dhe strukturat shtetërore, organizatat për mbrojtjen e interesave të shfrytëzuesve/ konsumatorëve për çështje që lidhen me zbatimin e këtij ligji.

2. Autoriteti dhe Autoriteti i Konkurrencës të Kosovës bashkëpunojnë për çështje me interes të përbashkët që lidhen me zbatimin e legjislacionit në fuqi për konkurrencën në sektorin e komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve postare.

3. Autoriteti i Konkurrencës të Kosovës, për aq sa ka të bëjë me aktivitetet e komunikimeve elektronike:

3.1. shkëmben me Autoritetin çdo informacion të nevojshëm për kryerjen e funksioneve të Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës dhe Autoritetit, përfshirë informacionin konfidencial, duke siguruar mbrojtjen e informacionit të marrë;

3.2. i siguron Autoritetit konsulta (këshilla) për çështjet që lidhen me kryerjen e funksioneve të tij sa i përket mbikëqyrjes së konkurrencës në fushën e komunikimeve elektronike;

3.3. bashkëpunon dhe konsultohet me Autoritetin gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes së konkurrencës në fushën e komunikimeve elektronike në përputhje me Ligjin për konkurrencën.

4. Institucioni kompetent për Mbrojtjen e të Drejtave të Konsumatorëve:

4.1. ofron bashkëpunim në aktivitetet e Autoritetit në fushën e mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve në lidhje me përdorimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike nga ana e tyre;

4.2. i ofron Autoritetit këshilla për çështjet që lidhen me kryerjen e funksioneve të tij sa i përket mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve në lidhje me përdorimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike nga ana e tyre;

4.3. brenda fushës së kompetencave të përcaktuara me Ligjin për Siguri të përgjithshme të Produkteve, ushtron mbikëqyrje në sigurinë e produkteve, duke përfshirë sigurinë e produkteve që kanë të bëjnë me shërbimet dhe/ose rrjetet e komunikimeve elektronike, si dhe radio-pajisjet dhe pajisjet fundore;

4.4. bashkëpunon dhe konsultohet me Autoritetin në fushën e mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve në lidhje me përdorimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike.

5. Inspektorati Shtetëror për Produkte Joushqimore, brenda fushës së kompetencave të përcaktuara me Ligjin për Siguri të Produkteve dhe kompetencave të dhëna me këtë nga ana e Qeverisë, mbron të drejtat e konsumatorëve në lidhje me përdorimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe ushtron mbikëqyrje në sigurinë e produkteve, duke përfshirë sigurinë e produkteve që kanë të bëjnë me shërbimet dhe/ose rrjetet e komunikimeve elektronike, si dhe radio-pajisjet dhe pajisjet fundore.

6. Komisioni i Pavarur për Media:

6.1. me rastin e marrjes së vendimeve në lidhje me licencimin e aktiviteteve transmetuese / ri-transmetuese radio-difuzive, konsultohet me Autoritetin për çështjet që kanë të bëjnë me komunikimet elektronike;

6.2. me rastin e licencimit e njofton Autoritetin me shkrim për çështjet që kanë të bëjnë me koordinimin e radio-frekuencave (kanaleve) të përcaktuara për transmetimet dhe/ ose ri-transmetimet radio-difuzive tokësore të programeve radio dhe televizive.

7. Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale bashkëpunon me Autoritetin në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë.

8. Doganat e Kosovës bashkëpunojnë me Autoritetin, brenda fushës së kompetencave të tyre, në kryerjen e funksioneve të saj në lidhje me vendosjen në treg të radio-pajisjeve, pajisjeve fundore dhe pajisjeve/mjeteve, si dhe shkëmbimin e informacionit përkatës.

9. Institucioni për standarde kombëtare bashkëpunon me institucionin e autorizuar për hartimin e politikave dhe strategjive dhe/ose standardeve në fushën e komunikimeve elektronike, në procesin e standardizimeve që kanë të bëjnë me ofrimin e shërbimeve/rrjeteve të komunikimeve elektronike, faciliteteve dhe shërbimeve shoqëruese, duke përfshirë edhe transmetimin e programeve radio dhe/ose televizive, gjithashtu lidhur edhe me ndërfaqet (interfejset) teknike dhe/ose funksionimin e rrjeteve, interoperabilitetit të pajisjeve fundore, duke përfshirë edhe pajisjet marrëse të programeve radio dhe televizive, si dhe do të shkëmbejnë informacion në lidhje me standardizimin.

10. Për sigurimin e nevojave të komunikimeve elektronike, institucionet e sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare bashkëpunojnë me Autoritetin në kuadër të kompetencave të tyre.

11. Gjatë përcaktimit të normave higjienike, lidhur me normat e rrezatimit elektromagnetik, Ministria e Shëndetësisë konsultohet me Autoritetin. Ministria e Shëndetësisë dhe Autoriteti do të shkëmbejnë informacion mbi normat higjienike dhe që kanë të bëjnë me normat e rrezatimit elektromagnetik. Shërbimi (inspektorati) për Mbikëqyrjen e Shëndetit Publik, gjatë ushtrimit të funksioneve të tij në lidhje me mbikëqyrjen e normave të rrezatimit elektromagnetik, do të konsultohet me Autoritetin dhe do të shkëmbejë informacionin përkatës me të.

12. Autoriteti dhe Enti i Statistikës së Kosovës do t'u ofrojë institucioneve tjera shtetërore dhe/ose komunale në bazë të kërkesës, të dhënat në dispozicion të nevojshme për kryerjen e funksioneve të tyre, në masën që është e nevojshme për kryerjen e këtyre funksioneve. Për marrje të informacioneve konfidenciale, institucionet shtetërore dhe/ose komunale duhet të sigurojnë mbrojtje të duhur të tyre.

13. Procedurat dhe kushtet e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të përmendura në këtë nen, duke përfshirë kushtet e projektuara për të siguruar kryerjen e duhur të funksioneve nga secili prej institucioneve në fjalë, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në lidhje me konfliktin e kompetencave, dhe krijimin e praktikave uniforme, mund të rregullohen me marrëveshje ndërmjet institucioneve të tilla.

KREU III

REGJIMI I AUTORIZIMIT TË PËRGJITHSHËM

Neni 15

Bazat e së drejtës për përfshirje në aktivitete të Komunikimeve Elektronike

1. Çdo ndërmarrës ka të drejtë të ofrojë rrjete dhe shërbime publike të komunikimeve elektronike në Republikën e Kosovës, në përputhje me kërkesat e këtij ligji, pa leje paraprake individuale nga institucionet shtetërore.
2. Autoriteti do t'i miratojë aktet nënligjore për krijimin e kushteve të përgjithshme sipas të cilave ndërmarrësit mund të përfshihen në aktivitete të komunikimeve elektronike.
3. Ndërmarrësi, i cili sipas nenit 16 të këtij ligji njofton për ofrimin e shërbimeve dhe/ose rrjeteve të komunikimeve elektronike në Republikën e Kosovës ka të drejtë:
 - 3.1. të negociojë për interkoneksion dhe, kur është e zbatueshme, për të marrë qasje nga ndërmarrësit e tjerë të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun, në përputhje me këtë ligj.
 - 3.2. për tu përcaktuar si ofrues i shërbimit universal për shërbime të veçanta në skemën e shërbimit universal, ose në pjesë të caktuara të territorit të Republikës së Kosovës.

Neni 16

Njoftimi

1. Autoriteti miraton listën e llojeve të aktiviteteve të komunikimeve elektronike për të cilat një ndërmarrës duhet të njoftojë Autoritetin, nëse ai kërkon të përfshihet në ndonjërin prej atyre aktiviteteve. Ndërmarrësi ka të drejtë për t'u përfshirë në aktivitetin përkatës, pas njoftimit të Autoritetit, në përputhje me procedurat dhe kushtet e përcaktuara nga Autoriteti.
2. Autoriteti mund të kërkojë dorëzimin e vetëm një njoftimi për të konfirmuar qëllimin për të filluar me ofrimin e shërbimeve, ose rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe dorëzimin e informacionit minimal, i cili është i nevojshëm që ndërmarrësi të përfshihet në regjistrin e ofruesve të shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike. Ky informacion duhet të kufizohet në:
 - 2.1. atë çfarë është e nevojshme për identifikimin e ofruesit të shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike:
 - 2.1.1. emrin dhe adresën e ofruesit;
 - 2.1.2. të dhënat e regjistrimit ligjor të ndërmarrësit;
 - 2.2. personin e kontaktit të ndërmarrësit;

2.3. përshkrimin e shkurtër të rrjetit, ose shërbimit;

2.4. datën kur është parashikuar fillimi i ofrimit, i ndryshimit, ose ndërprerjes së veprimtarisë.

3. Ndërmarrësit (operatorët dhe ofruesit e shërbimit) janë të detyruar të raportojnë te Autoriteti të gjitha ndryshimet në informacionin e paraqitur gjatë njoftimit, brenda tridhjetë (30) ditëve nga ndodhja e tyre.

4. Autoriteti regjistron operatorët, ose ofruesit e shërbimit brenda pesë (5) ditëve të punës nga data e marrjes së njoftimit, në bazën elektronike të të dhënave, si dhe duhet t'ua konfirmojë atyre me shkrim kryerjen e regjistrimit.

5. Brenda 5 ditëve të punës nga data e marrjes së një njoftimi jo të plotë në dokumentacion, sipas kërkesave në paragrafët 2. e 3. të këtij neni, Autoriteti informon ndërmarrësin për nevojën e plotësimit të dokumentacionit të munguar. Plotësimi i dokumentacionit të kërkuar duhet të bëhet brenda një afati jo më pak se dhjetë (10) ditë dhe jo më shumë se tridhjetë (30) ditë nga data e njoftimit.

6. Ndërmarrësit në përputhje me dispozitat e akteve nënligjore të miratuara nga Autoriteti për sa i përket kushteve të përgjithshme për t'u përfshirë në aktivitete të komunikimeve elektronike duhet të ketë të drejtë të kërkojë që Autoriteti të lëshojë një deklaratë të standardizuar, që konfirmon, ku është e aplikueshme, se ndërmarrësi ka dorëzuar njoftimin e fillimit të veprimtarisë së tij dhe për detajet se në çfarë rrethanash cilido ndërmarrës për ofrimin e shërbimeve ose rrjeteve të komunikimeve elektronike, në bazë të dispozitave të akteve ligjore për sa i përket termave dhe kushteve për t'u përfshirë në aktivitetet përkatëse të komunikimeve elektronike, ka të drejtë për të instaluar një infrastrukturë të komunikimeve elektronike, të negociojë për interkoneksion, dhe/ose të sigurojë qasje. Deklarata duhet të jetë lëshuar jo më vonë se pesë (5) ditë pune pas marrjes së një kërkesë të përshtatshme për konfirmim. Procedura dhe kushtet për lëshimin e deklaratave të tilla do të përcaktohen nga Autoriteti.

7. Autoriteti, me anë të një dokumenti rregullator të mbështetur në këtë ligj, përcakton në mënyrë të hollësishme formën dhe përmbajtjen e kërkesës për njoftim të dokumentacionit mbështetës dhe konfirmimit të regjistrimit. Ky dokument duhet të publikohet dhe të jetë lehtësisht i qasshëm nga publiku.

8. Autoriteti administron një regjistër të përditësuar, bazë të dhënash (*database*) për ndërmarrësit, të cilët kanë njoftuar, sipas përcaktimeve të këtij neni. Baza e të dhënave përmban, të paktën informacionin e përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni. Baza e të dhënave është në qasje të publikut, për të mundësuar qasjen në distancë.

9. Para se të ndërpritet një aktivitet i komunikimeve elektronike, i përfshirë në listën e llojeve të aktiviteteve të komunikimeve elektronike të miratuara nga Autoriteti, ndërmarrësi duhet të njoftojë Autoritetin, në përputhje me procedurën e vendosur për këtë.

Neni 17

Kushtet e përgjithshme

1. Kushtet e përgjithshme për t'u përfshirë në aktivitete të komunikimeve elektronike të përcaktuara nga Autoriteti duhet të jenë objektivist të arsyeshme në raport me rrjetin ose shërbimin në fjalë, jodiskriminuese, transparente dhe proporcionale. Autoriteti do të vendosë vetëm ato terma dhe kushte që janë specifike për sektorin e komunikimeve elektronike dhe të cilat nuk janë parashikuar në aktet e tjera ligjore. Aktet ligjore për vendosjen e kushteve të përgjithshme për t'u përfshirë në aktivitetet e komunikimeve elektronike duhet të specifikojnë kriteret dhe procedurat për vendosjen e detyrimeve për ndërmarrësit që kanë fuqi të ndjeshme tregu në tregun përkatës dhe/ose ndërmarrësit e caktuar për ofrimin e shërbimeve universale, ose do të përmbajnë një referencë të aktet ligjore përkatëse.

2. Dispozitat e akteve nënligjore të miratuara nga Autoriteti për vendosjen e kushteve të përgjithshme për përfshirjen në aktivitetet e komunikimeve elektronike mund të jenë të lidhur vetëm me:

- 2.1. kontributin financiar për financimin e shërbimit universal;
- 2.2. interoperabilitetin e shërbimeve dhe interkoneksionin e rrjeteve;
- 2.3. sigurimin e disponueshmërisë dhe përdorimin e numrave nga plani i numeracionit për përdoruesit fundorë, duke përfshirë kushtet për këtë përdorim;
- 2.4. mbrojtjen e mjedisit, planifikimin territorial, qasjen në pronat e patundshme, përfshirë përdorimin e tyre, bashkëvendosjen, ose përdorimin e përbashkët të pajisjeve, përfshirë, nëse është e zbatueshme, çfarëdo garancie financiare ose teknike, që mund të jetë e nevojshme për kryerjen e veprimtarisë;
- 2.5. mbrojtjen e të dhënave personale dhe të privatësisë;
- 2.6. mbrojtjen e konsumatorit;
- 2.7. kufizimet në transmetimin e përmbajtjes, nëse cenohet korniza ligjore;
- 2.8. mundësimin e përgjimit nga autoritetet kompetente, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për përgjimin e komunikimeve elektronike dhe zbatimin e detyrimeve, që burojnë nga ky legjislacion;
- 2.9. kushtet për ofrimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike në rastet e gjendjes së emergjencës apo të gjendjes së luftës;
- 2.10. mbrojtjen e shtetasve ndaj veprimeve të dëmshme të rrezatimit elektromagnetik, të përhapur nga rrjetet e komunikimeve elektronike në lidhshmëri me ligjet dhe rregulloret e vendit;
- 2.11. detyrimin për të ofruar qasje;

2.12. mirëmbajtjen e integritetit të rrjeteve të komunikimeve publike dhe parandalimin e ndërhyrjeve elektromagnetike ndërmjet rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike;

2.13. mbrojtjen e rrjeteve publike të komunikimeve ndaj qasjes së paautorizuar;

2.14. përdorimin e frekuencave, duke siguruar përdorimin efektiv të spektrit të frekuencave dhe parandalimin e interferencave të dëmshme;

2.15. detyrimin për të plotësuar standardet dhe specifikimet teknike të rrjeteve dhe të pajisjeve për ndërtimin e rrjeteve dhe ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, si dhe të shërbimeve e faciliteteve shoqëruese, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

3. Ndërmarrësit ofruer të shërbimeve dhe/ose rrjeteve të komunikimeve elektronike do t'i paraqesin Autoritetit, në përputhje me procedurat dhe kushtet e përcaktuara nga Autoriteti, të dhëna dhe raporte për veprimtarinë e tyre.

4. Dispozitat e akteve nënligjore të Autoritetit për vendosjen e kushteve të përgjithshme për përfshirjen në aktivitetet e komunikimeve elektronike mund të ndryshohen në raste objektivisht të justifikuara dhe në mënyrë proporcionale. Ndryshimet e menduara do të publikohen dhe palëve të interesuara, përfshirë shfrytëzuesve dhe konsumatorëve, do t'u lejohet një periudhë e mjaftueshme kohore për të shprehur pikëpamjet e tyre mbi ndryshimet e propozuara brenda një periudhe kohore, e cila duhet të jetë jo më pak se njëzet e tetë (28) ditë, përveç në rrethana të jashtëzakonshme.

Neni 18

Detyrimi për të dhënë informacion

1. Ndërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike detyrohen t'i japin të dhëna dhe çdo informacion tjetër, të kërkuar nga Ministria dhe Autoriteti, në funksion të përmbushjes së detyrave të përcaktuara nga ky ligj.

2. Lloji i të dhënave, afatet dhe mënyra e dërgimit të tyre përcaktohen nga organet përkatëse kompetente.

3. Autoriteti ka të drejtë të marrë nga institucionet shtetërore, institucionet ndërkombëtare dhe të tjera, si dhe nga institucionet komunale, nga ofruerit e shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike, nga shfrytëzuesit e radio-frekuencave (kanaleve), numrave të telefonit dhe resurseve tjera të komunikimeve elektronike, si dhe nga personat çdo informacion të nevojshëm për Autoritetin, Komisionin Evropian dhe autoritetet rregullatore kombëtare tjera, anëtare të BE-së, për kryerjen e detyrave dhe funksioneve të caktuara, duke përfshirë edhe informatat financiare, pavarësisht nga konfidencialiteti i tyre. Ofruerit e shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike, shfrytëzuesit e radio-frekuencave (kanaleve), numrave të telefonit dhe të resurseve tjera të komunikimeve elektronike, si dhe personat do t'i paraqesin Autoritetit çdo informacion sipas kërkesës së tij dhe në një periudhë dhe nivel të detajeve të kërkuara nga Autoriteti.

4. Autoriteti do të sigurojë fshehtësinë e informatave konfidenciale, në përputhje me procedurat dhe kushtet e përcaktuara me aktet ligjore. Informatat konfidenciale nuk do të përfshijnë informacione të përgjithshme në lidhje me tregjet e veçanta të komunikimeve elektronike e as të dhënat për pjesën e tregut të zotëruar nga ndërmarrësit e veçantë, numrin e parapaguesve (duke përfshirë të dhëna për llojet e veçantë të parapaguesve), të ardhurat (përfshirë të dhënat mbi të ardhurat nga aktivitete të veçanta) dhe për masën (sasinë) e komunikimeve elektronike, ose trafikun e thirrjeve, si dhe informacionin e marrë sipas nenit 34 paragrafi 4 të këtij ligji. Autoriteti do të mbajë informacionin e marrë nga institucionet e BE-së dhe/ose shtetet tjera anëtare të BE-së në përputhje me procedurën dhe kushtet e përcaktuara në aktet ligjore të BE-së.

5. Autoriteti mund të kërkojë nga ndërmarrësit e përfshirë në aktivitete të komunikimeve elektronike, deri në masën që është e lidhur me përcjelljen e aktiviteteve të komunikimeve elektronike ose të përdorimit të resurseve të komunikimeve elektronike, ose në masën që është e lidhur me detyrimet e vendosura për një ndërmarrës që ka fuqi të ndjeshme tregu në tregun përkatës ose i caktuar për të ofruar shërbime universale, informacionin që është proporcional dhe objektivisht i arsyetuar për qëllimet si më poshtë (e pazbatueshme për dhënien e informacionit që ka të bëjë me instalimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike):

5.1. verifikimin sistematik apo rast pas rasti të pajtueshmërisë së një ndërmarrësi me dispozitat e këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore që kanë të bëjnë me shfrytëzimin efikas dhe efektiv të resurseve të komunikimeve elektronike, financimin e shërbimeve universale, ose pagesave për Autoritetin, si dhe të pagesave në buxhetin e shtetit lidhur me të drejtën e përdorimit të resurseve të komunikimeve elektronike dhe me detyrimet e vendosura për një ndërmarrës me fuqi të ndjeshme tregu në tregun përkatës ose i caktuar për ofrimin e shërbimeve universale;

5.2. verifikimin e veçantë të pajtueshmërisë së një ndërmarrësi me aktet ligjore për vendosjen e termave dhe kushteve për t'u përfshirë në aktivitete të komunikimeve elektronike, ose termat dhe kushtet e përdorimit të resurseve të komunikimeve elektronike;

5.3. procedurat për përcaktimin (atribuimin) e resurseve të komunikimeve elektronike dhe vlerësimin e kërkesave përkatëse;

5.4. publikimin e pasqyrave krahasuese të cilësisë dhe çmimeve të shërbimeve në dobi të konsumatorëve;

5.5. qëllime të përcaktuara qartë statistikore;

5.6. qëllime të analizave të tregut;

5.7. vlerësimin për zhvillimet në të ardhmen të shërbimeve ose rrjeteve që mund të kenë ndikim në shërbimet e shitjes me shumicë që ndërmarrësit i vënë në dispozicion të konkurrentëve;

5.8. vlerësimin e mundësive për bashkëshfrytëzimin e faciliteteve, krijimin e një liste të detajuar me llojin, disponueshmërinë dhe vendndodhjen gjeografike të këtyre faciliteteve, në dispozicion të palëve të interesuara;

5.9 vlerësimin e sigurisë dhe/ose integritetit të shërbimeve dhe rrjeteve publike të komunikimeve elektronike, duke përfshirë politikat e dokumentuara të sigurisë.

6. Autoriteti nuk mund të kërkojë informacionin e përmendur në paragrafin 5 të këtij neni, përveç për informacionin e specifikuar në nënparagrafin 5.3 të paragrafit 5 të këtij neni, nga një ndërmarrës që ka për qëllim të angazhohet në një veprimtari të komunikimeve elektronike, para se atij t'i jetë dhënë e drejta për të ushtruar, ose para se të fillojë ushtrimin e aktivitetit të komunikimeve elektronike (cilado që të jetë më herët), ose si një parakusht për marrjen e të drejtës së tillë.

7. Kur kërkohet informacioni i përmendur në paragrafin 5 të këtij neni nga ofruesit e shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike, Autoriteti duhet të informojë ndërmarrësit për qëllimin specifik për të cilin ky informacion do të përdoret.

Neni 19

Dhënia e të drejtave për përdorim

Dhënia e së drejtës për përdorim të frekuencave dhe enumeracionit bëhet në përputhje me dispozitat e Kreut VII dhe VIII të këtij ligji.

KREU IV

SHËRBIMET DHE RRJETET E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

Neni 20

Ofrimi i shërbimeve dhe rrjeteve publike të komunikimeve elektronike

Ndërmarrësit, që ndërtojnë dhe/ose përdorin rrjete publike të komunikimeve elektronike dhe ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike në dispozicion të publikut janë të detyruar të zbatojnë kushtet e këtij ligji dhe të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore, si dhe rregulloret e nxjerra në zbatim të këtij ligji, që të mos rrezikojnë rendin publik, jetën dhe shëndetin e qytetarëve, sigurinë publike dhe mbrojtjen e vendit.

Neni 21

Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike

Rrjetet publike të komunikimeve elektronike dhe infrastruktura shoqëruese me to duhet të ndërtohen dhe shfrytëzohen në përputhje me këtë ligj dhe me aktet nënligjore në zbatim të tij, me legjislacionin në fuqi për planifikimin territorial dhe ndërtimin, për mbrojtjen e mjedisit, si dhe me standardet e tjera teknike.

Neni 22

Baza për instalimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike

1. Ofruesit e rrjeteve të komunikimeve elektronike kanë të drejtë që të instalojnë infrastrukturën e komunikimeve elektronike në tokën që është pronë e tyre sipas së drejtës së pronësisë, ose për të cilën është vendosur një servitut, ose kur ofruesit kanë të drejtë ta përdorin atë në baza të tjera pa e ndryshuar destinimin e tokës.
2. Në rastet kur kërkohet përdorimi ekonomik i hapësirave, planifikimi urban dhe mbrojtja e mjedisit, ndërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve publike elektronike, që kanë të drejtë të ndërtojnë dhe të instalojnë pajisje komunikimi në mjedise private ose publike duhet t'i ndërtojnë ose instalojnë ato, në atë mënyrë që të mundësohet përdorimi i përbashkët i tyre.
3. Punët për heqjen e infrastrukturës së komunikimeve elektronike të bëra gjatë ndërtimit ose rindërtimit të ndërtesave, urave dhe strukturave të tjera do të kryhet nga investitori me shpenzime të tyre sipas specifikimeve teknike të ofruara nga pronarët e infrastrukturës së komunikimeve elektronike dhe pasi që ka koordinuar një punë të tillë me pronarët e lartpërmendur, përveç nëse investitori dhe pronarët nuk bien dakord ndryshe.
4. Personat e përfshirë në ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike, në përputhje me procedurën, kushtet dhe rastet e përcaktuara në rregullat për instalimin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e infrastrukturës së komunikimeve elektronike, do të bëjnë informimin publik në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit dhe për mundësinë që persona të tjerë të marrin pjesë në ndërtimin e përbashkët.
5. Instalimi, mbrojtja, bashkëshfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së komunikimeve elektronike duhet të rregullohen me Ligjin për Planifikimin Hapësinor, Ligjin për Ndërtim, Ligjin për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, Ligjin mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Ligjin për Rrugët, rregullat për instalimin dhe përdorimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të për gatitura nga Ministria në bashkëpunim me Autoritetin dhe të miratuara nga Ministria, si dhe në pajtueshmëri me legjislacionin tjetër në fuqi.
6. Ndërtimi i rrjetave publike të komunikimeve elektronike si dhe faciliteteve shoqëruese është në interesin publik. Taksa e pronës së paluajtshme nuk zbatohet për rrjetat e komunikimeve elektronike dhe faciliteteve shoqëruese, duke përfshirë edhe ato për rrjetat mobile (GSM), stacionet bazë, satelitët dhe infrastruktura nëntokësore.

Neni 23

Instalimi, mbrojtja, bashkëshfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së komunikimeve elektronike në rrjetin rrugor

1. Pas koordinimit të veprimeve të tyre në pajtueshmëri me kërkesat e legjislacionit përkatës, me institucionet shtetërore qendrore, ose komunale, operatorët mund të përdorin brezin rrugor komunal dhe shtetëror, sheshet, tubacionet, rrjetin e ujësjellësit, urat, viaduktet, tunelet dhe strukturat e tjera për ndërtimin e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike pa pagesë, ose me pagesë minimale për t'i mbuluar shpenzimet administrative të institucioneve përkatëse.

2. Me përfundimin e instalimit, rindërtimit ose riparimit të infrastrukturës së komunikimeve elektronike, operatorët duhet të rregullojnë rrugët dhe/ose strukturat e lidhura, në përputhje me procedurat e përcaktuara me legjislacion tjetër.

Neni 24

Përdorimi i përbashkët i faciliteteve dhe aseteve

1. Në qoftë se një ofrues i rrjeteve publike të komunikimeve elektronike nuk mund ta realizojë të drejtën për të instaluar infrastrukturën e domosdoshme të komunikimeve elektronike, ose shpenzimet për realizimin e të drejtës së tillë janë disproporcionalisht të larta, Autoriteti mund të kërkojë nga cilido ofrues i rrjeteve të komunikimeve elektronike ose nga një person tjetër që kontrollon infrastrukturën përkatëse që të lejojë, në kushte jodiskriminuese, bashkëndarjen e infrastrukturës ekzistuese të komunikimeve elektronike, si dhe të tubacioneve të tjera përkatëse, kanaleve kabllore, kolektorëve, kullave, shtyllave, ndërtesave dhe objekteve tjera ose instalimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike, aty ku ajo është me kosto të arsyeshme dhe nuk kërkon punë të rëndësishme shtesë. Në këtë rast, Autoriteti do të konsultohet me personat e interesuar, në përputhje me procedurat dhe kushtet e përcaktuara në rregullat e referuara në paragrafin 4 të nenit 82 të këtij ligji.

2. Autoriteti do të inkurajojë ndërmarrësit e rrjeteve publike të komunikimit për arritjen e marrëveshjeve për shfrytëzimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve.

3. Procedura dhe kushtet për përdorimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike, si dhe tubacioneve, kanaleve kabllore, ujëmbledhësve, kullave, shtyllave, ndërtesave dhe objekteve të tjera përkatëse, si dhe për instalimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike duhet të përcaktohet me kontratë. Një person nën kontrollin e të cilit është një infrastrukturë përkatëse nuk mundet që, në rastet e përcaktuara me këtë ligj, të refuzojë të lidhë një kontratë të tillë me një ofrues të rrjeteve publike të komunikimit, të kërkojë që ajo duhet të ndryshohet ose të ndërpritet nëse detyrimet kontraktuale janë duke u kryer, madje as në bazë të mungesës së dokumenteve që ofrojnë dëshmi të kontrollit të ligjshëm të infrastrukturës së komunikimeve elektronike.

4. Përmes marrëveshjes ndërmjet palëve, shfrytëzuesi infrastrukturës do t'i paguajë një tarifë të duhur personit infrastruktura e të cilit është duke u përdorur.

5. Autoriteti do të vendosë procedurën dhe kushtet për bashkëshfrytëzimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike përmes rregullores për instalimin dhe përdorimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike.

6. Një ndërmarrës i rrjetit publik të komunikimeve mund të refuzojë kërkesën për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve në qoftë se shfrytëzimi i përbashkët i faciliteteve dhe aseteve është teknikisht i parralizueshëm, ose dëmton integritetin dhe sigurinë e rrjetit.

7. Në rast se ndërmarrësit e rrjeteve publike të komunikimeve nuk arrijnë deri në një marrëveshje mes tyre, Autoriteti, me kërkesë të cilësdo palë, do të fillojë një procedurë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

8. Në rastet kur shfrytëzimi i përbashkët kërkon rindërtimin e faciliteteve dhe të aseteve të komunikimit, shpenzimet e rindërtimit mbulohen nga pala, që kërkon shfrytëzimin e përbashkët.

Neni 25

Servituti për instalimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike

1. Kur një ofrues i rrjeteve të komunikimeve publike nuk mund ta realizojë të drejtën për të ndërtuar rrjete të komunikimeve elektronike as përmes ndërtimit të përbashkët, as përmes bashkëshfrytëzimit të infrastrukturës, as përmes mënyrave të tjera të parashikuara në këtë ligj, gjithashtu edhe në rast të dështimit të negociatave me pronarët e pronave, të cilat do të mund të përdorëshin për instalimin e infrastrukturës, e cila është pjesë e një rrjeti publik të komunikimeve, ofruesi i tillë i rrjeteve publike të komunikimeve mund të aplikojë në gjykatë për dhënien e së drejtës, atëherë kur ekziston një mundësi e tillë dhe kur kjo nuk vendos një barrë të panevojshme për pronarin, që të përdorë pronën shtetërore, komunale dhe private për instalimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike, duke krijuar një servitut në pronën e tillë. Vendimi i gjykatës për vendosjen e servitutit rekomandohet që të merret në një afat sa më të shkurtër kohor.

2. Informacioni për procedurën dhe kushtet lidhur me servitutet për t'u zbatuar sipas këtij neni dhe akteve të tjera ligjore, si dhe informacioni në lidhje me servitutet për instalimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike duhet të parashtrohen tek Autoriteti, i cili e publikon atë në përputhje me procedurën dhe kushtet e përcaktuara nga Autoriteti.

Neni 26

Mbrojtja e rrjeteve publike të komunikimeve

1. Zona e mbrojtur e rrjeteve publike të komunikimeve përbëhet nga një rrip toke përgjatë linjave komunikuese me tela, të rrjeteve publike të komunikimit dhe rreth objekteve të infrastrukturës së komunikimeve elektronike, duke përfshirë çdo konstruksion dhe strukturë të vendosur në të. Është e ndaluar që në këtë zonë të ndryshohet destinimi i tokës, të ndërtohen ndërtesa dhe struktura tjera, të mënjanohen pajisjet dhe materialet, të gërmohet, të shpohen puse, të kryhen shpërthime dhe të kryhen vepra të tjera që mund ta dëmtojnë infrastrukturën e komunikimeve elektronike, pa miratimin paraprak nga pronarët e infrastrukturës së komunikimeve elektronike.

2. Përmasat dhe metodat e përcaktimit të kufijve të zonave të mbrojtura, si dhe procedura për kryerjen e punëve brenda zonave të tilla do të përcaktohen nga Autoriteti.

3. Punonjësit, apo përfaqësuesit tjerë që veprojnë nën autoritetin e një personi, infrastruktura e rrjeteve publike të komunikimit e të cilit influencohet, kanë të drejtë ta mirëmbajnë infrastrukturën e komunikimeve elektronike në përputhje me rregullat e përcaktuara nga Autoriteti.

Neni 27
Pagesat për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike

1. Ndërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve dhe qarkullimi i të cilave është mbi njëqind mijë (100,000) Euro, janë të detyruar të paguajnë një pagesë vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike nga Autoriteti. Kjo pagesë bëhet për t'i mbuluar kostot administrative të Autoritetit.
2. Pagesa vjetore, e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, nuk duhet të jetë më shumë se zero presje pesë për qind (0,5%) e të hyrave vjetore të vitit paraprak kalendarik.
3. Ndërmarrësi duhet të bëjë pagesën vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike pranë Autoritetit deri me datë 30 prill të çdo viti, menjëherë pas dorëzimit të bilancit vjetor dhe të raportit të audituar në rast të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe/ose caktimin e një eksperti të certifikuar të kontabilitetit, i cili depozitohet nga ndërmarrësi pranë Autoritetit.
4. Niveli i pagesës vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike, brenda kufirit prej zero presje pesë për qind (0,5%) të të hyrave vjetore, përcaktohet në rregulloren e Autoritetit, të nxjerrë në përputhje me këtë ligj.
5. Përcaktimi i nivelit të pagesës vjetore për mbikëqyrjen e tregut nuk duhet të çrregullojë konkurrencën apo të krijojë pengesa për hyrjen në treg të ndërmarrësve të rinj.
6. Para miratimit të rregullores, sipas përcaktimeve në pikën 4 të këtij neni, Autoriteti duhet të njoftojë me shkrim ndërmarrësit, për të paraqitur mendimet dhe propozimet e tyre, me shkrim, për pagesën vjetore, mënyrën e përlllogaritjes dhe të zbatimit të saj. Afati i dërgimit të propozimeve nga ndërmarrësit është tridhjetë (30) ditë nga data e marrjes së njoftimit. Mosdërgimi i mendimeve dhe propozimeve brenda këtij afati, nuk përbën pengesë për Autoritetin që të veprojë sipas paragrafit 4 të këtij neni.
7. Pagesa vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike duhet të bëhet në pajtueshmëri me nenin 83 të këtij ligji.

KREU V
SIGURIMI I SHËRBIMIT UNIVERZAL

Neni 28
Shërbimi Univerzal

1. Në territorin e Republikës së Kosovës do të sigurohet ofrimi i këtyre shërbimeve universale:
 - 1.1. lidhja, me kërkesën e tij, e shfrytëzuesit fundor në rrjetin publik të komunikimeve, duke siguruar qasje në shërbimet telefonike, të disponueshme për publikun nga një vendndodhje gjeografike e përcaktuar, duke i krijuar mundësi

shfrytëzuesit të bëjë dhe të pranojë thirrje lokale, kombëtare e ndërkombëtare, komunikimin me faks dhe komunikimin e të dhënave;

1.2. shërbimi i kërkimit të të dhënave të numratorit në dispozicion të publikut, që plotëson kërkesat e përgjithshme të parashikuara në paragrafin 8 të këtij neni;

1.3. sigurimi i telefonave publik me pagesë apo pikave tjera qasëse të telefonisë publike, duke plotësuar nevojat e arsyeshme të shfrytëzuesve fundorë në gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Telefonat publik me pagesë duhet të mundësojnë lidhjen me shërbimet e emergjencës pa pagesë dhe pa qenë nevoja e përdorimit të mjetit të pagesës, të parashikuar për to;

1.4. sigurimi i kushteve për qasje të barasvlershme dhe përdorimin e shërbimeve telefonike të disponueshme për shfrytëzuesit fundorë, me aftësi të kufizuara, duke përfshirë qasje në shërbimet e thirrjeve të emergjencës, të numratorit telefonik për të gjithë shfrytëzuesit në Republikën e Kosovës.

2. Autoriteti ka të drejtë që të vendos shërbim universal shtesë, procedurën dhe kushtet për ofrimin e shërbimit të tillë, kërkesat e kualitetit të shërbimit, si dhe procedurën, kushtet dhe rastet për imponimin e detyrimeve të shërbimit shtesë tek ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike. Humbjet e shkaktuara në lidhje me ofrimin e shërbimit univerzal shtesë nuk mund të kompensohen nga fondet e ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike.

3. Autoriteti monitoron rritjen e nivelit të tarifave me tregti me pakicë të shërbimeve dhe nëse konsiderohet e nevojshme Qeverisë i sugjerohet që të vendos kufirin e çmimit për shërbimin universal dhe rregullat për ofrimin e shërbimit universal.

4. Qeveria përcakton kufirin e çmimit për shërbimet universale dhe nëse është e nevojshme, poashtu edhe procedurën, kushtet dhe rastet për kompensimin e dëmeve të shkaktuara në lidhje me ofrimin e shërbimit.

5. Autoriteti miraton rregullat për përcaktimin e shërbimit universal si dhe të përcaktojë fushëveprimin e shërbimeve universale, kërkesat e kualitetit të shërbimit, procedurën dhe kushtet për ofrimin e shërbimit të tillë, procedurën, kushtet dhe rastet për imponimin e detyrimeve të shërbimit universal për ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike. Detyrimet e shërbimit universal gjithashtu mund të lidhen me të qenurit operator me fuqi të ndjeshme tregu në një treg relevant.

6. Ministria mund të kërkojë që Autoriteti të përcaktojë kërkesat për kualitetin e shërbimit universal dhe rregullat për publikimin e informacionit për kualitet të shërbimeve, gjithashtu të miratojë aktet ligjore që zbatojnë rregullat për ofrimin e shërbimit universal.

7. Autoriteti ka të drejtë që të imponojë detyrime për ndërmarrësit që nuk janë përcaktuar që të ofrojnë shërbimet universale të cilat janë të nevojshme për ofrimin e shërbimit universal në mënyrën e duhur, duke përfshirë detyrimin për të ofruar shërbimet e regjistrit për kërkim me kushte që janë të favorshme, objektive, të bazuara në kosto dhe jo-diskriminuese dhe detyrimet për të bërë të mundshme shërbimet e tilla.

8. Kur një ndërmarrës i përcaktuar në përputhje me këtë nen ka planifikuar që të shes një pjesë të konsiderueshme ose të gjitha pronat e saj të rjetit për qasje lokale tek një entitet ligjor tjetër me pronar tjetër, do ta informoj paraprakisht Autoritetin në mënyrë të përshtatshme, për të lejuar që Autoriteti të vlerësoj efektin e transaksionit të planifikuar në ofrimin e qasjes në lokacionin fiks dhe shërbimeve telefonike sipas paragrafit 1. të këtij neni. Autoriteti mund të imponoj, ndryshoj ose anuloj detyrimet specifike sipas nenit 32 të këtij ligji.

9. Me rastin e verifikimit nëse një ndërmarrës me detyrime të shërbimit universal i plotëson detyrimet e tilla, Autoriteti ka të drejtë që të urdhëroj auditim të pavarur dhe/ose rishqyrtime të ngjashme për të dhënat e paraqitura, të paguara nga ndërmarrësi përkatës, për të garantuar saktësinë dhe krahasimin e të dhënave. Auditimet e tilla të pavarura dhe/ose rishqyrtimet e ngjashme, të paguara nga ndërmarrësi përkatës, mund të urdhërohen jo më shpesh se një herë gjatë një viti kalendarik, me përjashtim të rasteve kur ka dyshime të arsyeshme që ndërmarrësi vepron në kundërshtim me aktet ligjore ose kur ndërmarrësi kërkon kompensim për humbjet e shkaktuara në lidhje me ofrimin e shërbimeve. Auditori ose kompania audituese do të përzgjidhet me tender. Kushtet dhe procedurat e tenderit do të vendosen nga Autoriteti.

10. Humbjet e shkaktuara në lidhje me ofrimin e shërbimeve të referuara në paragrafin 1. të këtij neni do të kompensohen nga burimet e paraqitura nga Qeveria në pajtueshmëri me dispozitat e paragrafit 3. të këtij neni. Autoriteti ka të drejtë të krijoj burime të tjera për kompensimin e humbjeve të shkaktuara në lidhje me shërbimin universal. Autoriteti do të krijoj rregullat për llogaritjen e humbjeve, imponon një mekanizëm për kompensim, dhe përcakton vlerën e humbjeve në rastet specifike. Autoriteti ka të drejtë të rishqyrtoj llogaritë e një ndërmarrësi si dhe informacionet e tjera që përdoren për llogaritjen e vlerës së humbjeve dhe të kërkoj nga ndërmarrësi që të paraqesë një opinion të auditimit. Rezultatet e llogaritjes së humbjes dhe konkluzionet e rishqyrtimit të bëra nga Autoriteti dhe/ose opinionin e auditimit do të bëhen publike.

11. Ofruesi i shërbimit universal, i caktuar nga Autoriteti për botimin e numërorit telefonik të përgjithshëm, duhet të reflektojë, të paktën një herë në vit, ndryshimet e ndodhura. Numërori telefonik i përgjithshëm duhet të përmbajë të paktën: emrin e plotë të parapaguesit, adresën, numrin përkatës të telefonit, me përjashtim për parapaguesit, të cilët kanë kërkuar, në mënyrë të veçantë, që këto të dhëna të mos bëhen publike.

12. Ofruesit e shërbimeve publike telefonike duhet t'u ofrojnë cilitdo ofrues të numërorit për kërkim të të dhënave që i referohet nën-paragrafit 1.2. të paragrafit 1. të këtij neni informacionin e nevojshëm për parapaguesit e tyre, për t'u përfshirë, pa përjashtim, në numërorin telefonik të përgjithshëm dhe në shërbimin e informacionit të ofruar.

13. Kur ofruesi i shërbimit nuk i dorëzon ofruesit të numërorit për kërkim të të dhënave për parapaguesit, Autoriteti detyron ofruesin e shërbimit telefonik t'i dorëzojë këto të dhëna brenda një periudhe të caktuar kohore. Ofruesi i numërorit për kërkim të të dhënave duhet t'i përfshijë të dhënat në numërorin telefonik të përgjithshëm dhe në shërbimet e informacionit pa diskriminim ndërmjet ofruesve të shërbimit telefonik.

KREU VI

RREGULLIMI I KONKURENCËS NË FUSHËN E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

Neni 29

Dispozitat e përgjithshme

1. Autoriteti duhet të krijojë kushte për konkurrencë të efektshme dhe zhvillim të saj në fushën e komunikimeve elektronike, si dhe kushte për të parandaluar shpërdorimin e fuqisë në treg nga ndërmarrësit.
2. Komisioni Kosovar i Konkurrencës do të ushtrojë mbikëqyrjen e konkurrencës në fushën e komunikimeve elektronike në përputhje me Ligjin për Konkurrencë.

Neni 30

Ndërmarrësit me fuqi të ndjeshme tregu

1. Ndërmarrësi do të konsiderohet që ka fuqi të ndjeshme tregu (FNT) nëse ai, ose bashkë me të tjerët ka një pozitë ekuivalente mbizotërimi, pra një pozitë të forcës ekonomike që i jep fuqi që të veprojë në nivel të konsiderueshëm në mënyrë të pavarur nga konkurrentët, klientët dhe shfrytëzuesit fundorë.
2. Aty ku ndërmarrësi ka FNT në një treg relevant, gjithashtu mund të mendohet që ka FNT në një treg të lidhur ngushtë me të (tregu tjetër) nëse lidhjet në mes dy tregjeve janë të tilla që të lejojnë që fuqia e tregut që e ka në një treg të ndikojë në tregun tjetër, duke përforcuar fuqinë në treg të ndërmarrësit. Prandaj, detyrimet që kanë për qëllim parandalimin e ndikimit të tillë mund të zbatohen në tregun tjetër.
3. Ndërmarrësi do të identifikohet që ka FNT atëherë kur përcaktohet me vendim të Autoritetit bazuar në një analizë të tregut, dhe do të konsiderohet si e tillë derisa Autoriteti përcakton me vendim të saj bazuar në një analizë tjetër të tregut që ndërmarrësi nuk ka FNT.

Neni 31

Analiza e tregut

1. Analiza e tregut duhet të bëhet nga Autoriteti. Procedura e analizës së tregut duhet të iniciohet me një vendim paraprak të Autoritetit. Analiza e tregut nga Autoriteti bëhet me qëllim të garantimit të konkurrencës së efektshme në fushën e komunikimeve elektronike dhe parandalimit të shpërdorimit të fuqisë në treg nga ndërmarrësit me FNT. Autoriteti do të nxjerrë Rregulloren për analizë të tregut duke marr parasysh dispozitat e këtij ligji dhe udhëzuesit e Komisionit Evropian për analizë të tregut dhe vlerësimin e FNT sipas kornizës rregullatore të Bashkimit Evropian për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike.
2. Kur bëhet një analizë e tregut, Autoriteti do të veprojë në pajtim me këtë ligj, rregulloren e analizës së tregut referuar në paragrafin 1 të këtij neni dhe do të marrë parasysh udhëzuesit dhe rekomandimet e miratuara nga Komisioni Evropian.

3. Autoriteti ka të drejtë që të bëjë një analizë të tregut:

3.1. me kërkesë të arsyeshme dhe të justifikuar të ndërmarrësve të interesuar;

3.2. me kërkesë të arsyeshme dhe të justifikuar të institucioneve qendrore ose komunale;

3.3. me vetiniciativën e tij.

4. Procedura e analizës së tregut do të përfshijë fazat në vijim:

4.1. përcaktimi i tregut relevant (produkti/shërbimi dhe shtrirja gjeografike), karakteristikat e të cilit mund të jenë të tilla për të justifikuar imponimin e detyrimeve referuar në nenin 32 të këtij ligji;

4.2. analizimi nëse tregu relevant ka konkurrencë efektive dhe në rastin kur nuk ka konkurrencë efektive, identifikimi i ndërmarrjeve me FNT në atë treg;

4.3. imponimi, korigjimi dhe/ose anulimi i detyrimeve të referuara në nenin 32 të këtij ligji në lidhje me ndërmarrjet me FNT.

5. Autoriteti ka të drejtë që të kompletojë vetëm pjesë të veçanta të procedurës së analizës së tregut, në rastet e tregjeve për të cilat konsideron se për arsye të justifikuara nuk është i arsyeshëm kompletimi i gjithë procedurës.

6. Autoriteti do t'i përcaktojë tregjet relevante që i nënshtrohen rregullimit paraprak (ex-ante) në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe me parimet e Ligjit për Konkurrencën dhe kushtet aktuale të tregut të Kosovës, duke marrë parasysh rekomandimet e Komisionit Evropian për tregjet relevante të produkteve dhe shërbimeve që i nënshtrohen rregullimit paraprak (ex-ante).

7. Kur bëhet një analizë e tregut, Autoriteti ka të drejtë që ta konsultojë Autoritetin e Konkurrencës të Kosovës sipas dispozitave të nenit 14 të këtij ligji. Autoriteti duhet të marrë mendimin e Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës për definicionin e tregut relevant nëse definicioni i tregut ndryshon nga definicioni i krijuar në rekomandimin e Komisionit Evropian referuar në paragrafin 6 të këtij neni. Në të gjitha rastet, vendimi përfundimtar do të merret nga Autoriteti.

8. Autoriteti duhet ta kompletojë procedurën e analizës së tregut brenda katër muajve pas vendimit të Autoritetit referuar në paragrafin 1 të këtij neni për iniciimin e analizës së tregut. Autoriteti do t'i konsultojë palët relevante për draftin e vendimit të vet për rezultatet e analizës së tregut sipas procedurës për konsultim të krijuar në nenin 82 të këtij ligji. Periudha kohore e kërkuar për procedurën e konsultimit për analizë të tregut e vendosur në nenin 82 të këtij ligji nuk do të përfshihet në kushtet e procedurës së analizës së tregut të referuar në këtë paragraf. Periudha për procedurën e analizës së tregut mund të vazhdohet me një vendim të arsyetuar të Autoritetit, por jo më shumë se tre (3) herë dhe jo më shumë se tre (3) muaj për çdo herë. Autoriteti do të përpiqet që ta kompletojë analizën e tregut brenda një periudhe sa më të shkurtër kohore të mundshme. Analiza e tregut do të kompletohet me një vendim të Autoritetit për rezultatet e analizës së tregut, që do t'i

inkorporojë rezultatet e çdo faze të kompletuar të analizës së tregut, referuar në paragrafin 4 të këtij neni.

9. Në rrethana të jashtëzakonshme, kur Autoriteti konsideron se ka nevojë urgjente për të vepruar duke iu shmangur procedurave të konsultimit të përcaktuara në nenin 82 të këtij ligji, ashtu që ta ruajë konkurrencën dhe t'i mbrojë interesat e shfrytëzuesve, mund të miratojë menjëherë masa proporcionale dhe të përkohshme, p.sh. ta përcaktojë një treg relevant, t'i identifikojë ose të mos i identifikojë ndërmarrjet me FNT për një treg relevant dhe/ose të imponojë, të mos imponojë ose ta anulojë një, apo më shumë detyrime të referuara në nenin 32 të këtij ligji për ndërmarrësit e tillë. Masat e tilla të përkohshme mund të imponohen për një periudhë jo më të gjatë se nëntë (9) muaj. Autoriteti mund t'i bëjë masat e tilla të përhershme, ose ta vazhdojë kohën për të cilën ato janë të aplikueshme sipas procedurës konsultuese të vendosur në nenin 82 të këtij ligji.

10. Autoriteti do ta bëjë analizën e tregut relevant jo më pak se njëherë në çdo tri (3) vite nga vendimi i kaluar përfundimtar i Autoritetit për rezultatet e analizës së tregut. Periudha e referuar në këtë paragraf mund të vazhdohet deri në tri (3) vite shtesë me vendim të Autoritetit. Kur Autoriteti mendon se faktet që arsyetojnë vendimin e Autoritetit për rezultatet e analizës së tregut kanë ndryshuar dhe nuk reflektojnë situatën aktuale në tregun relevant, Autoriteti do të përsërisë analizën e tregut relevant.

11. Autoriteti do ta publikojë në Ueb faqen e vet listën e tregjeve relevante për të cilat ndërmarrjet me FNT janë identifikuar dhe listën e ndërmarrjeve me FNT, si dhe detyrimet e imponuara për to, duke përfshirë informacionin për masat e shprehura në paragrafin 9 të këtij neni dhe çdo ndryshim në informacionin e tillë në faqen elektronike të Autoritetit.

12. Me rastin e kryerjes së një analize të tregut, të vendosjes se a ka një ndërmarrje FNT dhe të imponimit të detyrimeve për ndërmarrjet me FNT, Autoriteti do të marrë parasysh dispozitat relevante të traktateve dhe/ose marrëveshjeve ndërkombëtare dhe do të sigurojë brenda fushës së kompetencave të veta, pajtueshmërinë me dhe zbatimin e traktateve dhe/ose marrëveshjeve të tilla në Republikën e Kosovës. Kur zbatohet dhe sigurohet pajtueshmëria me traktatet dhe/ose marrëveshjet ndërkombëtare dhe mutatis mutandis që janë subjekt i procedurës së konsultimit të përcaktuara në nenin 82 të këtij ligji, Autoriteti ka të drejtë të imponojë, ndryshojë, ose anulojë detyrimet e referuara në nenin 32 të këtij ligji për ndërmarrjet që janë të ndryshme nga ato me FNT në një treg relevant.

Neni 32

Imponimi i detyrimeve për ndërmarrësit që kanë FNT në një treg relevant

1. Autoriteti ka të drejtë që t'i imponojë detyrimet në vijim për ndërmarrësit që kanë FNT në një treg relevant, duke marrë parasysh përshtatjen e tyre në secilin rast specifik dhe caktimin e momentit të fillimit me kohë për përmbushjen e detyrimeve të tilla:

1.1. detyrimi i transparencës sipas dispozitave të nenit 34 të këtij ligji;

1.2. detyrimi i jodiskriminimit sipas dispozitave të nenit 33 të këtij ligji;

1.3. detyrimi i ndarjes së llogarive sipas dispozitave të nenit 35 të këtij ligji;

1.4. detyrimi për ofrim të qasjes sipas dispozitave të nenit 36 të këtij ligji;

1.5. detyrimi i kontrollit të çmimit dhe llogaritjes së kostos sipas dispozitave të nenit 35 të këtij ligji.

2. Në rastet e referuara në nenin 38, nenin 39 dhe nenin 64 të këtij ligji, ndërmarrësit me FNT në një treg relevant duhet t'i përmbushin detyrimet relevante pa vendim të veçantë të Autoritetit. Gjithashtu, pa vendim të veçantë të Autoritetit, ndërmarrësit duhet t'i përmbushin detyrimet shtesë të specifikuar në nenin 34 të këtij ligji. Autoriteti ka të drejtë ta vendosë momentin e fillimit të kohës për përmbushjen e detyrimeve të lartpërmendura. Në rast se nuk e bën këtë, ndërmarrësi duhet t'i përmbushë detyrimet e referuara në këtë paragraf që nga momentit që identifikohet se ai ka FNT në një treg relevant.

3. Autoriteti ka të drejtë që t'i imponojë detyrime specifike të detajuara pa tejkalluar detyrimet e referuara në paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni.

4. Në rrethana të veçanta (p.sh. aty ku Autoriteti, duke marrë parasysh paragrafin 6. të këtij neni dhe/ose paragrafin 12. të nenit 31 të këtij ligji, arrin në përfundim se detyrimet e referuara në paragrafët 1., 2. dhe 3. të këtij neni nuk do të mjaftojnë për të arritur objektivat e paraqitura në paragrafin 1. të nenit 31 të këtij ligji), Autoriteti ka të drejtë që operatorëve me FNT t'i imponojë detyrime tjera për qasje, përfshirë interkoneksionin, të tjera nga ato të paraqitura në paragrafin 1., 2. dhe 3. të këtij neni. Autoriteti duhet të marrë mendimin e Komisionit Kosovar të Konkurrencës për detyrimet tjera të referuara në këtë paragraf. Vendimi përfundimtar merret nga Autoriteti.

5. Autoriteti ka të drejtë që këtyre detyrimeve t'u shtojë kushtet që sigurojnë paanësinë, arsyeshmërinë dhe kohëzgjatjen. Autoriteti ka të drejtë që t'i specifikojë detyrimet e dhëna në këtë nen dhe t'i formulojë kushtet e përmbushjes së tyre duke miratuar, për rastet e dhëna në këtë ligj, rregullat, procedurat dhe/ose kushtet e detyrueshme për të gjithë ndërmarrësit që duhet t'i përmbushin detyrimet relevante, si dhe duke imponuar, në të gjitha rastet, detyrimet specifike të detajuara dhe/ose kushtet e përmbushjes së tyre për ndërmarrësit e veçantë.

6. Detyrimet e imponuara nga Autoriteti për ndërmarrësit duhet të jenë të arsyeshme, të bazuara në natyrën e problemit të identifikuar, proporcionale dhe të justifikueshme nga pikëpamja e parimeve dhe objektivave për rregullimin e aktiviteteve të komunikimeve elektronike të referuara në nenin 3 të këtij ligji.

7. Aty ku është vendosur mbi baza të një analize të tregut relevant se karakteristikat e tregut nuk justifikojnë imponimin e detyrimeve të referuara në këtë nen dhe/ose që nuk ka ndërmarrje që ka FNT në tregun në fjalë, Autoriteti nuk do të imponojë, sipas procedurës dhe kushteve të specifikuar në këtë ligj, detyrimet e referuara në këtë nen dhe/ose do të anulojë, nëse ka, detyrimet e imponuara për ndërmarrjet që kanë FNT. Me rastin e anulimit të detyrimeve, Autoriteti mund që me një vendim të arsyeshëm ta caktojë datën përfundimtare për zbatimin e tyre, e që nuk duhet të jetë më vonë se njëzet e tetë ditë (28) ditë nga vendimi i Autoritetit për rezultatet e analizës së tregut.

8. Pasi të jetë bërë një analizë e përsëritur e tregut, Autoriteti mund t'i ndryshojë detyrimet e imponuara duke aplikuar mutatis mutandis, sipas dispozitave të këtij neni për imponimin e detyrimeve.

Neni 33

Detyrimi i mosdiskriminimit

1. Autoriteti mund të imponojë detyrimet për jodiskriminim sa i përket qasjes për një operator që ka FNT në një treg relevant ashtu që operatori të mos bëj diskriminim ndaj ndërmarrësve tjerë, dhe veçanërisht që të zbatojë kushte ekuivalente në rrethana ekuivalente për ndërmarrësit e tjerë që ofrojnë shërbime ekuivalente, dhe të ofrojë shërbime dhe informacion për të tjerët me kushte të njëjta dhe me kualitet të njëjtë siç i ofron për vet shërbimet e veta, ose për ato të nën-njësive ose degëve të veta.

2. Autoriteti do t'i imponojë detyrimet e përcaktuara në paragrafin 1., të këtij neni aty ku është e nevojshme për të garantuar që ndërmarrësit e integruar vertikalisht, duke përfshirë edhe ndërmarrësit të kontrolluar nga shteti apo komunat, të cilat ofrojnë rrjete të komunikimeve elektronike të ndërtuara si subjekt i të drejtave ekskluzive ose speciale dhe që kanë FNT, të mos diskriminojnë kundër ndërmarrësve të tjerë duke iu dhënë përparësi operimeve të veta.

3. Autoriteti mund të kërkojë që ndërmarrësi që ka FNT në një treg relevant, sipas procedurës dhe kushteve të vendosura nga Autoriteti, të sigurojë arritjen e marrëveshjeve për sa i përket ofrimit të shërbimeve relevante të interkoneksionit dhe/ose qasjes, duke përfshirë shërbimet shoqëruese nga ndërmarrësi që ka FNT.

Neni 34

Detyrimi për transparencë

1. Autoriteti, pavarësisht nga dispozitat e nenit 18, mund t'i imponojë detyrimet për transparencë në lidhje me interkoneksionin dhe/ose qasjen dhe të kërkojë që ndërmarrësi me FNT ta publikojë informacionin e specifikuar nga Autoriteti, duke përfshirë:

1.1. informacion për kontabilitetin;

1.2. specifikimet teknike;

1.3. karakteristikat/ veçoritë e rrjetit;

1.4. termat dhe kushtet për dhënie dhe përdorim, duke përfshirë çdo kusht që kufizon qasjen dhe/ose përdorimin e shërbimeve dhe aplikacioneve aty ku kushtet e tilla janë të lejuara me akte ligjore;

1.5. tarifatat, duke përfshirë zbritjet.

2. Autoriteti mund të kërkojë nga operatorët që kanë FNT në një treg relevant ta publikojnë një ofertë referimi për ofrimin e qasjes dhe të shërbimeve shoqëruese sipas kushteve të paraqitura nga Autoriteti, duke përfshirë kërkesat për përmbajtjen e ofertave të referimit. Oferta duhet të jetë mjaft e detajuar për të garantuar që nuk do të kërkohet nga ndërmarrësit që të paguajnë për facilitetet që nuk janë të nevojshme për shërbimin e kërkuar, duke dhënë një përshkrim për ofertat relevante që janë ndarë në komponente sipas nevojave të tregut dhe për termat dhe kushtet shoqëruese duke përfshirë çmimet e arsyetuara. Autoriteti ka të

drejtë që të kërkojë për operatorin që ka ndryshim të FNT, brenda një periudhe të kufizuar të caktuar nga Autoriteti, termat dhe kushtet e një oferte referimi për të dhënë efekt në detyrimet e imponuara me këtë ligj për operatorët me FNT.

3. Autoriteti mund të specifikojë informacionin e saktë që duhet të vihen në dispozicion sipas paragrafëve 1., 2. dhe 5. të këtij neni, nivelin e kërkuar të detajuar, mënyrën e publikimit dhe kushtet tjera të publikimit.

4. Informacioni i referuar në paragrafët 1., 2. dhe 5. të këtij neni, duke përfshirë pikat gjeografike të interkoneksionit të rrjetit, kushtet e testimit të interkoneksionit, kushtet e pagesës dhe bashkëshfrytëzimit të infrastrukturës së komunikimeve elektronike, kushtet për përzgjedhjen e ofruesit të shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe të tarifave, mund të mos konsiderohet informacion konfidencial.

5. Operatori që ka për detyrë ofrimin e 'shitjes me shumicë' të qasjes në infrastrukturën e rrjetit dhe/ose qasjes së lirë (unbundled) në lakun lokal duhet ta publikojë një ofertë referente sipas kushteve të vendosura nga Autoriteti duke përfshirë kërkesat për përmbajtjen e ofertave referente. Dispozitat e paragrafëve 1. dhe 2. të këtij neni do të zbatohen në ofertën e tillë referente.

Neni 35

Detyrimi për ndarjen e llogarive

1. Autoriteti mund t'i imponojë detyrimet për ndarjen e llogarive për aktivitetin e veçantë ose aktivitetet për qasjen në operatorin që ka FNT në një treg relevant.

2. Autoriteti vendos rregullat për ndarje të llogarive dhe kërkesat lidhur me të, duke përfshirë kërkesën për auditim.

3. Autoriteti mund të kërkojë nga një kompani e integruar vertikalisht që të bëjë transparente çmimet me shumicë dhe çmimet e transfereve të saj të brendshëm, ndër të tjera për të garantuar përputhshmërinë aty ku ka kërkesë për jodiskriminim sipas nenin 33 të këtij ligji ose, aty ku është e domosdoshme, për të parandaluar kryq-subvencionimet e padrejta. Autoriteti mund ta specifikojë formën dhe metodologjinë e llogaritjes që do të përdoret.

4. Në mënyrë që të lehtësohet verifikimi i përputhshmërisë me detyrimet të referuara në nenet 33 dhe 34 të këtij ligji, Autoriteti mund të kërkojë që të dhënat e llogarive, përfshirë të dhënat për të ardhurat e pranuar nga palët e treta, të jepen me kërkesë në mënyrën dhe formën e përcaktuar me rregullat për ndarjen e llogarive të referuar në paragrafin 2 të këtij neni. Autoriteti do ta publikojë këtë informacion nëse është e domosdoshme për të kontribuar për një treg të hapur dhe konkurrues. Në veprimin e tillë, Autoriteti do të marrë parasysh rregullat që lidhen me informacionin konfidencial.

Neni 36

Detyrimet për ofrimin e qasjes dhe interkoneksionit

1. Autoriteti mund t'i imponojë detyrime për një operator që ka FNT në tregun përkatës për t'i plotësuar kërkesat e arsyeshme të ndërmarrësve tjerë për qasje dhe përdorim të elementeve të veçantë të rrjetit dhe të faciliteteve shoqëruese, përfshirë:

1.1 ofrim qasje palëve të treta në elementet e veçanta të rrjetit dhe/ose faciliteteve, duke përfshirë qasjen në elementet e rrjetit që nuk janë aktivë dhe/ose qasjen e lirë në lakun lokal për të lejuar, ndër të tjera, zgjedhjen dhe/ose para-zgjedhjen e bartësit (operatorit) dhe/ose ofrimin e rishitjes së linjës së parapaguesit;

1.2 ofrimin e shërbimeve të veçanta të shitjes me shumicë, për t'u rishitur nga palët e treta;

1.3 mosanulimin e qasjes në facilitete, tashmë të dhënë;

1.4 negocimin me dëshirën e mirë dhe me mirëbesim me ndërmarrësit, që kërkojnë qasje;

1.5 ofrimin e qasjes së hapur në ndërfaqet teknike, protokollet ose teknologjitë e tjera të rëndësishme, të domosdoshme për interoperabilitetin e shërbimeve, ose për shërbimet e rrjetit virtual;

1.6 ofrimin e përdorimit të përbashkët të hapësirave, ose formave të tjera të bashkëshfrytëzimit të faciliteteve shoqëruese;

1.7 ofrimin e shërbimeve të veçanta të nevojshme për të siguruar interoperabilitetin e shërbimeve nga një pikë në pikën tjetër fundore për shfrytëzuesit, duke përfshirë facilitetet për shërbimet e rrjeteve inteligjente ose roaming-ut në rrjetet mobile;

1.8 ofrimin e qasjes në Sistemet Operacionale Mbështetëse ose sistemet e ngjashme softuerike, të domosdoshme, për të siguruar konkurrencë të ndershme në ofrimin e shërbimeve;

1.9 interkonektimin e rrjeteve ose faciliteteve të rrjetit, duke përfshirë mundësinë e interkonektimit të rrjeteve në çdo pikë të rrjetit, aty ku kjo është teknikisht e mundshme;

1.10 ofrimin e qasjes në shërbimet shoqëruese, siç janë shërbimet e identitetit, vendndodhjes dhe pranisë.

2. Për miratimin e një vendimi për imponimin, ose anulimin e detyrimeve dhe veçanërisht për vlerësimin se si detyrimet e tilla do të imponohen sipas paragrafit 1. të këtij neni, Autoriteti do të marrë parasysh parimet dhe objektivat e këtij ligji, si dhe faktorët në vijim:

2.1 realizueshmërinë teknike dhe ekonomike për përdorimin ose instalimin e faciliteteve konkurruese, në pikëpamje të shkallës së zhvillimit të tregut, duke pasur parasysh natyrën dhe tipin e interkoneksionit dhe/ose të llojit të qasjes, si dhe realizueshmërinë e qasjes në pajisjet shoqëruese të tilla, si qasja në tubacione;

2.2 mundësinë e ofrimit të qasjes së kërkuar, në relacion me kapacitetet (resurset) në dispozicion;

2.3 investimin fillestar nga pronari i faciliteteve, duke marrë parasysh çfarëdo investimi publik të bërë dhe rrezikun e përfshirë në investimin e tillë;

2.4 nevojën për të garantuar konkurrencën në terma afatgjatë duke i kushtuar vëmendje të veçantë konkurrencës infrastrukturore në aspektin e efikasitetit ekonomik;

2.5 të gjitha të drejtat e pronësisë intelektuale.

3. Me rastin e imponimit të detyrimeve ndaj një operatori për ofrimin e qasjes sipas dispozitave të këtij neni, Autoriteti mund t'i vendosë kushtet teknike, ose operative që duhet të plotësohen nga ofruesi dhe/ose përfituesit e qasjes së tillë atëherë kur është e nevojshme për të garantuar funksionimin normal të rrjetit.

Neni 37

Qasja

1. Ndërmarrësit që janë të përfshirë ligjshëm në një aktivitet të komunikimeve elektronike kanë të drejtë që lirshëm të negociojnë qasjen. Operatorët kanë të drejtë dhe, kur të kërkohet nga operator të tjerë ose nga ofrues të shërbimeve të komunikimeve elektronike që synojnë ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike të mundshme për publikun ose që të sigurojnë ofrimin e tyre, obligim për të negociuar interkonektimin e rrjetit për të garantuar ofrimin dhe interoperabilitetin e shërbimeve.

2. Autoriteti do të inkurajojë dhe aty ku është e përshtatshme të garantojë, në përputhje me procedurën e vendosur nga ky ligj, qasje adekuate dhe pajtueshmëri të shërbimeve për të përkrahur efikasitetin, konkurrencën afatgjate, inovacionet dhe investimet efektive, si dhe arritjen e përfitimeve maksimale të mundshme për shfrytëzuesit fundorë. Me një qëllim të tillë të qartë Autoriteti ka të drejtë që t'i imponojë, në përputhje me procedurën e vendosur nga ky ligj, detyrimet për ndërmarrësit me fuqi të ndjeshme tregu, si dhe për ndërmarrësit tjerë, veçanërisht:

2.1 detyrimet, deri në masën që është e nevojshme për të garantuar lidhje të vazhdueshme prej një pike në pikën tjetër fundore, për ndërmarrësit që kontrollojnë qasjen në shfrytëzuesit fundorë, duke përfshirë detyrimet për të ndërlidhur rrjetat e tyre aty ku kjo nuk është bërë ende;

2.2 detyrimet, deri në masën që është e nevojshme për të garantuar mundësinë e qasjes për shfrytëzuesit fundorë në shërbimet specifike të transmetimit digjital të radios dhe televizionit, për operatorët për të garantuar qasjen në ndërfaqet e programeve aplikative dhe udhëzuesit e programeve elektronike në kushte të paanshme, të arsyeshme dhe jodiskriminuese;

2.3 në raste të justifikueshme dhe deri në masën që është e nevojshme, detyrimet për ndërmarrësit që kontrollojnë qasjen në shfrytëzuesit fundorë për t'i bërë shërbimet e tyre interoperabile (ndërvepruese).

3. Detyrimet për ofrimin e qasjes të imponuara nga Autoriteti dhe/ose kushtet e ndërlidhura të imponuara në këtë mënyrë duhet të jenë objektive, transparente, proporcionale dhe jodiskriminuese dhe vendimet përkatëse duhet të merren sipas rregullave të zbatuara në rastet e specifikuara në nenin 82 të këtij ligji dhe rregullave të paraqitura në nenin 32 të këtij ligji.

4. Në rastin e referuar në paragrafin 2. të këtij neni, një ndërmarrës mund të refuzojë që të ofrojë, në mënyrë të njëanshme ta pezullojë ose të ndërpres qasjen vetëm në rast se veprimet e tilla janë të bazuara në kritere objektive, duke përfshirë jorealizueshmërinë teknike, ose domosdoshmërinë për të siguruar integritetin e rrjetit.

5. Ndërmarrësit duhet të garantojnë që çdo informacion i marrë nga ndërmarrësit tjerë para, gjatë, ose pas negociatave për qasje, me përjashtim të informacionit që mund të mos jetë konfidencial sipas procedurave, rasteve dhe kushteve të përcaktuara në këtë ligj, do të përdoret vetëm për qëllimin për të cilin ai është ofruar dhe do të respektojnë konfidencialitetin e informacionit të transmetuar ose ruajtur. Informacioni i tillë nuk bën t'i jepet asnjë pale tjetër, në veçanti nënndarjeve, degëve ose partnerëve tjerë për të cilët informacioni i tillë mund të ishte një avantazh konkurrimi. Autoriteti mund t'i miratojë rregullat që detajizojnë masat për të siguruar kërkesat e tilla.

6. Me rastin e zgjidhjes së një mosmarrëveshjeje në mes ndërmarrësve, Autoriteti ka të drejtë, në pajtim me parimet e vendosura nga ky ligj dhe në rastet e justifikuara me objektivat e saj, që të nxjerrë, me vetë iniciativën e saj ose sipas procedurës së vendosur në Kreun XIII të këtij ligji, një vendim për dhënien e qasjes, që do të jetë detyrues për ndërmarrësit, duke përfshirë imponimin e detyrimeve për qasje të veçanta, që përfshijnë interkoneksionin, siç specifikohet në paragrafin 2. të këtij neni.

7. Autoriteti ka të drejtë që t'i miratojë rregullat për dhënien dhe ofrimin e qasjes, duke përfshirë interkoneksionin e rrjetit.

Neni 38

Detyrimi për zgjedhjen dhe parazgjedhjen e bartësit

1. Ndërmarrësit që kanë FNT në tregun përkatës për qasje në dhe shfrytëzim të rrjetit telefonik publik në lokacionin fiks, në përputhje me procedurën dhe kushtet e përcaktuara nga Autoriteti, do t'u mundësojnë, në llogari të vetë, parapaguesve të tyre qasjen në shërbimet e çdo ofruesi të shërbimeve telefonike të disponueshme për publikun, me të cilët janë të interkonektuar, nëpërmjet zgjedhjes ose parazgjedhjes së bartësit.

2. Tarifat e vendosura për qasjen dhe për pagesën e aktivizimit të zgjedhjes ose parazgjedhjes duhet të jenë të bazuara në kosto. Për këtë qëllim, do të zbatohen rregullat e vendosura në nenin 40 të këtij ligji. Tarifat e imponuara parapaguesve për shfrytëzimin e të drejtave të tilla nuk duhet të shërbejnë si dekurajim për përdorimin e një mundësie të tillë. Për këtë qëllim, Autoriteti mund t'i kufizojë tarifat maksimale.

3. Detyrimet e referuara në paragrafin 1. të këtij neni mund të imponohen nga Autoriteti ndaj çdo ndërmarrësi që ka FNT në tregun relevant, si edhe për imponimin e detyrimeve në lidhje me nën-paragrafin 1.4. të paragrafit 1. të nenit 32 të këtij ligji.

Neni 39

Detyrimi për ofrimin e linjave të huazuara

1. Ndërmarrësi që ka FNT në tregun relevant të linjave të huazuara duhet ta ofrojë një grup të linjave të tilla sipas vendimeve nga Autoriteti dhe të pajtohet me procedurën dhe kushtet për dhënien e shërbimeve të tilla të përcaktuara në rregullat e miratuara nga Autoriteti, gjithashtu të plotësojë detyrimet në lidhje me jodiskriminimin, çmimet e bazuara në kosto duke përfshirë futjen në përdorim dhe shfrytëzimin e një sistemi për llogaritje të kostos, transparencën dhe krijimin e kushteve për ofrimin e shërbimeve.

2. Ndërmarrësi që ka FNT në një treg relevant të linjave të huazuara duhet të ofrojë shërbimet e linjave të huazuara me çmime që rrjedhin (derivojnë) nga koston, duke përfshirë një tarifë të arsyeshme të kthimit të investimit. Për këtë qëllim, Autoriteti mund të vendosë nivelin më të lartë të çmimit për shërbimet e linjave të huazuara. Paragrafët 4. dhe 5. të nenit 40 të këtij ligji do të zbatohen *mutatis mutandis*, për çmimet e bazuara në kosto dhe llogaritjen e koston.

Neni 40

Detyrimi për kontroll të çmimeve dhe sistemin e llogaritjes së koston

1. Autoriteti mund t'ua imponojë ndërmarrësve që kanë FNT në një treg relevant detyrime për mbulimin e koston dhe kontrollimin e çmimit, duke përfshirë detyrimet për çmimet e bazuara në kosto dhe detyrimet lidhur me sistemet e llogaritjes së koston, për ofrimin e llojeve specifike të interkoneksionit dhe/ose qasjes, në situatat kur një analizë e tregut tregon mundësi të konkurrencës së efektshme që do të thotë që operatori përkatës mban çmimet në një nivel tepër të lartë, ose mund të zbatojë një ngjeshje të çmimeve, në dëm të shfrytëzuesve fundorë.

2. Me rastin e imponimit të detyrimeve, duhet të merret parasysh e drejta e operatorit për një normë të arsyeshme të kthimit të investimit.

3. Mekanizmi i mbulimit të koston dhe/ose metodologjia e caktimit të çmimit që janë të detyrueshme duhet të përkrahin efikasitetin dhe konkurrencën afatgjate dhe të rrisin përfitimet e konsumatorit. Në lidhje me këtë Autoriteti mund t'i marrë parasysh çmimet në tregjet konkurruese të krahasueshme.

4. Kur një operator ka një detyrim në lidhje me orientimin në kosto të çmimeve të tij, barra e argumentimit që çmimet janë të bazuara në kosto duke përfshirë një normë të arsyeshme të kthimit të investimeve do t'i bie operatorit përkatës. Autoriteti mund të përcaktojë rregullat për llogaritjen e koston me qëllim të llogaritjes së koston për ofrimin sa më efikas të shërbimeve. Autoriteti mund të kërkojë nga një operator i cili ka një detyrim në lidhje me orientimin në kosto të çmimeve të tij që të japë një justifikim të plotë për çmimet e tij dhe mund të caktojë një afat kohor të arsyeshëm të detyrueshëm për dorëzimin e justifikimit të tillë. Nëse operatori dështon që ta japë justifikimin për çmimet e tij para skadimit të afatit të

vendosur, do të konsiderohet se çmimet e tij nuk janë të bazuara në kosto. Autoriteti ka të drejtë të kërkojë që të dhënat e paraqitura nga operatori të auditohen. Autoriteti ka të drejtë të kërkojë që çmimet të rregullohen ose që të vendoset niveli më i lartë i çmimit. Derisa një operator, i cili e ka një detyrim në lidhje me orientimin në kosto të çmimeve, ta japë justifikimin e plotë për çmimet e tij, Autoriteti mund të vendosë çmime të përkohshme të nivelit më të lartë duke parasysh të dhënat për kostot përkatëse të marra në bazë të metodave indirekte të vlerësimit të kostos, duke përfshirë krahasimet e çmimeve për shërbimet relevante duke pasur parasysh praktikën më të mira të vendeve anëtare të BE-së, praktikën e vendeve në një nivel të ngjashëm të zhvillimit dhe praktikën e Republikës së Kosovës, si dhe vlerësimit të raportit në mes të çmimeve relevante me shumicë dhe pakicë.

5. Nëse Autoriteti kërkon që të zbatohet një sistem i llogaritjes së kostos për kontroll të çmimit, operatori duhet që brenda afatit të caktuar dhe sipas procedurës dhe kushteve të përcaktuara nga Autoriteti të përgatisë një sistem të llogaritjes së kostos, të bëjë përshkrimin e tij dhe të publikojë atë, t'ia paraqesë atë Autoritetit dhe të punojë në pajtueshmëri me të. Sistemi i llogaritjes së kostos dhe mënyra e publikimit të tij duhet të jenë në pajtim me rregullat e llogaritjes së kostos të përcaktuara nga Autoriteti. Autoriteti ka të drejtë që të krijojë sistemin për llogaritjen e kostos, metodologjinë dhe/ose formatin që do të përdoret nga një operator ose operatorët që kanë FNT në një treg relevant. Autoriteti do t'i bëjë publike sistemin e llogaritjes, metodologjinë dhe/ose formatin duke i publikuar ato në ueb faqen e vet. Pajtueshmëria me rregullat e llogaritjes së kostos dhe aktet e tjera ligjore, si dhe me sistemin e llogaritjes së kostos, metodologjinë dhe/ose formatin e përgatitur nga operatori dhe/ose krijuar nga Autoriteti do të verifikohen nga një auditim. Mendimi i audituesit duhet të publikohet çdo vit sipas rregullave të caktuara nga Autoriteti.

Neni 41

Transmetimi i televizionit digjital

Ofruesit e rrjeteve të komunikimeve elektronike që shfrytëzohen për transmetimin e shërbimeve të televizionit digjital do të garantojnë mundësinë për të ofruar shërbime dhe programe të televizionit digjital. Operatorët që marrin dhe ritransmetojnë shërbime dhe programe të televizionit digjital duhet të mbajnë të njëjtin format.

Neni 42

Shërbimet me qasje të kushtëzuar dhe facilitetet shoqëruese

1. Ndërmarrësit që kontrollojnë sistemet me qasje të kushtëzuar duhet t'i përdorin vetëm sistemet e tilla të qasjes së kushtëzuar për shërbimet digjitale të radios dhe/ose televizive pavarësisht nga mënyrat e transmetimit, që duhet të kenë aftësinë e duhur teknike për kontroll të qasjes së kushtëzuar (p.sh. procedurat teknike që mundësojnë transferimin e kontrollit të qasjes së kushtëzuar nga një transmetues tek transmetuesi tjetër), duke lejuar mundësinë e kontrollit të plotë në nivelin lokal apo rajonal të shërbimeve nga operatorët që përdorin sistemet e tilla.

2. Ndërmarrësit që ofrojnë shërbime të qasjes së kushtëzuar për shërbimet digjitale të radios dhe/ose televizive pavarësisht nga mënyrat e transmetimit, transmetime këto që kushtëzojnë ofrimin e shërbimeve çfarëdo grupi të shikuesve, ose dëgjuesve potencialë pavarësisht nga mënyrat e transmetimit, duhet:

2.1. ofruar të gjithë transmetuesve, në baza të drejta, të arsyeshme dhe jodiskriminuese, shërbimet teknike që mundësojnë që shërbimet e transmetuara në mënyrë digjitale të pranohen nga shikuesit, ose dëgjuesit e autorizuar nëpërmjet dekoderëve të ofruar dhe administruar nga ofruesit e shërbimeve (operatorët);

2.2. që nëse ndërmarrësit janë të përfshirë në aktivitete të tjera përveç ofrimit të qasjes së kushtëzuar për shërbimet digjitale të radios dhe/ose televizive, atëherë të mbajnë llogari të veçantë financiare për aktivitetin e tyre si ofrues i qasjes së kushtëzuar në përputhje me rregullat për ndarjen e llogarive të përcaktuara nga Autoriteti dhe në pajtim me kërkesat për ndarjen e llogarive, duke përfshirë kërkesën e auditimit.

3. Autoriteti ka të drejtë të përcaktojë procedurën dhe kushtet për zbatimin e dispozitave të paragrafëve 1. dhe 2. të këtij neni.

4. Autoriteti ka të drejtë të përcaktojë kërkesat për ofrimin dhe përdorimin e udhëzuesve elektronik të programeve dhe faciliteteve të ngjashme listuese dhe të navigimit.

Neni 43

Masat e veçanta që garantojnë konkurrencë efektive

1. Ndërmarrjet publike qendrore apo lokale ose që zotërojnë të drejta ekskluzive apo të veçanta, që kanë fuqi të ndjeshme tregu në një pjesë të konsiderueshme të tregut të zakonshëm për ofrimin e rrjeteve publike të komunikimit dhe shërbimeve telefonike të mundshme për publikun dhe që kontrollojnë një rrjet të instaluar të televizionit kabllor duke përdorur të drejtat ekskluzive, ose të veçanta që i ka zotëruar apo i zotëron në territorin e njëjtë gjeografik, mund të ofrojnë një rrjet të televizionit kabllor vetëm përmes personit juridik, i ndryshëm nga personi juridik që është përcaktuar për ofrimin e një rrjeti publik të komunikimeve.

2. Ofruesit e rrjeteve publike të komunikimeve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike të mundshme për publikun, të cilëve u janë dhënë, gjithashtu të drejta speciale ose të veçanta për ofrimin e shërbimeve në sektorët e tjerë ekonomikë të Republikës së Kosovës, do të mbajnë llogari të ndara për aktivitetet për ofrimin e rrjetave dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike në përputhje me rregullat për ndarje të llogarive dhe me kërkesat e ndërlidhura, duke përfshirë kërkesën për auditim dhe kërkesën për të pasur ndarje strukturale për aktivitetet në lidhje me ofrimin e rrjetave dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, siç janë përcaktuar nga Autoriteti. Autoriteti ka të drejtë që të specifikojë kërkesat për ndarje strukturale.

3. Paragrafi 2 i këtij neni nuk do të zbatohet për ndërmarrësit qarkullimi vjetor i të cilëve në aktivitetet me rrjetat dhe/ose shërbimet e komunikimeve elektronike në Republikën e Kosovës është më i vogël se treqindmijë (300,000) Euro.

4. Çdo ndërmarrës që ofron rrjete publike të komunikimeve elektronike ose shërbime të komunikimeve elektronike të mundshme për publikun, me përjashtim të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, duhet të sigurohet që raportet e tyre vjetore financiare janë të audituara dhe të publikuara. Kjo dispozitë, gjithashtu do të zbatohet për të gjitha llogaritë e ndara që

mbahen sipas paragrafit 2 të këtij neni. Autoriteti ka të drejtë që të specifikojë procedurën dhe kushtet për zbatimin e dispozitave të këtij paragrafi.

Neni 44

Masat që garantojnë interoperabilitetin e komunikimeve elektronike

1. Autoriteti do të miratojë akte ligjore të cilat detyrojnë pajtueshmërinë me standardet e vendosura nga organizatat ndërkombëtare dhe evropiane të standardizimit që janë të transpozuar në standardet kosovare në përputhje me procedurat e përcaktuara, si dhe me standardet origjinale kosovare, specifikimet dhe/ose rekomandimet ndërkombëtare dhe evropiane për ofrimin e shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike, si dhe të faciliteteve dhe shërbimeve shoqëruese duke përfshirë transmetimet e programeve të radios dhe/ose televizive, ndërfaqet teknike dhe/ose funksionet e rrjetit dhe interoperabilitetin e pajisjeve fundore, duke përfshirë pajisjet për pranimin e programeve të radios dhe televizive. Një person fizik, ose juridik konsiderohet se i ka përmbushur detyrimet e pajtueshmërisë me standardet e Kosovës në fushat e lartpërmendura nëse personi ka pajtueshmëri me standardet relevante ndërkombëtare, ose evropiane, si dhe me standardet relevante kosovare që transpozojnë standardet ndërkombëtare, ose evropiane.

2. Derisa standardet ndërkombëtare ose evropiane në fushat e referuara në paragrafin 1. të këtij neni nuk janë transpozuar brenda standardeve kosovare, Autoriteti mund të kërkojë pajtueshmëri të drejtpërdrejtë me standardet relevante për ofrimin e shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike. Pasi që të jetë transpozuar standardi relevant brenda standardit kosovar, çdo referim në standardin ndërkombëtar ose evropian do të konsiderohet se është një referim në standardin relevant kosovar. Një person ose ndërmarrës konsiderohet se e ka përmbushur detyrimin e pajtueshmërisë me standardet ndërkombëtare ose evropiane në fushat e referuara në paragrafin 1. të këtij neni nëse personi/ndërmarrësi ka pajtueshmëri me standardet relevante që transpozojnë standardet ndërkombëtare ose evropiane.

3. Kërkesat teknike të standardeve të deklaruara nga persona ose ndërmarrës që në baza vullnetare kanë paraqitur një deklaram të pajtueshmërisë së produkteve ose shërbimeve me standarde të tilla, duke përfshirë standarde ndërkombëtare, evropiane, të huaja dhe kosovare, do të jenë detyruese për ata persona/ndërmarrës.

4. Autoriteti ka të drejtë që të vendosë kërkesat teknike të pavarura në fushat e referuara në paragrafin 1. të këtij neni.

5. Pronarët e ndërfaqeve të programeve aplikative do t'i bëjnë të mundshme nën kushte të ndershme, të arsyeshme dhe jodiskriminuese dhe përkundrejt një pagese të përshtatshme, të gjithë informacionin e tillë që nevojitet për t'u mundësuar ofruesve të shërbimeve televizive digjitale që të ofrojnë të gjitha shërbimet e përkrahura nga API (ang. "Application program interface"- Ndërfaqja e programit aplikativ) në një formë të funksionimit të plotë.

6. Certifikatat e pajtueshmërisë të lëshuara nga institucionet relevante të BE-së dhe institucionet relevante të autorizuara nga vendet anëtare të BE-së për instrumentet matëse dhe standardet e pranuar në vendet anëtare të BE-së do të pranohen në Republikën e Kosovës. Procedura e pranimit të tillë do të krijohet nga Qeveria në pajtim me zotimet ndërkombëtare.

KREU VII

MENAXHIMI ME RESURSE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

Neni 45

Parimet bazë për menaxhimin me resurse të komunikimeve elektronike

1. Autoriteti, në përputhje me procedurat dhe kushtet e paraqitura në këtë ligj do të menaxhojë me resurset e komunikimeve elektronike. Spektri frekuencor (kanalet), numrat telefonik, emrat, adresat, kodi shtetëror i Internetit dhe resurset tjera të komunikimeve elektronike duhet të menaxhohen në përputhje me dispozitat e këtij ligji.
2. Spektri frekuencor (kanalet) do të menaxhohet duke u bazuar në Planin Kombëtar të Radio-frekuencave dhe Planin për përdorimin e radio-frekuencave (kanaleve) konform planeve zhvillimore për radio komunikime.
3. Numrat telefonik të shfrytëzuar në rrjetat publike të komunikimeve elektronike duhet të menaxhohen në përputhje me planin nacional të numeracionit të aprovuar nga Autoriteti. Autoriteti duhet të miratojë kushtet dhe procedurat për implementimin e “Planit nacional të numeracionit”.
4. Autoriteti duhet të përcaktojë rregulla të qarta për menaxhimin e resurseve tjera të komunikimeve elektronike.

Neni 46

Bazat për ndarjen dhe shfrytëzimin e resurseve të komunikimeve elektronike

1. Resurset e komunikimeve elektronike duhet të jepen dhe shfrytëzohen në përputhje me procedurat dhe kushtet e vendosura në këtë ligj, si dhe në rregulloret për dhënien dhe shfrytëzimin e resurseve të komunikimeve elektronike të miratuara nga Autoriteti.
2. Resurset e komunikimeve elektronike mund të shfrytëzohen:
 - 2.1. pa kurrfarë autorizimi, kur Autoriteti vendos që resurset e caktuara të komunikimeve elektronike mund të shfrytëzohen pa autorizim;
 - 2.2. pas marrjes së një autorizimi individual për shfrytëzimin e resurseve të komunikimeve elektronike të lëshuar nga Autoriteti, por duke u siguruar që resurset e komunikimeve elektronike shfrytëzohen në mënyrë efikase dhe efektive, duke siguruar kualitetin e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe shmangur interferencat e dëmshme.
3. Autoriteti konform obligimeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, radio-rregulloreve, Planit Kombëtar të Radio-frekuencave, Planit për përdorimin e radio-frekuencave (kanaleve) planeve zhvillimore radio-komunikuese, do ta bëjë ndarjen e radio frekuencave (kanaleve) dhe resurseve tjera të komunikimeve elektronike të domosdoshme

për aktivitetet që kanë të bëjnë me mbrojtjen nacionale, sigurinë nacionale, mirëmbajtjen e rendit publik, shërbimet publike emergjente, mbrojtjen e kufijve shtetërorë, aviacionin civil, sigurinë hekurudhore, operimin e sigurt dhe stabil të sistemit energjetik nacional, si dhe për funksionet tjera jokomerciale të shtetit (përfshirë shtetet e huaja) dhe institucioneve të tij.

4. Autoriteti gjatë kryerjes së funksioneve që i referohen paragrafit 3 të këtij neni nuk duhet të zbatojë dispozitat e neneve 47 – 52 të këtij ligji. Autoriteti duhet të miratojë rregulla të qarta për dhënien e resurseve të komunikimeve elektronike, të referuara në paragrafin 3 të këtij neni, duke u udhëhequr nga parimi i efikasitetit dhe efektivitetit të shfrytëzimit të frekuencave.

5. Kohëzgjatja e të drejtave për shfrytëzimin e resurseve të komunikimeve elektronike do të caktohet nga Autoriteti. Kohëzgjatja mund të prolongohet në rastet kur është përcaktuar në rregulloret për dhënien dhe shfrytëzimin e resurseve të komunikimeve elektronike dhe në pajtueshmëri me procedurat dhe kushtet e përcaktuara në to.

6. Kur shfrytëzimi i radio-frekuencave (kanaleve) është harmonizuar, është arritur marrëveshja për kushtet dhe procedurat për shfrytëzimin e tyre dhe pala të cilës do t'i jepet radio-frekuenca (kanalet) është përzgjedhur në bazë të traktateve ndërkombëtare dhe/ose marrëveshjeve, si dhe rregulloreve të Bashkimit Evropian, Autoriteti duhet t'i japë radio-frekuencat që janë subjekt i rregullave relevante. Pas procedurës së përgjithshme përzgjedhëse nëse të gjitha kushtet të vendosura nga Republika e Kosovës për shfrytëzimin e radio-frekuencave janë plotësuar, nuk lejohen vendosje shtesë të kushteve, kriterëve ose procedurave për shfrytëzimin e radio-frekuencave (kanaleve), të cilat mund ta kufizojnë, modifikojnë ose vonojnë zbatimin korrekt të procedurës së përgjithshme për dhënien e radio-frekuencave (kanaleve).

Neni 47

Dhënia e resurseve të komunikimeve elektronike

1. Nëse Autoriteti nuk e ka përcaktuar që resursi i caktuar frekuencor mund të shfrytëzohet pa ndonjë autorizim individual, personi duhet që para fillimit të shfrytëzimit të këtij resursi të aplikojë te Autoriteti në formë përshkruese për ndarje të resurseve të caktuara të komunikimeve elektronike në përputhje me procedurat dhe kushtet e vendosura në rregulloren për ndarjen dhe shfrytëzimin e resurseve të komunikimeve elektronike.

2. Kur një ndërmarrës aplikon për marrje të resurseve të komunikimeve elektronike pas procedurës së njoftimit për fillim të aktiviteve të Autoriteti, ndërmarrësi mund në momentin e aplikimit të konfirmojë se dokumentet dhe informatat e ofruara Autoritetit më herët nuk kanë ndryshuar dhe se këto informata dhe dokumente nuk kanë nevojë të ofrohen përsëri. Nëse gjatë ushtrimit të aktiviteve të ndërmarrësit ndodhin çfarëdo ndryshimesh pas njoftimit të Autoritetit për fillimin e aktiviteve në bazë të akteve juridike të lëshuara nga Autoriteti, ndërmarrësi duhet të përditësojë dokumentet dhe informatat në momentin kur aplikon për marrje të resurseve të komunikimeve elektronike.

3. Personi që kërkon radio-frekuenca (kanale) duhet t'i ofrojë Autoritetit informata për mundësitë dhe aftësitë e përmbljes së obligimeve që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e radio-frekuencave (kanaleve). Autoriteti duhet të përcaktojë se cilat informata duhet të ofrohen, si dhe procedurat për ofrimin e këtyre informatave. Autoriteti e ka të drejtën të

refuzojë dhënien e radio-frekuencave (kanaleve) personit që ka dështuar të ofrojë informatat e kërkuara apo informatat e ofruara nuk janë konform kërkesave të bëra nga Autoriteti.

4. Personi mund të fillojë të shfrytëzojë resurset e komunikimeve elektronike nga data e lëshimit të autorizimit përkatës nga Autoriteti, përveç në rastet kur është specifikuar ndryshe në autorizim. Autorizimi për shfrytëzim të resurseve të komunikimeve elektronike duhet t'iu jepet atyre personave të cilëve iu është dhënë resursi i komunikimeve elektronike në përputhje me procedurat dhe kushtet e përcaktuara nga Autoriteti.

5. Numri i autorizimeve për shfrytëzim të resurseve të komunikimeve elektronike duhet të jetë i palimituar, përveç në rastet kur kufizimet janë të domosdoshme për të siguruar shfrytëzim efektiv të radio-frekuencave (kanaleve), në rastet kur resurset e caktuara të komunikimeve elektronike kanë vlerë ekonomike të posaçme dhe/ose në rastet kur kufizimi i resurseve të komunikimeve elektronike është i pashmangshëm dhe arsyetohet duke u bazuar në principin e proporcionalitetit.

6. Gjatë miratimit të vendimit për kufizimin e numrit të autorizimeve për shfrytëzim të resurseve të komunikimeve elektronike Autoriteti duhet të:

6.1. marrë parasysh domosdoshmërinë për maksimizimin e përfitimeve për shfrytëzuesit dhe inkurajimin e konkurrencës;

6.2. ofrojë mundësinë për të gjitha palët e interesuara, përfshirë shfrytëzuesit dhe konsumatorët, të shprehin mendimin e veta për çfarëdo kufizimi në kuadër dhe në pajtueshmëri me procedurat dhe kushtet e vendosura për konsultimet publike të definuara në paragrafin 1. të nenit 82 të këtij ligji;

6.3. publikojë vendimin me arsyet për kufizim të numrit të autorizimeve për shfrytëzim të resurseve të komunikimeve elektronike;

6.4. që pas vendosjes së procedurave relevante, të publikojë thirrje për palët e interesuara për dhënie të resurseve të komunikimeve elektronike;

6.5. që kohë pas kohe, ose pas pranimit të ndonjë kërkesë të arsyetuar nga personat e interesuar, të rishikojë kufizimet.

7. Autoriteti pas konstatimit se mund të japë (ndajë) resurset e komunikimeve elektronike që janë subjekt i kufizimeve në aspekt të dhënies së autorizimeve, duhet të publikojë konkluzionet e veta dhe një thirrje për palët e interesuara për shfrytëzim të resurseve të komunikimeve elektronike. Autoriteti duhet të publikojë informatat për ndarje të resurseve të komunikimeve elektronike në pajtueshmëri të plotë me procedurat dhe kushtet e vendosura nga ai.

8. Autoriteti duhet t'iu publikojë informatat për aplikacionet e bëra nga personat me kërkesë për marrje të resurseve të komunikimeve elektronike kur numri i autorizimeve për shfrytëzim të atyre resurseve është i kufizuar. Rregullat për publikimin e informatave të tilla duhet të vendosen nga Autoriteti.

9. Autoriteti mund të rezervojë resurse specifike të komunikimeve elektronike për të

siguruar zhvillim adekuat të rrjetave dhe/ose shërbimeve dhe teknologjive të komunikimeve elektronike.

10. Vendimi për dhënie të resurseve të komunikimeve elektronike duhet të merret, t'i komunikohet aplikuesit dhe të bëhet publik sa më shpejtë që është e mundur pas pranimit të aplikacionit të kompletuar konform kërkesave të vendosura (informatat dhe dokumentet e kompletuara) nga Autoriteti brenda afatit prej njëzet e një (21) ditëve për rastin e numrave telefonik dhe dyzet e dy (42) ditë në rastin e radio-frekuencave (kanaleve). Kufizimet tjera kohore duhet të aplikohen pa paragjykime dhe bazuar në kufizimet kohore të vendosura në traktatet ndërkombëtare dhe/ose marrëveshjet tjera.

11. Nëse Autoriteti vendos që e drejta për shfrytëzim të numrave telefonik duhet të jepet nëpërmjet tenderit, apo ankandit, limiti maksimal kohor prej njëzet e një (21) ditëve i vendosur në paragrafin 10. të këtij neni duhet të zgjatet edhe për njëzet e një (21) ditë të tjera. Nëse Autoriteti vendosë që dhënia e radio-frekuencave (kanaleve) nëpërmjet tenderit apo ankandit, limiti maksimal kohor prej dyzet e dy (42) ditëve i vendosur në paragrafin 10. të këtij neni duhet të zgjatet për një përdhë kohore të domosdoshme për të siguruar procedura fer, të hapura, të arsyeshme dhe transparente për të gjitha palët e interesuara, por në çfarëdo rasti jo më gjatë se tetë (8) muaj. Ky kufizim kohor duhet të aplikohet pa prejudikim për çfarëdo kufizimi kohor të vendosur në traktatet ndërkombëtare dhe/ose marrëveshjet tjera.

12. Pagesat për të shfrytëzuar të drejtën e përdorimit të resurseve të komunikimeve elektronike duhet të paguhet në buxhetin e shtetit nga tenderuesi i suksesshëm apo fituesi i ankandit. Në rastet kur tenderuesi i suksesshëm apo fituesi i ankandit e vonon pagesën, apo pjesë të pagesës, Autoriteti e ka të drejtën të marrë vendim për imponim të obligimit në tenderuesin e suksesshëm apo fituesin e ankandit që të bëjë pagesat në kohë të caktuar dhe të vendosë kufizime kohore për pagesat në fjalë. Vendimi i marrë nga Autoriteti duhet të jetë dokument ekzekutiv. Nëse vendimi nuk është zbatuar duhet të përcillet për ekzekutim në pajtim me procedurat e vendosura në në legjislacionin në fuqi për procedurë penale. Vendimi duhet të ekzekutohet brenda afatit tre (3) vjeçar nga data e prurjes së këtij vendimi.

Neni 48

Mënyrat e dhënies së resurseve të komunikimeve elektronike

1. Autoriteti do t'i japë resurset e komunikimeve elektronike:

1.1. drejtpërdrejt personit që i kërkon ato;

1.2. nëpërmjet tenderit;

1.3. nëpërmjet ankandit.

Neni 49

Dhënia e resurseve të komunikimeve elektronike drejtpërdrejt personit kërkues

1. Autoriteti e ka të drejtën të ndajë resurset e komunikimeve elektronike në mënyrë të drejtpërdrejtë personit që i kërkon ato, në rastet kur plotësohet ndonjëri prej kushteve:

1.1. Autoriteti nuk kufizon numrin e autorizimeve për shfrytëzim të resurseve të komunikimeve elektronike të kërkuara;

1.2. pas publikimit që e bën Autoriteti për pranimin e një aplikacioni për ndarje të resurseve të komunikimeve elektronike, asnjë person tjetër nuk shpreh interes brenda afatit të caktuar kohor të përcaktuar nga Autoriteti për shfrytëzim të të njëjtit resurs, ose resurset e tilla janë të bollshme për t'iu ndarë të gjithë personave që kanë shprehur interes për atë resurs.

2. Nëse Autoriteti pranon aplikacione për ndarje të resurseve të komunikimeve elektronike nga disa persona në të njëjtën kohë dhe resurset nuk mund t'iu jepen në të njëjtën kohë të gjithë personave që i kanë kërkuar ato, resurset e tilla duhet të jepen nëpërmjet tenderit, apo ankandit publik. Aplikacionet duhet të merren parasysh ashtu si janë pranuar brenda kohës së përcaktuar nga Autoriteti, duke marrë si kohë referente publikimin e informatës për pranimin e aplikacionit të parë.

Neni 50

Dhënia e resurseve të komunikimeve elektronike nëpërmjet tenderit

Procedura tenderuese për dhënie të resurseve të komunikimeve elektronike duhet të organizohet në pajtueshmëri me procedurat e përcaktuara në rregulloret për dhënie të resurseve të komunikimeve elektronike të aprovuara nga Autoriteti dhe në bazë të kushteve të tenderit publik të miratuara nga Ministria, duke u bazuar në këtë ligj. Kushtet e tenderit duhet të specifikojnë kërkesat për kualifikim të tenderuesve, definojnë tregun në të cilin resurset e komunikimeve elektronike do të shfrytëzohen dhe vendos kushte të qarta për shfrytëzim të resurseve të komunikimeve elektronike. Kushtet tenderuese duhet të specifikojnë kriteret përzgjedhëse për zgjedhjen e tenderuesve të suksesshëm. Kriteret e përcaktuara duhet të bazohen në njohuri të specializuara dhe në performancë efektive, skema të përshtatshme operimi për ofrimin e rrjetave dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, çmimeve adekuate për shërbime, kufizimet kohore për fillimin e ofrimit të shërbimeve në treg, sasinë e investimeve, si dhe promovimin e konkurrencës efektive. Kur radio-frekuencat (kanalet) janë dhënë nëpërmjet tenderit, prioritet duhet t'iu jepet atyre tenderuesve që sigurojnë mbulueshmëri më të madhe gjeografike me shërbime për kohë më të shkurtër.

Neni 51

Dhënia e resurseve të komunikimeve elektronike nëpërmjet Ankandit

1. Rregullat e ankandit duhet të vendosen nga Autoriteti.

2. Rregullat e ankandit duhet të specifikojnë kërkesat kualifikuese për pjesëmarrësit e ankandit, definojnë tregun në të cilin do të shfrytëzohen resurset e komunikimeve

elektronike, kushtet për shfrytëzim të resurseve të komunikimeve elektronike, si dhe sasinë minimale të resurseve të komunikimeve elektronike që duhet të blihen nga pjesëmarrësi në ankand.

Neni 52

Refuzimi për dhënie të resurseve të komunikimeve elektronike

1. Autoriteti mund ta refuzojë dhënien e resurseve të komunikimeve elektronike nëse:

1.1. nuk ka resurse të komunikimeve elektronike rezervë në dispozicion. Këtu përfshihen edhe rastet kur shfrytëzimi i resurseve të caktuara të komunikimeve elektronike do të pengojë shfrytëzimin e resurseve të komunikimeve elektronike, të cilat janë tanimë në shfrytëzim;

1.2. aktivitetet e aplikuesit nuk janë konform me kërkesat e këtij ligji, kërkesave të tenderit apo ankandit, qëllimit të shfrytëzimit të resurseve të komunikimeve elektronike ose aplikuesi ka shfrytëzuar resurset e komunikimeve elektronike të ndara atij në mënyrë joefikase dhe joefektive;

1.3. aplikuesi ka dështuar të ofrojë informatat apo dokumentet e kërkuara;

1.4. aplikacioni nuk është konform me kërkesat e akteve ligjore;

1.5. informatat, ose dokumentet e ofruara nga aplikuesi janë të pasakta apo të falsifikuara;

1.6. aplikuesi nuk ka qenë i suksesshëm në procesin tenderues ose procesin e ankandit kur një procedurë e tillë është organizuar për dhënien e resurseve të komunikimeve elektronike;

1.7. aplikuesi ka dështuar të bëjë pagesat relevante, apo pagesat tjera në afatin e përcaktuar kohor.

2. Para marrjes së vendimit për refuzim të dhënies së resurseve të komunikimeve elektronike personit të caktuar, Autoriteti mund t'ia caktojë një afat kohor shtesë për personin për të rregulluar çështjet, të cilat e kanë detyruar Autoritetin që të marrë vendim refuzues. Autoriteti duhet ta informojë personin për një vendim të tillë duke specifikuar mangësitë dhe kohën valide gjatë së cilës personi duhet t'i eliminojë këto mangësi. Ky paragraf nuk duhet të aplikohet nëse për dhënien e të drejtës për shfrytëzim të resurseve të komunikimeve elektronike është organizuar tender, apo ankand publik.

Neni 53

Transferi i të drejtës për shfrytëzim të resurseve të komunikimeve elektronike

Një person mund ta transferojë të drejtën për shfrytëzim të resurseve të dhëna të komunikimeve elektronike përfshirë këtu edhe transferin e qiramarrjes, përveç transferin e radio-frekuencave, qëllimi i të cilave është radio dhe/ose TV difuzioni tek personi tjetër në rastet e specifikuar nga Autoriteti.

Neni 54
Shfrytëzimi i resurseve të komunikimeve elektronike

1. Kushtet e vendosura në rregulloret për dhënien dhe shfrytëzimin e resurseve të komunikimeve elektronike dhe në autorizimet për shfrytëzim të këtyre resurseve duhet të jenë jodiskriminuese, transparente dhe proporcionale. Termat dhe kushtet e specifikuar nga aktet juridike që rregullojnë termat dhe kushtet e përgjithshme për pjesëmarrje në aktivitetet e komunikimeve elektronike nuk duhet të përsëriten në rregulloret për dhënien dhe shfrytëzimin e resurseve të komunikimeve elektronike dhe në autorizimet për shfrytëzim të resurseve të komunikimeve elektronike.

2. Kushtet e vendosura në rregulloret për shfrytëzimin e radio-frekuencave (kanaleve) dhe në autorizimet për shfrytëzim të radio-frekuencave (kanalet) mund të përmbajnë vetëm:

2.1. përcaktimin e qëllimit për dhënie (llojin e shërbimit, teknologjinë) të radio-frekuencave (kanaleve), si dhe mbulueshmërinë dhe kërkesat për kualitet;

2.2. shfrytëzimin efikas dhe efektiv të radio-frekuencave (kanaleve);

2.3. kushtet teknike dhe operacionale të domosdoshme për shmangie të interferencave dhe për limitim të ekspozimit të publikut në përgjithësi ndaj rrezeve elektromagnetike, kur këto kondita dallojnë nga ato të përfshira në termat dhe kushtet e përgjithshme për përfshirje në aktivitetet e komunikimeve elektronike të miratuara nga Autoriteti;

2.4. kohëzgjatjen maksimale për shfrytëzim të radio-frekuencave (kanaleve), duke specifikuar qëllimin e përdorimit të radio-frekuencave (kanaleve), shfrytëzimin efektiv të radio frekuencave (kanaleve) dhe amortizimin e investimeve;

2.5. të drejtën për transfer të shfrytëzimit të radio-frekuencave (kanaleve) me iniciativë të pronarit aktual dhe kushtet për transfer të tillë. Autoriteti duhet të specifikojë kushtet e tilla në dokumentet autorizuese për shfrytëzim të radio-frekuencave (kanaleve);

2.6. pagesat për mbikëqyrje të shfrytëzimit të radio-frekuencave (kanaleve), si dhe pagesat tjera në buxhetin e shtetit në përputhje me procedurat e vendosura në akte juridike;

2.7. të gjitha zotimet e bëra nga personat gjatë procesit tenderues, apo procedurës së ankandit;

2.8. obligimet që dalin nga traktatet relevante ndërkombëtare dhe/ose obligimet që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e radio-frekuencave (kanaleve);

2.9. obligimet specifike për shfrytëzim eksperimental të radio-frekuencave (kanaleve).

3. Kushtet e vendosura në rregulloret për shfrytëzim të numrave telefonik dhe në autorizimet për shfrytëzim të numrave telefonik mund të përmbajnë vetëm:

3.1. përcaktimin e qëllimit (shërbimit) për të cilin shfrytëzohen numrat telefonik, përfshirë të gjitha kërkesat që kanë të bëjnë me atë shërbim dhe principet tarifore me çmimet maksimale që mund të aplikohen në rangun specifik numerik;

3.2. shfrytëzimin efikas dhe efektiv të numrave telefonik;

3.3. të drejtat e parapaguesit për të mbajtur numrin telefonik;

3.4. obligimet për të ofruar informata për shërbimet e numëratorit telefonik;

3.5. afati maksimal kohor për shfrytëzim të numrave telefonik;

3.6. të drejtën për transfer të shfrytëzimit të numrave telefonik me iniciativë të pronarit aktual dhe kushtet për transfer të tillë. Autoriteti duhet të specifikojë kushtet e tilla në dokumentet autorizuese për shfrytëzim të numrave telefonik;

3.7. pagesat për mbikëqyrje të shfrytëzimit të numrave telefonik, si dhe pagesat tjera në buxhetin e shtetit në përputhje me procedurat e vendosura në akte juridike;

3.8. të gjitha zotimet e bëra nga personat gjatë procesit tenderues apo procedurës së ankandit;

3.9. obligimet që dalin nga traktatet relevante ndërkombëtare dhe/ose obligimet që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e numrave telefonik.

4. Personat duhet të shfrytëzojnë resurset e komunikimeve elektronike në mënyrë efikase dhe efektive. Kriteret për shfrytëzim efikas dhe efektiv të resurseve të komunikimeve elektronike duhet të përshkruhen në rregulloret për dhënie dhe shfrytëzim të resurseve të komunikimeve elektronike dhe në autorizimet për shfrytëzim të resurseve të komunikimeve elektronike.

5. Autoriteti e ka të drejtën t'i zëvendësojë resurset e dhëna të komunikimeve elektronike me resurset tjera të të njëjtit qëllim duke paralajmëruar shfrytëzuesit e resurseve të komunikimeve elektronike nëntë (9) muaj paraprakisht ose të revokoj një autorizim për shfrytëzim të resurseve të komunikimeve elektronike, duke paralajmëruar shfrytëzuesit e resurseve të komunikimeve elektronike tetëmbëdhjetë (18) muaj paraprakisht nëse kjo kërkohet nga obligimet e traktateve ndërkombëtare, aktet juridike të Bashkimit Evropian, ose qëllimi i përdorimit të resurseve të komunikimeve elektronike ka ndryshuar. Gjatë zbatimit të dispozitave të këtij paragrafi Autoriteti duhet të marrë parasysh dispozitat nga neni 55 i këtij ligji.

6. Ndërmarrësit, të cilit i është ndaluar e drejta për t'u përfshirë në aktivitete të komunikimeve elektronike duhet t'i ndalohet, gjithashtu e drejta e shfrytëzimit të resurseve përkatëse të komunikimeve elektronike.

7. Në rastet kur të drejtat individuale për shfrytëzim të radio-frekuencave janë dhënë për dhjetë (10) apo më shumë vite dhe të drejtat e tilla nuk mund të transferohen apo të jepen

me qira në mes të ndërmarrësve, Autoriteti duhet të sigurojë që kriteret për dhënie të të drejtës individuale për shfrytëzim aplikohen dhe janë konform përgjatë tërë periudhës së vlefshmërisë së licencës, e posaçërisht në rastet kur shfrytëzuesi i të drejtës për shfrytëzim e bën një kërkesë të tillë dhe të njëjtën e arsyeton. Nëse këto kriteret nuk janë më të aplikueshme, e drejta individuale për shfrytëzim të radio frekuencave duhet të ndryshohet në autorizim të përgjithshëm për shfrytëzim të radio frekuencave, pas njoftimit paraprak dhe pas një periudhe të caktuar kohore, ose këto të drejta duhet të bëhen të transferueshme ose të jepet mundësia e dhënies me qira në mes të ndërmarrësve.

8. Autoriteti duhet të sigurojë që radio frekuencat shfrytëzohen në mënyrë efektive dhe në pajtim me këtë ligj. Ata duhet të sigurojnë që konkurrenca të mos shtrembërohet si pasojë e çfarëdo transferi apo akumulimi të së drejtës për shfrytëzim të radio-frekuencave. Për këto qëllime, Autoriteti mund të ndërmarrë masa të përshtatshme si detyrimi i shitjes apo dhënies me qira të së drejtës për të shfrytëzuar radio-frekuencat.

Neni 55

Ndryshimi i kushteve për shfrytëzim të resurseve të komunikimeve elektronike

Të drejtat, kushtet dhe procedurat që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e resurseve të komunikimeve elektronike mund të ndryshohen vetëm në rastet objektivisht të arsyeshme dhe në mënyrë proporcionale duke marrë parasysh kushtet që kanë të bëjnë me transferin ose qiradhënien e të drejtës për shfrytëzim të radio frekuencave. Njoftimi i duhur dhe paraprak duhet të jepet për qëllim të ndryshimeve dhe palëve me interes përfshirë shfrytëzuesëve dhe konsumatorëve duhet t'u jepet kohë e mjaftueshme për të shprehur pikëpamjet e veta, por jo më pak se tridhjetë (30) ditë përveç në rastet e jashtëzakonshme. Kur ndryshimet për kushtet për shfrytëzimin e radio-frekuencave (kanaleve) bazuar në kriteret e vendosura në aktet juridike kanë të bëjnë me mbulueshmërinë e territorit me sinjal radio dhe TV difuziv, apo ritransmetime radio TV difuzive të licencuara nga Komisioni i Pavarur për Media, ndryshimet e tilla duhet të koordinohen me Komisionin e Pavarur për Media.

Neni 56

Aktivitetet radio amatore dhe shfrytëzuesit tjerë të radio stacioneve

Procedura për dhënien e të drejtës për aktivitete radio amatore dhe çfarëdo aktiviteti tjetër për shfrytëzim të radio stacioneve, si dhe kushtet dhe procedurat për dhënie të autorizimeve për aktivitete të tilla duhet të vendosen nga Autoriteti.

Neni 57

Pagesat për shfrytëzim të radio frekuencave

1. Pagesat e rregullta vjetore duhet të paguhet për përdorimin e spektrit të radio-frekuencës, gjithashtu kalkulimi, si dhe shuma e pagesave, poashtu edhe mënyra e pagesës duhet të miratohet nga Autoriteti në përputhje me dispozitat e nën-paragrafit 2.6. të paragrafit 2, të nenit 54 të këtij ligji.

2. Pagesat e aprovuara sipas paragrafit 1. të këtij neni duhet të sigurojnë një përdorim optimal të spektrit të radio-frekuencës në pajtueshmëri me parimet e përmendura në nenin 3 të këtij ligji.

3. Llogaritja, si dhe shuma e pagesave të referuara në autorizimin për përdorim nuk duhet të zbatohet tek bandet e radio-frekuencave, të cilat sipas tabelës së shpërndarjes së frekuencës së radios janë subjekte tek procedura e ankandit publik në pajtueshmëri me nenin 51 të këtij ligji, përmes së cilës shuma e pagesave për të drejtën për përdorim të spektrit të frekuencës duhet të përcaktohet në procedurën e ankandit publik.

KREU VIII NUMERACIONI, EMRAT DHE ADRESAT

Neni 58 Plani i numeracionit

1. Plani i Numeracionit definon strukturën, gjatësinë dhe dhënien e numrave për qasje në rrjetat dhe shërbimet e komunikimeve elektronike.

2. Autoriteti duhet ta administrojë planin e numeracionit që të:

2.1. sigurojë strukturim efikas dhe shfrytëzim të numrave dhe serive të numrave;

2.2. kënaqë nevojat e arsyeshme të operatorëve dhe ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike për caktim të numrave, sipas këtij ligji;

2.3. sigurojë që caktimi dhe përdorimi i numrave bëhet në mënyrë të ndershme, transparente dhe jodiskriminuese.

3. Autoriteti ruan të gjitha të dhënat, që lidhen me administrimin e planit të numeracionit.

4. Autoriteti publikon caktimin e numrave dhe të serive numerike, si dhe përdoruesit e tyre në faqen e vet të internetit.

Neni 59 Përdorimi i numrave, i emrave dhe i adresave

1. Numrat dhe seritë numerike, emrat dhe adresat nga plani i numeracionit mund të përdoren vetëm në bazë të vendimit të Autoritetit.

2. Autoriteti harton rregulla edhe për caktimin dhe përdorimin e emrave dhe të adresave, duke synuar sigurimin e transparencës, ndershmërisë dhe të mosdiskriminimit të përdoruesve të tyre.

Neni 60

Bartshmëria e numrit

1. Ofruesit e shërbimeve dhe/ose të rrjetave publike të komunikimeve elektronike duhet të sigurojnë, me shpenzime të veta dhe në pajtim me procedurat dhe kushtet e vendosura nga Autoriteti që parapaguesit mund t'i bartin numrat e vet në rast se ka ndërrim të ofruesit të shërbimeve, ndryshim të vendit të shërbimit të ofruar apo mënyrës së ofrimit të shërbimit.
2. Kërkesa që të gjithë shfrytëzuesit e numrave nga plani numerik nacional për të mbajtur numrat e tyre në mënyrë të pavarur nga ndërmarrësi që ofron shërbime duhet të vlejë:
 - 2.1. në rast të numrave gjeografik, në lokacion të caktuar; dhe
 - 2.2. në rastin e numrave jo gjeografik, në çfarëdo lokacioni. Ky paragraf nuk vlen për bartjen e numrave ndërmjet rrjetave të shërbimeve fikse dhe rrjetave mobile.
3. Autoriteti duhet të sigurojë që çmimorja në mes të operatorëve dhe/ose ofruesve të shërbimeve që ka të bëjë me bartshmërinë e numrave është e bazuar në kosto. Për këtë qëllim, Autoriteti e ka të drejtën t'i aplikojë rregullat nga neni 40 i këtij ligji tek të gjithë ndërmarrësit që iu referohet ky nen. Tarifat që iu imponohen parapaguesve për të gëzuar këtë të drejtë në rast se lejohen nga Autoriteti dhe në pajtim me kushtet e vendosura nga ai nuk duhet të kenë efekt dekurajues për ta shfrytëzuar këtë të drejtë. Për këtë qëllim, Autoriteti mund të caktojë nivelin më të lartë të çmimit.

Neni 61

Numrat jogjeografik

1. Ndërmarrësit e rrjeteve publike telefonike ose të shërbimeve telefonike të disponueshme për publikun janë të detyruar që, kur është e mundur teknikisht dhe ekonomikisht, t'u sigurojnë përdoruesve jashtë territorit të Republikës së Kosovës, mundësinë të bëjnë thirrje drejt numrave jogjeografikë të caktuar në Republikën e Kosovës, sipas planit kombëtar të numeracionit.
2. Ndërmarrësit e rrjeteve publike telefonike, ose shërbimeve telefonike të disponueshme për publikun nuk janë të detyruar të plotësojnë detyrimin e paragrafit 1. të këtij neni, në rastet kur pala e thirrur ka vendosur, për arsye biznesi, të kufizojë thirrjet e gjeneruara nga zona të veçanta.
3. Ndërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të rrjeteve të komunikimeve publike duhet të lejojnë përdorimin e shërbimit publik telefonik nomadik nga përdoruesit e tyre.

KREU IX
MASAT PËR MBROJTJEN E RRJETEVE TË KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE PUBLIKE

Neni 62
Mbrojtja e rrjetit nga dëmtimet

Ndërmarrësi mban dokumentacion të plotë e të saktë për rrjetin e vet. Me kërkesë zyrtare, ndërmarrësit u japin organeve përgjegjëse sipas legjislacionit për planifikimin urban dhe njëri-tjetrit të dhëna për pjesë të këtij rrjeti, për të shmangur dëmtimin e rrjetit nga punimet nëntokësore, apo ndërtimore, ose nga ndikimet e mundshme elektrike, që shkakton vënia në punë e pajisjeve të tjera pranë rrjetit të komunikimeve elektronike.

Neni 63
Mbrojtja e rrjetit nga dëmtimet e palëve të treta

1. Për ta parandaluar dëmtimin e mundshëm të rrjetit ekzistues të komunikimeve elektronike, çdo person fizik ose juridik, që kryen punime ndërtimi e gërmimi, përpara fillimit të punimeve detyrohet të njoftojë ndërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve elektronike.
2. Në rast se punimet në rrjetin ekzistues të komunikimeve elektronike duhet të kryhen domosdoshmërisht, të gjitha shpenzimet për mbrojtjen, shmangien ose riparimin e dëmtimeve të këtyre rrjeteve barten nga subjekti që kryen punimet.
3. Mosmarrëveshjet ndërmjet palëve zgjidhen nga gjykata.

KREU X
TË DREJTAT DHE INTERESAT E SHFRYTËZUESVE FUNDOR

Neni 64
Obligimet që kanë të bëjnë me ofrimin e shërbimeve për shfrytëzuesit fundor

1. Autoriteti gjatë vendimmarrjes për obligimet që mund të imponohen duke u bazuar në nenet 33, 34, 35, 36, 37 dhe 40 të këtij ligji, si dhe obligimet, plotësimi i të cilave është i domosdoshëm dhe kur është e aplikueshme bazuar në nenin 38 të këtij ligji dhe të cilat nuk janë të mjaftueshme për operatorët që kanë fuqi të ndjeshme tregu në një treg relevant duhet të imponojnë obligime që janë të përshtatshme, duke u bazuar në natyrën e problemit të identifikuar, proporcional dhe të arsyetuar në bazë të objektivave që duhet arritur, përfshirë kërkesat që ndërmarrësi të mos aplikojë çmime ekcesive, pengon hyrjen në treg apo kufizon konkurrencën duke vendosur çmime grabitqare, tregojnë preferenca ndaj shfrytëzuesve specifik, apo paketojnë shërbimet në mënyrë të paarsyeshme, gjithashtu edhe obligime për të siguruar kualitet të shërbimeve të vendosura nga Autoriteti. Për t'i mbrojtur interesat e shfrytëzuesve fundorë dhe promovuar konkurrencën efektive, Autoriteti ka të drejtën të vendosë nivelet më të larta të çmimit, ndërmarrë masa për kontrollim të tarifave

individuale dhe të imponojë obligime për orientim të tarifave kah kostot apo çmimet në tregjet e krahasueshme. Kur një ndërmarrësi i imponohen obligime për orientim të tarifave kah kostot, dispozitat e paragrafit 4. të nenit 40 të këtij ligji duhet aplikuar *mutatis mutandis*.

2. Autoriteti duhet të sigurojë që kur rregullimi i tarifave, apo obligimet tjera relevante i imponohen ndonjë ndërmarrësi që ky ndërmarrës t'i mirëmbajë kostot kontabël në pajtim me rregullat e vendosura nga Autoriteti. Ky ndërmarrës në afat të caktuar nga Autoriteti duhet ta përgatis sistemin kontabël të kostove, publikojë përshkrimin e tij dhe ta dorëzojë atë tek Autoriteti, në pajtim me sistemin e kostove kontabël. Sistemi i kostove kontabël duhet të jetë konform me rregullat e kostove kontabël të vendosura nga Autoriteti. Autoriteti e ka të drejtën që të vendosë sistemin e kostove kontabël, formatin dhe metodologjinë kontabël që do të përdoret nga ndërmarrësit ose nga ndërmarrësi i veçantë që ka fuqi të ndjeshme tregu në ndonjë treg relevant. Autoriteti duhet të publikojë sistemin kontabël në ueb faqen e vet. Pajtueshmëria e kostove kontabël me rregullat e kostove kontabël dhe aktet tjera juridike dhe me sistemet e kostove kontabël dhe/ose metodologjitë kontabël dhe/ose formatet e përgatitura nga ndërmarrësi dhe/ose të vendosura nga Autoriteti duhet të verifikohen nga një auditim. Mendimi i auditorit duhet të publikohet çdo vit në pajtim me rregullat e vendosura nga Autoriteti.

Neni 65

Transparenca dhe publikimi i informacionit

1. Ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike duhet të publikojnë, të bëjnë transparente, të krahasojnë dhe në mënyrë adekuate dhe të përditësuar të informojnë për tarifën dhe çmimet e aplikuar, për të gjitha pagesat deri në përfundim të kontratës dhe për përfundimin e kontratës dhe për termat dhe kushtet standarde që kanë të bëjnë me qasje dhe shfrytëzim të shërbimeve që ofrohen nga ata për shfrytëzuesit fundorë dhe konsumatorët në pajtim me rregullat për publikim të informatave dhe dërgim te Autoriteti, përfshirë këtu qëllimin dhe përmbajtjen e informatave, kufizimet kohore, formën dhe metodën e publikimit dhe/ose dërgimit dhe rregullat për kontroll kualiteti.

2. Autoriteti duhet të inkurajojë ofrimin e informacionit krahasues që t'u mundësojë përdoruesve fundorë dhe konsumatorëve ta bëjnë një vlerësim të pavarur të kostos së pakove alternative të shërbimeve, si për shembull duke përdorur udhëzues interaktivë, ose teknika të ngjashme. Kur një mjet i tillë nuk ofrohet në treg pa pagesë, apo me një çmim të arsyeshëm, Autoriteti mund të vendosë për të krijuar udhëzues, apo mundësi teknike të tilla nëpërmjet prokurimit apo duke përdorur resurse të veta të brendshme. Palët e treta do të kenë të drejtën të përdorin, pa pagesë, informacionin e publikuar nga ndërmarrësit që ofrojnë rrjete të komunikimit elektronik dhe/ose shërbimeve publike të komunikimit elektronik për qëllim të shitjes ose mundësimin të udhëzuesve të tillë interaktiv ose teknikave të ngjashme.

3. Ofruesit e shërbimeve dhe rrjetave të komunikimeve elektronike publike, përveç tjerash duhet të:

3.1 iu ofrojnë informata parapaguesve për tarifën e aplikuar për çfarëdo numri dhe shërbimi që ka të bëjë me kushte specifike të çmimeve; kur kemi të bëjmë me

kategori individuale shërbimesh Autoriteti mund të kërkojë që informatat e tilla të jepen para se lidhja të vendoset;

3.2. informojë parapaguesit për çfarëdo ndryshimesh për qasje në shërbime emergjente dhe për vendndodhjen e thirrësit për shërbimet për të cilat janë parapaguar;

3.3. informojë parapaguesit për çfarëdo ndryshimi të kushteve që limitojnë qasjen dhe/ose shfrytëzimin e shërbimeve dhe aplikacioneve, kur kushtëzimet e tilla lejohen me legjislacion nacional;

3.4. ofrojë informata për çfarëdo procedure që ndërmerret nga ofruesi i shërbimeve për matje dhe menaxhim të trafikut për të shmangur ngarkesat, apo mbingarkesat e linkut dhe se si këto procedura mund të ndikojnë në kualitetin e shërbimit;

3.5. informojë parapaguesit për të drejtat për të vendosur për përfshirje, ose mospërfshirje të të dhënave personale në informatorët telefonikë dhe për llojin e të dhënave për të cilat bëhet fjalë konform këtij ligji dhe legjislacionit të BE-së për mbrojtje të të dhënave dhe privatësi në komunikime elektronike

3.6. rregullisht informojë parapaguesit me nevoja të veçanta për detalet e produkteve të dizajnuara për ta.

4. Autoriteti mund të kërkojë nga ofruesit e shërbimeve dhe rrjetave të komunikimeve elektronike publike ta informojnë publikun me informata që kanë rëndësi publike, pa pagesë, për parapaguesit ekzistues apo ata të rinj në mënyrë të njëjtë sikurse parapaguesit e rregullt. Në këto raste informatat e tilla ofrohen nga autoritetet relevante publike në format të standardizuar dhe përveç tjerash duhet të përmbajnë këto çështje:

4.1. përdorimet më të shpeshta të shërbimeve të komunikimeve elektronike për të kryer aktivitete të paligjshme apo për të shpërndarë përmbajtje të dëmshme, posaçërisht kur kemi të bëjmë me të drejtat dhe liritë e të tjerëve, përfshirë të drejtën e autorit dhe të drejtat e ngjashme, si dhe konsekuencat legale për to; dhe

4.2. mënyrat për mbrojtje nga rreziqet që kanë të bëjnë me siguri personale, privatësi dhe të dhëna personale kur shfrytëzohen shërbimet e komunikimeve elektronike.

Neni 66

Të drejtat dhe obligimet e ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe shfrytëzuesve fundorë

1. Kur shfrytëzuesit fundor i ofrohet pajisja fundore falas, apo me pagesë, e cila është më e ultë sesa çmimi blerës, ofruesi i shërbimeve të komunikimeve elektronike publike duhet të vendosë në kontratë për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike diferencën e çmimit të kësaj pajisjeje me dhe pa çmim të shërbimit, si dhe periudhën kohore dhe mënyrën në të cilën do të bëhet kompensimi i kësaj difference.

2. Ofruesi i shërbimeve të komunikimeve elektronike duhet të ekzaminojë të gjitha aplikacionet, propozimet dhe ankesat që i pranon dhe kanë të bëjnë me shërbimet e komunikimeve elektronike të ofruara apo që pretendohet të ofrohen nga ai dhe të përgjigjet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit.
3. Ofruesi i shërbimeve të komunikimeve elektronike duhet të informojë pa pagesë parapaguesit për shërbimet e ofruara dhe për tarifën dhe çmimet, nëse këtë e kërkon parapaguesi.
4. Ofruesit e shërbimeve telefonike publike që ofrojnë qasje në rrjetën telefonike publike duhet të ofrojnë edhe shërbime ndihmëse asistuese për shfrytëzuesit fundorë. Autoriteti duhet të aprovojë rregulloren për ofrimin e shërbimeve të asistencës nga ofruesit e shërbimeve.
5. Ndërmarrësve që ofrojnë rrjeta dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike nuk iu lejohej që palëve të treta t'u jepen informata për numrin, vendin dhe pronësinë e pajisjeve fundore, përveçse në rastet kur Autoriteti merr vendim ndryshe për t'i kryer obligimet e veta dhe obligimet që i kryejnë organet tjera përgjegjëse për mbarëvajtjen e rendit dhe qetësisë publike të identifikuar me vendim nga Autoriteti për t'i kryer obligimet e veta, por edhe në rastet tjera kur ligjet e përcaktojnë një gjë të tillë.
6. Të gjithë ndërmarrësit që ofrojnë rrjeta dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike publike duhet të sigurojnë që në përputhje me procedurat dhe kushtet e vendosura nga Autoriteti që parapaguesit dhe/ose shfrytëzuesit, përfshirë këtu edhe shfrytëzuesit me nevoja të veçanta dhe shfrytëzuesit e telefonave për qasje publike janë në gjendje të thërrasin shërbimet emergjente falas dhe pa pasur nevojë për të shfrytëzuar çfarëdo mjete pagese.
7. Ofruesit e shërbimeve telefonike publike duhet t'ua mundësojnë parapaguesve në bazë të kërkesës së tyre mundësinë për të zgjedhur planin e pagesës kur pagesat për shërbime telefonike publike bëhen në bazë të kalkulimit për çdo sekondë, përveç në rastet kur ofruesi i shërbimeve telefonike publike shfrytëzon sasinë e të dhënave për pagesë të komunikimeve me të dhëna.

Neni 67

Regjistrimi i parapaguesve

1. Ndërmarrësit e rrjetave dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike janë të obliguar që të regjistrojnë të gjithë parapaguesit, pavarësisht a janë me kontratë apo të parapaguar, para aktivizimit të shërbimit.
2. Formatin me të dhënat e obligueshme që jepen nga parapaguesit për të mundësuar regjistrimin e tyre në bazë të këtij neni e definon Autoriteti.

Neni 68

Ruajtja dhe administrimi i të dhënave personale për qëllime të ndjekjes penale

1. Pavarësisht definicioneve tjera në këtë ligj, ndërmarrësit e rrjetave dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike janë të obliguar të ruajnë dhe të administrojnë për një periudhë jo më gjatë se një (1) vit skedaret e të dhënave për parapaguesit e vet duke u referuar në paragrafin 2. të këtij neni. Kjo ruajtje duhet të paguhet nga fondet shtetërore në pajtueshmëri me procedurat e vendosura nga Qeveria.

2. Ndërmarrësit të cilët ofrojnë rrjeta të komunikimeve elektronike dhe/ose shërbime duhet të sigurojnë që ruhen kategoritë e të dhënave si në vijim:

2.1. të dhënat e nevojshme për të gjetur dhe identifikuar resursin e komunikimit në lidhje me rrjetin e telefonisë fikse dhe telefonisë mobile:

2.1.1. numri i telefonit thirrës;

2.1.2. emrin dhe adresën e parapaguesit ose përdoruesit të regjistruar;

2.2. të dhënat që kanë të bëjnë me qasjen nga Interneti, me email adresën e Internetit dhe me telefoninë përmes Internetit:

2.2.1. ID e ndarë të përdoruesit;

2.2.2. ID e përdoruesit dhe numrin e ndarë të telefonit të secilës hyrje komunikuese të rrjetit të telefonave publik;

2.2.3. emrin dhe adresën e parapaguesit, apo përdoruesit të regjistruar për të cilin është ndarë një adresë e Protokollit të Internetit (IP), një ID e përdoruesit apo numër i telefonit i është ndarë atij në kohën e komunikimit;

2.3. të dhënat e domosdoshme për të identifikuar destinimin e komunikimit që kanë të bëjnë me rrjetën e telefonisë fikse dhe asaj mobile:

2.3.1. numrat e thirrur (numrat e telefonit të thirrur), dhe, në rastet e përfshirjes së shërbimeve plotësuese siç janë bartja e thirrjes ose transferi i thirrjes, numri apo numrat tek të cilët është rutinuar thirrja;

2.3.2. emri(at) dhe adresa(t) e parapaguesit(ve) ose përdoruesit(ve).

2.4. të dhënat që kanë të bëjnë me e-mail adresën e Internetit dhe telefoninë përmes Internetit:

2.4.1. ID e përdoruesit ose numri i telefonit të marrësit të synuar të një thirrje të telefonisë përmes Internetit;

2.4.2. emri(at) dhe adresa(t) e parapaguesit(ve) ose përdoruesit(ve) të regjistruar dhe ID e përdoruesit të marrësit të synuar të komunikimit;

2.5. të dhënat e domosdoshme për të identifikuar datën, kohën dhe zgjatjen e komunikimit:

2.5.1. sa i përket telefonisë së rrjetit fiks dhe atij mobil, data dhe koha e fillimit dhe e mbarimit të komunikimit;

2.6. të dhënat që kanë të bëjnë me qasjen në Internet, e-mail adresa e Internetit, dhe telefoninë përmes Internetit:

2.6.1. data dhe koha e kyqjes dhe çkyqjes së shërbimit të qasjes së Internetit, duke u bazuar në zonën e saktë kohore, bashkë me IP adresën, qoftë dinamike apo statike, e ndarë nga Ofruesi i shërbimit të qasjes së Internetit, si dhe ID e përdoruesit të parapaguesit ose përdoruesit të regjistruar;

2.6.2. data dhe koha e kyqjes dhe çkyqjes në shërbimin e e-mailit ose shërbimin e telefonisë përmes Internetit, duke u bazuar në zonën e saktë kohore;

2.7. të dhënat e domosdoshme për të identifikuar llojin e komunikimit:

2.7.1. lidhur me telefoninë e rrjetit fiks dhe telefonisë mobile: shërbimi i përdorur i telefonit;

2.7.2. sa i përket e-mailit të Internetit dhe telefonisë përmes Internetit: Shërbimi i Internetit të përdorur;

2.8. të dhënat e domosdoshme për të identifikuar pajisjen komunikuese të përdoruesit ose për çfarë pretendon të jetë pajisja.

2.9. në lidhje me telefoninë e rrjetit fiks, numrat e telefonit të thirrësit dhe të të thirrurit;

2.10. në lidhje me telefoninë mobile;

2.11. numrat e telefonit të thirrësit dhe të të thirrurit;

2.12. numri identifikues internacional i shfrytëzuesit mobil (ang.IMSI) i palës thirrëse;

2.13. numri identifikues internacional i pajisjes mobile (ang. IMEI) i palës thirrëse;

2.14. numri IMSI i palës së thirrur;

2.15. numri IMEI i palës së thirrur;

2.16. në rastin e shërbimeve parapaguese anonime, data dhe koha kur është bërë aktivizimi i këtij shërbimi dhe emërtimi i lokacionit (ID e celulës) prej të cilës është bërë aktivizimi i shërbimit.

2.17. të dhënat që kanë të bëjnë me qasjen në Internet, e-mail adresa e Internetit, dhe telefoninë përmes Internetit:

2.18. numri i telefonit i thirrësit për lidhje dial-up;

2.19. linja digjitale e shfrytëzuesit (ang. DSL) ose ndonjë vend tjetër ku është iniciuar komunikimi;

2.20. të dhënat e domosdoshme për të identifikuar lokacionin e pajisjes komunikuese mobile:

2.20.1 emërtimi i lokacionit (ID e celulës) në fillim të komunikimit;

2.21. të dhënat që identifikojnë lokacionin gjeografik të celulare duke u referuar nga emri i lokacionit të tyre (ID e celulës) gjatë periudhës në të cilën të dhënat komunikuese kanë qenë në dispozicion.

3. Të dhënat e listuara në paragrafin 2. të këtij neni, duhet t'iu vihen në dispozicion edhe në formë elektronike dhe pas kërkesës së tyre autoriteteve përgjegjëse siç përshkruhet në legjislacionin për Procedurë Penale në fuqi.

Neni 69

Kualiteti i shërbimeve komunikuese publike

1. Ndërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike janë të detyruar ta publikojnë informacionin e duhur, të krahasueshëm dhe të përditësuar për cilësinë e shërbimeve të ofruara prej tyre.

2. Autoriteti, në bazë të një rregulloreje të veçantë, përcakton treguesit e cilësisë së shërbimit.

Neni 70

Asistenca e operatorit

1. Ndërmarrësit janë të detyruar të organizojnë dhe t'i kenë funksionale shërbimet e asistencës për shfrytëzuesit e fundëm, madje të përdorin të gjitha mjetet e mundshme për të informuar shfrytëzuesit e fundëm për këto shërbime e për mundësinë e përdorimit të tyre, si dhe për pagesat eventuale, nëse këto shërbime, tërësisht ose pjesërisht, ofrohen me pagesë.

2. Të gjithë shfrytëzuesit fundorë, që kanë qasje në rrjetin e komunikimeve elektronike publike, duhet të kenë qasje në shërbimet e asistencës të ofruar nga ndërmarrësi.

Neni 71

Faturimi i detajuar

1. Ndërmarrësit janë të detyruar t'u ofrojnë parapaguesve të tyre, për shërbimet telefonike të mundshme për publikun, faturë të detajuar, me qëllim që t'u mundësojë kontrollin mbi shumën e faturuar.

2. Në faturën e përmendur në paragrafit 1. të këtij neni mund të mos përfshihen thirrjet drejt numrave pa pagesë dhe thirrjet drejt numrave të emergjencës.

3. Fatura e detajuar për shërbimet telefonike publike duhet të përfshijë, së paku elementet e mëposhtme:

3.1. periudhën e faturimit;

3.2. pagesën fikse mujore për shërbimin;

3.3. llojin dhe shumën e të gjitha pagesave të tjera të mundshme për periudhën e faturimit;

3.4. numrat e thirrur, datën, orën, si dhe kohëzgjatjen e bisedave të kryera;

3.5. pagesën përkatëse për çdo komunikim të kryer.

Neni 72

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve bazuar në ankesat e shfrytëzuesve fundorë

1. Në rast të mosmarrëveshjeve në mes të ofruesit të shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe shfrytëzuesit fundorë, shfrytëzuesi fundorë ka të drejtë t'i drejtohet Autoritetit për zgjidhje të mosmarrëveshjes para se çështja të shkojë në procedurë gjyqësore. Shfrytëzuesi fundorë ka të drejtë që drejtpërdrejt t'i drejtohet gjykatës.

2. Paragrafët 6, 7, 8, 9, 11, 12, 13, 15, 16, 17, 19, 20 të nenit 84 të këtij ligji duhet të aplikohen *mutatis mutandis* për zgjidhjen e konflikteve bazuar në ankesat nga shfrytëzuesit fundorë.

3. Nëse shfrytëzuesi fundor i drejtohet drejtpërdrejt Autoritetit, pa shkuar fillimisht te ofruesi i shërbimeve të komunikimeve elektronike, Autoriteti duhet të marrë masa për t'i pajtuar palët. Autoriteti nuk do të marrë parasysh ankesën nëse ofruesi i shërbimeve të komunikimeve elektronike propozon në afat të caktuar kohor nga Autoriteti marrëveshje kompromisi dhe shfrytëzuesi e pranon propozimin, apo nuk e refuzon atë në afatin e caktuar nga Autoriteti.

4. Vendimi i lëshuar nga Autoriteti që ka të bëjë me ankesën mund të apelohe në gjykatën kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga data e marrjes së vendimit.

5. Autoriteti duhet të vendosë rregulla për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve bazuar në ankesat e bëra nga shfrytëzuesit fundorë. Rregullat duhet ta përmbajnë formën, përmbajtjen dhe mënyrën e skedimit të ankesave të tilla. Dorëzimi i ankesës, mbledhja e fakteve, si dhe procesi i pajtimit dhe procedurat e zgjidhjes së konfliktit duhet të jenë pjesë e rregullave të lëshuara nga Autoriteti.

Neni 73

Kufizimi ose ndërprerja e qasjes

1. Ndërmarrësit, që ofrojnë qasje në rrjetet e komunikimeve elektronike publike, mund ta kufizojnë ose ndërpresin përkohësisht qasjen në shërbimet e tyre, pa miratimin paraprak të

shfrytëzuesve, nëse kjo është e nevojshme për përmirësimin, modernizimin, mirëmbajtjen apo për probleme teknike në rrjet.

2. Ndërmarrësit duhet të njoftojnë Autoritetin dhe shfrytëzuesit për kufizimet apo ndërprerjet e shërbimit, të cilat do të zgjasin më shumë se një (1) orë. Ky njoftim bëhet:

2.1. të paktën dyzet e tetë (48) orë më parë, në rast të një përmirësimi, modernizimi ose mirëmbajtjeje të planifikuar të rrjetit;

2.2. sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se dyzet e tetë (48) orë, pas ndodhjes së kufizimit apo ndërprerjes së shkaktuar nga defekte apo dëmtime të rrjetit.

3. Ndërmarrësit duhet të informojnë Autoritetin për kufizimin apo ndërprerjen e qasjes sipas kushteve të paraqitura në paragrafin 4. të këtij neni.

4. Autoriteti duhet të ketë të drejtën të miratojë kushtet dhe procedurat për paraqitjen e informacionit të Autoritetit tek përdoruesit fundorë në rast të kufizimit apo ndërprerjes së qasjes.

5. Ndërmarrësit duhet t'i marrin të gjitha masat e nevojshme që ta bëjnë sa më të shkurtër kohën e kufizimit, ose të ndërprerjes.

Neni 74 **Shkyçja e parapaguesit**

1. Ndërmarrësit që ofrojnë qasje në rrjetet e komunikimeve elektronike publike mund ta kufizojnë qasjen në shërbimet e tyre dhe/ose mund ta ndërpresin lidhjen e parapaguesit, apo mund të ndërpresin kontratën me parapaguesin vetëm në rast se parapaguesi nuk përmbush kushtet e kontratës, apo nuk kryen pagesat, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.

2. Ndërmarrësit duhet të përcaktojnë qartë dhe me detaje në kushtet e kontratës rastet kur bëhet kufizimi, ndërprerja e shërbimit apo ndërprerja e kontratës.

3. Në rastet e mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale nga parapaguesi, ndërmarrësit janë të detyruar t'i dërgojnë një njoftim, me shkrim, brenda një intervali të arsyeshëm kohor, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga dita kur operatori ka identifikuar shkeljen, me qëllim që parapaguesi të mund të plotësojë detyrimet kontraktuale.

4. Ndërmarrësit nuk janë të detyruar të njoftojnë paraprakisht parapaguesit për masat e marra, në rast se shkelja e evidentuar e kontratës:

4.1. shkakton një kërcënim serioz të rendit e të sigurisë publike, shëndetit dhe mjedisit;

4.2. shkakton një dëmtim serioz fizik, material ose funksional të rrjetit.

5. Nëse parapaguesi kundërshton shumën e faturuar, ndërmarrësi mund të mos veprojë sipas paragrafit 1. të këtij neni, deri në arritjen e një vendimi përfundimtar, kur parapaguesi do të jetë i detyruar të paguajë brenda një afati të caktuar kohor.

6. Nëse është teknikisht e mundur, operatorët janë të detyruar të kufizojnë qasjen vetëm në ato shërbime për të cilat parapaguesi ka shkëlur kushtet e kontratës, përveç rasteve kur parapaguesi abuzon, ose, në mënyrë të përsëritur, kryen me vonesë ose nuk paguan faturat.

7. Ndërmarrësve u ndalohe të kufizojnë qasjen për përdorimin e numrave të emergjencës.

KREU XI KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE NË RASTE TË VEÇANTA

Neni 75

Masat e jashtëzakonshme për sigurimin e ofrimit të shërbimeve

1. Ndërmarrësit detyrohen që, me rrjetet dhe shërbimet, të përballojnë nevojat e shtetit në situatë të jashtëzakonshme dhe kur e kërkojnë interesat e mbrojtjes kombëtare e të sigurisë së rendit publik.

2. Ndërmarrësit, që ofrojnë qasje në rrjetet e komunikimeve elektronike publike dhe shërbime të komunikimeve elektronike për publikun, hartojnë dhe paraqesin te Autoriteti planin, për të siguruar integritetin e rrjetit të komunikimeve publike dhe për qasje në shërbimet e komunikimeve publike, të zbatueshëm në situata të jashtëzakonshme. Në kuptim të këtij ligji, me situatë të jashtëzakonshme kuptojmë dëmtimet e rënda të rrjetit, fatkeqësitë natyrore, gjendjen e emergjencës, ose gjendjen e luftës.

3. Planet, sipas paragrafit 2. të këtij neni, duhet të sigurojnë qasje të pandërprerë dhe përdorimin e numrave të emergjencës.

4. Planet detyrojnë ndërmarrësit të zbatojnë masat emergjente përgjatë gjithë kohëzgjatjes së situatës së jashtëzakonshme.

5. Ministri, në bashkëpunim me strukturat e tjera, të caktuara me ligj për trajtimin e situatave të jashtëzakonshme dhe me Autoritetin, i propozon Qeverisë masat, që duhet të përfshihen në planet e veprimit, sipas paragrafit 1. të këtij neni.

6. Ofruesit e shërbimeve dhe rrjetave të komunikimeve elektronike duhet dhënë prioritet absolut komunikimeve për shërbime emergjente dhe të sigurojnë qasje të pandërprerë institucioneve që ofrojnë shërbime të thirrjeve emergjente, përfshirë këtu çfarëdo komunikimi që ka të bëjë me sigurinë tokësore, ajrore, hapësinore dhe gjithashtu komunikimeve epidemiologjike me urgjencë ekstreme siç definoohen nga Organizata Botërore e Shëndetësisë. Shfrytëzuesit e radiostacioneve duhet të sigurojnë pranimin e sinjaleve dhe mesazheve për raste fatkeqësie nga cilido resurs dhe duke iu dhënë prioritet absolut, përgjigjur me shpejtësi dhe duke ndërmarrë veprime të menjëhershme.

Neni 76
Bashkëpunimi i ndërmarrësve në raste të veçanta

1. Ndërmarrësit duhet të bashkëpunojnë ndërmjet tyre dhe me organizatat qeveritare, ndërqeveritare dhe jofitimprurëse për përdorimin e resurseve të komunikimeve elektronike, për lehtësimin dhe përballimin e rasteve të veçanta:

1.1. duke vendosur pajisje të komunikimit tokësor dhe satelitor për parandalimin, mbikëqyrjen dhe sigurimin e parandalimit të dëmeve natyrore, fatkeqësive në përgjithësi e atyre shëndetësore në veçanti;

1.2. duke informuar për fatkeqësitë natyrore dhe shëndetësore, nëpërmjet organizatave përkatëse dhe dhënien e informatave publikut, veçanërisht në komunitetet që rrezikohen më tepër;

1.3. duke vendosur dhe vënë në punë shërbimet e komunikimeve elektronike fleksibile, që përdorin organizatat humanitare.

2. Për lehtësimin e realizimit të masave të mësipërme, ndërmarrësit mund të lidhin marrëveshje të veçanta dhe të vendosin pagesa të veçanta ose të nënshkruajnë shtesa në marrëveshjet ekzistuese.

Neni 77
Ofrimi i shërbimeve universale gjatë grevave

Ofruesit e shërbimit universal janë të obliguar që paraprakisht të caktojnë punonjësit të cilët gjatë grevave do të sigurojnë në mënyrë të pandërprerë shërbimin universal, ose kryerjen e obligimeve sipas nenit 76 të këtij ligji.

KREU XII
FUNKSIONIMI I AUTORITETIT

Neni 78
Statusi dhe Bordi

1. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare është person juridik, publik. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare drejtohet nga Bordi, i cili është i pavarur në marrjen e vendimeve dhe funksionon në bazë të statutit dhe rregullores së brendshme, të miratuar nga Bordi.

2. Anëtarët dhe Kryetarin e Bordit me rekomandim të Ministrit i propozon Qeveria dhe emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

3. Kur mandati i anëtarit të Bordit i përfundon, i njëjti vazhdon të kryejë funksionet e tij derisa të zgjidhet anëtari i ri i Bordit, në pajtim me paragrafin 1. dhe 2. të këtij neni.

4. Bordi i Autoritetit përbëhet nga pesë (5) anëtarë njëri prej të cilëve është Kryetar. Mandati i anëtarëve të Bordit është pesë (5) vjeçar. Anëtari i Bordit nuk mund të shërbejë me shumë se dy (2) mandate. Kryetari, udhëheqë takimet dhe aktivitetet e bordit, dhe merr përgjegjësinë për administrimin e Autoritetit.

4.1. Kryetari do të:

4.1.1. përfaqësojë Autoritetin;

4.1.2. drejtojë mbledhjet e Bordit;

4.1.3. nënshkruajë vendimet dhe dokumentet tjera të Autoritetit;

4.1.4. mbikëqyrë për zgjedhjen, punësimin, përfundimin dhe drejtimin e përgjithshëm të stafit; dhe

4.1.5. kryejë punë tjera që parashikohen në këtë ligj, në legjislacionin tjetër në fuqi, si dhe në Statutin e Autoritetit.

4.2. Në mungesë të Kryetarit të Autoritetit, sipas nenit 80 të këtij ligji, Bordi cakton njërin nga anëtarët e Bordit, si ushtrues detyre i Kryesuesit për një periudhë gjashtë (6) muajsh.

5. Anëtarët e Bordit duhet të jenë specialistë, me arsim të lartë, të kualifikuar, që kanë, të paktën, shtatë (7) vjet përvojë pune dhe të jenë përfaqësues nga sektori i komunikimeve elektronike, i ekonomisë dhe i drejtësisë.

6. Secili anëtar i Bordit, pas emërimit, duhet të japë dorëheqje nga çdo post ose funksion zyrtar, të tërhiqet nga çdo veprimtari private fitimprurëse, si dhe të shesë e të shlyejë çdo interes financiar, që mund të ketë në ndërmarrje, që ushtrojnë veprimtari komerciale nën juridiksionin e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

7. Asnjë anëtar i Bordit nuk ka të drejtë brenda periudhës një (1) vjeçare pas përfundimit të mandatit si anëtar i Bordit të punësohet në pozita menaxheriale apo audituese të ndërmarrjeve që kanë qenë të mbikëqyrura apo kontrolluara nga Autoriteti.

8. Pas ndarjes zyrtare nga Bordi, një person apo ndërmarrësi në të cilën anëtari i Bordit ose të afërmit e tij ose anëtarët e familjes kanë më shumë se dhjetë përqind (10%) të aksioneve në formë kapitali apo në formë materiali tjetër, ose janë të punësuar në struktura menaxheriale ose institucione auditimi, nuk do të kenë të drejtë që gjatë periudhës një (1) vjeçare të hyjnë në marrëdhënie kontraktuale me Autoritetin ose të kërkojnë privilegje individuale të ofruara nga Autoriteti për një periudhë një (1) vjeçare menjëherë para lëshimit të shërbimit.

9. Kufizimet e përcaktuara nga paragrafi 7. i këtij neni nuk aplikohen kur kontrata është arritur para se personi është bërë pjesë e Bordit, gjithashtu edhe për kontratat që janë dhënë nëpërmjet tenderit publik dhe për kontratat që nuk kalojnë vlerën dhjetë mijë (10,000) Euro në vit.

10. Nuk mund të jetë anëtar i Bordit:

10.1. personi, bashkëshorti ose të afërmit deri në shkallë të dytë, që kanë lidhje me anëtarët e Qeverisë;

10.2. personi që është dënuar më shumë se gjashtë (6) muaj me burg nga gjykata për kryerjen e një vepre penale, me vendim të formës së prerë;

10.3. personi, që është debitor, kreditor ose aksionar në një shoqëri, e cila i nënshtrohet kuadrit rregullator të Autoritetit;

10.4. personi, që përjashtohet me ligj për të mbajtur poste publike shtetërore.

Neni 79

Vendimmarrja dhe struktura e Bordit

1. Bordi merr vendimet me shumicë votash, kur janë të pranishëm të paktën tre (3) anëtarë. Secili anëtar, duke përfshirë edhe kryesuesin, ka të drejtën e një vote dhe votat e shumicës së votuesve duhet të jenë prezentë për çfarëdo çështjeje që ka të bëjë me punën e Autoritetit. Në rast se ndodh bllokim i votimit si rezultat i votave të barabarta atëherë vota e kryesuesit ka peshë më të madhe dhe është vendimtare.

2. Bordi i Autoritetit merr vendime në emër të Autoritetit .

3. Në rast të konfliktit të interesit sipas Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike në Republikën e Kosovës, në procesin e votimit nuk marrin pjesë anëtarët e Bordit të Autoritetit.

4. Anëtarët e Bordit nuk e kanë statusin e shërbyesit civil. Anëtarët e Bordit paguhen në bazë të skemës së pagave dhe mëditjeve për anëtarët e Bordeve të Pavarura dhe miratohet nga Kuvendi i Kosovës për çdo vit me Ligjin e Buxhetit vjetor deri në nxjerrjen e ligjit për pagat e funksionarëve publik ose ligji tjetër që rregullon këtë fushë.

5. Statusi i stafit profesional të Autoritetit trajtohet sipas Ligjit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe paguhen sipas Ligjit për pagat e nëpunësve civil.

6. Struktura organizative përcaktohet nga Bordi në përputhje me ligjet në fuqi.

7. Bordi definon rregullat e punësimit dhe kriteret në bazë të legjislacionit në fuqi.

Neni 80

Lirimi dhe shkarkimi i anëtarëve të Bordit

1. Anëtari i Bordit lirohet ose shkarkohet nga organi që e ka zgjedhur kur:

1.1. është në pamundësi fizike dhe mendore për t'i kryer funksionet e ngarkuara;

1.2. gjatë ushtrimit të detyrës, është dënuar nga gjykata me vendim të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale;

- 1.3. zgjidhet ose kandidon si deputet i Kuvendit ose në organet e pushtetit vendor, me përjashtim të rastit kur është anëtar i shoqatave profesionale dhe mban funksione në to;
 - 1.4. pa shkak të arsyeshem, nuk ka pranuar të kryejë ose nuk kryen detyrën ose është i paaftë për të ushtruar detyrën për një periudhë gjashtë (6) mujore ose më shumë;
 - 1.5. përfshihet në ndonjërin nga dispozitat e paragrafi 10., të nenit 78 të këtij ligji;
 - 1.6. vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji;
 - 1.7. kur i plotëson kushtet për dalje në pension;
 - 1.8. pas kërkesës që e bën për lirim nga detyra si anëtar apo/dhe Kryetar i Bordit;
 - 1.9. pas skadimit të mandatit.
2. Kur një anëtar lirohet ose shkarkohet nga detyra, sipas paragrafit 1. të këtij neni, anëtari i ri emërohet nga organi përkatës, sipas nenit 78 të këtij ligji.
 3. Anëtari i shkarkuar apo liruar i Bordit nuk ka të drejtë të riemërohet në Bord, përveç në rastet që i referohen, nën-paragrafëve 1.8 dhe 1.9 të paragrafit 1. të këtij neni.
 4. Vendimi për të shkarkuar një anëtar të Bordit duhet të bëhet publik në momentin e shkarkimit. Anëtari i shkarkuar i Bordit duhet të marrë arsyeshmërinë e vendimit për shkarkim dhe ka të drejtë të kërkojë publikimin e arsyeve për të cilat është shkarkuar.

Neni 81

Financimi dhe buxheti i Autoritetit

1. Burimet e financimit të Autoritetit sigurohen nga Buxheti i Kosovës, përmes të hyrave të Autoritetit në pajtim me nenin 83 të këtij ligji.
2. Autoriteti përgatit projektbuxhetin dhe dorëzon për shqyrtim dhe miratim në Kuvend, në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
3. Autoriteti duhet të mbajë llogari të plota dhe të sakta të shpenzimeve faktike si dhe auditimin e pasqyrave financiare, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontabilitet dhe auditim në Republikën e Kosovës.
4. Autoriteti i raporton Kuvendit për shpenzimet buxhetore me raportin vjetor, më së voni deri me 30 Mars të vitit vijues kalendarik dhe raportim të veçantë kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi.

Neni 82

Konsultimet publike

1. Autoriteti gjatë aprovimit të akteve normative në bazë të këtij ligji apo gjatë zbatimit të akteve juridike që pritet të kenë ndikim të rëndësishëm në ndonjë treg relevant, përveç në rastet që i referohen paragrafit 4. të nenit 32 të këtij ligji dhe në rastet e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, duhet të publikojë draftet e akteve të tilla juridike në pajtim me procedurat dhe kushtet e vendosura nga Autoriteti, duke ua ofruar mundësinë personave të interesuar që në afat të arsyeshëm kohor të shprehin pikëpamjet e veta.
2. Autoriteti duhet, varësisht prej rasteve, procedurës dhe kushteve të vendosura nga vetë ai, t'i publikojë draftet e vendimeve të veta që kanë të bëjnë me çështjet e të drejtave të konsumatorëve dhe shfrytëzuesve fundorë në relacion me shërbimet e komunikimeve elektronike publike, posaçërisht kur vendimet e tilla kanë ndikim të madh në treg, duke ua ofruar mundësinë shfrytëzuesve fundorë dhe konsumatorëve (posaçërisht shfrytëzuesve me nevoja të veçanta), prodhuesve dhe ofruesve të shërbimeve dhe/ose rrjetave të komunikimeve elektronike që në afat të arsyeshëm kohor të shprehin pikëpamjet e veta.
3. Autoriteti duhet të konsultojë personat e interesuar kur merr vendime që kanë të bëjnë me zbatimin e obligueshëm të standardeve ndërkombëtare, të Bashkimit Evropian, standardeve rajonale, si dhe atyre kombëtare.
4. Autoriteti duhet të aprovojë rregulla për konsultime duke definuar rastet, procedurat dhe kushtet e konsultimeve. Informatat që kanë të bëjnë me çfarëdo konsultimi në vijim duhet të publikohen në faqen elektronike të Autoritetit. Autoriteti duhet të publikojë rezultatet e konsultimeve, përveç informatave që janë konfidenciale, ose ato që kanë të bëjnë me jetën private të personave fizik.
5. Dokumentacioni i skeduar i Autoritetit është i hapur për publikun gjatë një kohe të caktuar, brenda orarit zyrtar të punës. Këto skedarë përfshijnë dokumentacionin, që indeksohet sipas udhëzimeve, procedurave dhe standardeve të definuara nga Bordi i Autoritetit duke respektuar parimin e ruajtjes së sekretit.
6. Dokumentacioni i rëndësishëm, si: vendimet, kriteret, procedurat për njoftim, dhënien e autorizimit të së drejtës së përdorimit, autorizimet e dhëna, rregullat e rregulloret teknike, standardet, etj. publikohen në uebfaqen e Autoritetit.

Neni 83

Pagesat

1. Në Buxhetin e Kosovës bëhen pagesat lidhur me veprimtarinë e Autoritetit, si në vijim:
 - 1.1. pagesa për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike, sipas përcaktimeve në nenin 27 të këtij ligji;
 - 1.2. pagesa për financimin e shërbimit universal;
 - 1.3. pagesa për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, sipas përcaktimeve në nenin 57 të këtij ligji;

- 1.4. pagesa për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe të serive numerike;
- 1.5. pagesat nga dënimet ekonomike të shqiptuara nga Autoriteti;
2. çdo taksë apo pagesë tjetër e paraparë me këtë ligj depozitohet në Buxhetin e Kosovës.

KREU XIII MOSMARRËVESHJET

Neni 84 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Autoriteti, bazuar në kornizën e procedurës paraprake jashtëgjyqësore dhe të detyrueshme zgjidh mosmarrëveshjet që kanë të bëjnë me subjektin e këtij ligji që shfaqen në mes të ndërmarrësve që ofrojnë rrjeta dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike, duke përfshirë edhe ato të cilat lidhen me çështjet e përdorimit të përbashkët të faciliteteve dhe aseteve.
2. Ndërmarrësi që aplikon në Autoritet për zgjidhje të mosmarrëveshjes (përfshirë këtu rastet kur rinovimi i zgjidhjes së mosmarrëveshjes kërkohet) duhet t'i paguaj Autoritetit një pagesë për zgjidhje të mosmarrëveshjes që caktohet në bazë të procedurës dhe kushteve të vendosura në bazë të këtij ligji. Kur aplikacioni zgjidhet plotësisht apo pjesërisht në favor të paditësit i padituri pas kërkesës së aplikantit mund të urdhërohet nëpërmjet një vendimi, të kompensojë aplikantin, me shumën që është në proporcion të drejtë me nivelin e zgjidhjes pozitive të çështjes së ngritur nga aplikanti. Nëse kostoja e zgjidhjes së mosmarrëveshjes e tejkalon shumën e pagesës së bërë nga aplikanti, Autoriteti ka të drejtë gjatë vendimmarrjes për çështjen e ngritur ta distribuojë koston e zgjidhjes së mosmarrëveshjes në mes të palëve, duke marrë parasysh se sa dhe a është zgjidhur mosmarrëveshja dhe në favor të kujt (proporcionalisht me nivelin e zgjidhjes apo refuzimit të çështjes). Në rast se aplikacioni refuzohet, nuk merret parasysh apo marrja e më tutjeshme në konsideratë është shkëputur, Autoriteti nuk e kompenzon pagesën e bërë nga aplikanti.
3. Me kërkesë të palës fituese të shpallur nga Autoriteti, Autoriteti mund ta urdhërojë palën tjetër që ta kompensojë palën fituese për koston e shkaktuar nga procesi i zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Në këtë rast aplikohen dispozitat e legjislacionit për Procedurë Civile në fuqi. Pala në favor të të cilit vendimi është marrë ka të drejtë në kompensim të shpenzimeve të paguara për shërbimet e avokatisë apo shërbimeve ndihmëse të avokatisë në përputhje me dispozitat përkatëse të legjislacionit në fuqi për Procedurës Civile.
4. Kur të pranohet një kërkesë për zgjidhje të mosmarrëveshjes, aplikohen dispozitat përkatëse të legjislacionit në fuqi.
5. Autoriteti zgjidhë mosmarrëveshjen në përputhje me parimet dhe objektivat e këtij ligji, si dhe në përputhje me parimet e përqendrimit dhe efikasitetit të koston, bashkëpunimit,

konkurrencës, gatishmërisë dhe barazisë procedurale të palëve të referuara në dispozitat përkatëse të legjislacionit në fuqi që do të aplikohen *mutatis mutandis*, përveç nëse parashihet ndryshe në këtë ligj.

6. Autoriteti refuzon aplikacionin për zgjidhje të mosmarrëveshjes në rastet si në vijim:

6.1. nuk është në kompetencën e tij aplikacioni për zgjidhje të mosmarrëveshjes;

6.2. një vendim nga Autoriteti, gjykata apo gjykata e arbitrazhit ka hyrë në fuqi për mosmarrëveshjen në mes të palëve të njëjta, për subjektin e njëjtë dhe në baza të njëjta, apo vendimi nga Autoriteti ose gjykata që ta refuzojë për të pranuar heqjen dorë të aplikuesit nga aplikimi për zgjidhje të mosmarrëveshjes ose që të pranojë një zgjidhje kompromisi;

6.3. zgjidhja e mosmarrëveshjes në mes të palëve të njëjta, me të njëjtin subjekt dhe në baza të njëjta është në proces nga Autoriteti apo në pritje për t'u zgjidhur nga gjykata;

6.4. palët pajtohen që çështjen ta zgjidhin nëpërmjet arbitrazhit dhe i padituri kërkon që kjo të merret parasysh dhe të respektohet nga Autoriteti, përveç rasteve kur çështja është e tillë që nuk mund të zgjidhet në bazë të ligjit nëpërmjet arbitrazhit;

6.5. aplikimi për zgjidhje të mosmarrëveshjes është bërë nga personi i paautorizuar në emër të ndërmarrësit.

7. Autoriteti duhet që ta ndërpres procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes nëse rrethanat që i referohen nën-paragrafëve 6.1., ose 6.2., të paragrafit 6. të këtij neni bëhen të njohura, por edhe në rastet nëse:

7.1. aplikanti e ka tërhequr aplikacionin për zgjidhje të mosmarrëveshjes dhe Autoriteti e ka pranuar tërheqjen;

7.2. zgjidhja e mosmarrëveshjes në mes të palëve të njëjta, me të njëjtin subjekt dhe në baza të njëjta është në procedurë gjyqësore;

7.3. palët kanë arritur marrëveshje kompromisi, e cila është aprovuar nga Autoriteti. Në këtë rast marrëveshja e tillë e kompromisit është vendim i detyrueshëm i lëshuar nga Autoriteti.

8. Autoriteti nuk do ta marrë në konsiderim zgjidhjen e mosmarrëveshjes nëse rrethanat që i referohen nën-paragrafëve 6.4. ose 6.5 të paragrafit 6. të këtij neni bëhen të njohura dhe gjithashtu në rast se:

8.1. Autoriteti është duke e shqyrtuar mosmarrëveshjen në mes të palëve të njëjta, me subjekt të njëjtë dhe me bazë të njëjtë;

8.2. aplikacioni për zgjidhje të mosmarrëveshjes ka mangësi të tilla, siç janë dështimi për ta bërë pagesën, apo për ta vërtetuar bërjen e pagesës për zgjidhje të mosmarrëveshjes Autoritetit dhe në rast se aplikanti ka dështuar që ta qartësojë

situatën që ka të bëjë me mosmarrëveshjen brenda afatit kohor të përcaktuar nga Autoriteti.

9. Autoriteti pezullon marrjen parasysh të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në rastet si në vijim:

9.1. njëra nga palët pushon së ekzistuari (rasti duhet të pezullohet derisa të drejtat dhe detyrimet e palës që ka pushuar së ekzistuari janë bartur në apo deri kur rrethanat për shkak të të cilave këto të drejta dhe obligime nuk mund të barten, nuk janë bërë të njohura). Kur është e mundur që të bëhet identifikimi i ankesave që nuk kanë të bëjnë me palën që ka pushuar së ekzistuari, Autoriteti do të vazhdojë të marrë parasysh ankesën për aq sa ankesa nuk është e ndërlidhur me këtë palë;

9.2. përderisa një ankesë tjetër nuk merret parasysh nga Autoriteti, ose një rast tjetër është duke pritur për t'u zgjidhur në gjykatë, pa zgjidhjen e së cilës ankesa në pritje nuk mund të merret parasysh.

10. Autoriteti mund që me kërkesë të cilësdo palë, apo me kërkesë të cilitdo person, ose ndërmarrësi të interesuar, apo me vetiniciativë, të ndërmarrë masa paraprake të përkohshme mbrojtëse p.sh. lëshojë urdhëresë për mosndërmarrje të veprimeve të caktuara, apo të ndërmarrë hapa të caktuar, sepse nëse ndodhin dështime për të ndërmarrë hapa të tillë zbatimi i vendimit nga Autoriteti për zgjidhjen e mosmarrëveshjes do të bëhej shumë më i vështirë, apo i pamundur. Kur të ndërmerren masa të përkohshme mbrojtëse dispozitat përkatëse të legjislacionit në fuqi do të aplikohen *mutatis mutandis*. Masat e përkohshme duhet të jenë në fuqi përderisa vendimi që ka të bëjë me mosmarrëveshjen i lëshuar nga Autoriteti nuk është i plotfuqishëm, përveç në rastet kur Autoriteti e revokon atë me kërkesë të cilësdo palë, apo me kërkesë të cilitdo person, ose ndërmarrësi të interesuar, apo me vetiniciativë. Vendimi për masa paraprake të përkohshme mbrojtëse i lëshuar nga Autoriteti mund të apelohej në Gjykatën kompetente brenda afatit shtatë (7) ditor. Skedimi i ankesës në gjykatë nuk e suspendon marrjen parasysh shqyrtimin e mosmarrëveshjes nga Autoriteti. Apeli duhet të skedohet dhe të merret në shqyrtim në pajtim me procedurën e përshkruar në paragrafin 18. të këtij neni.

11. Palët në mosmarrëveshje, personat tjerë dhe ndërmarrësit e interesuar që marrin pjesë në shqyrtimin e mosmarrëveshjes kanë të drejtë të kenë qasje në materialin e lëndës së mosmarrëveshjes, përveç rasteve kur ky material përmban informata konfidenciale të ndërmarrësve, apo kur zbulimi i këtyre informatave do ta shkelë privatësinë e personave fizik. I padituri ka të drejtë që të ketë gjithmonë qasje në tekstin e aplikacionit për zgjidhje të mosmarrëveshjes, ndërsa aplikanti ka gjithmonë të drejtë të ketë qasje në tekstin e mbrojtjes së të paditurit. Palët në mosmarrëveshje, apo personat, ose ndërmarrësit tjerë pjesëmarrës gjatë zgjidhjes së mosmarrëveshjes mund të paraqesin dëshmi, sqarime, argumente dhe përgjigje në padi në Autoritet, në bazë të kërkesës, argumentimit dhe përgjigjeve në padi nga palët, personat dhe ndërmarrësit tjerë pjesëmarrës në procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, pranojnë kopjet e vendimeve të zgjidhjes së mosmarrëveshjes të lëshuara nga Autoriteti, apelojnë kundër këtyre vendimeve të Autoritetit dhe të ushtrojnë të drejtat tjera të parapara me këtë ligj dhe rregullat tjera të lëshuara nga Autoriteti për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Aplikanti ka të drejtë ta tërheqë aplikacionin për zgjidhje të mosmarrëveshjes. I padituri ka të drejtë ta marrë aplikacionin. Palët në konflikt mund të përfundojnë shqyrtimin e mëtutjeshëm të procesit të zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke arritur marrëveshje kompromisi. Palët në konflikt, ndërmarrësit

tjerë dhe personat tjerë të interesuar që marrin pjesë në procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes duhet të ushtrojnë të drejtat e tyre në mënyrë të drejtë.

12. Autoriteti i merr parasysh proceset për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në mënyrë të shkruar, përveç nëse vendos ndryshe me kërkesë të ndonjërës palë në konflikt, apo me kërkesë të ndonjë personi dhe ndërmarrësi tjetër të interesuar, apo edhe me vetiniciativë që zgjidhja e mosmarrëveshjes me seanca dëgjimore do të marrë parasysh zgjidhjen e mosmarrëveshjes në mënyrë më të mirë. Autoriteti i informon palët për mbledhjet; megjithatë dështimi i cilësdo palë që të paraqitet nuk e ndalon Autoritetin ta zgjidhë mosmarrëveshjen, përveç nëse përshkruhet ndryshe në rregullat e vendosura nga Autoriteti për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në mes të ndërmarrësve. Mbledhjet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve janë publike, përveç në rastet kur Autoriteti vendos që mbledhjet e tilla të jenë të mbyllura për shkak të mbrojtjes së konfidencialitetit të informatave, apo mbrojtjes e privatësisë së personave fizikë.

13. Autoriteti ka të drejtë ta refuzojë pranimin e dëshmive, kërkesave dhe motiveve nëse këto kanë mundur të dorëzohen më herët në Autoritet.

14. Autoriteti merr vendim për zgjidhje të mosmarrëveshjes jo më larg se katër (4) muaj nga data e pranimin të aplikacionit, përveç në rastet kur nevojitet kohë më e gjatë e imponuar nga rrethanat e jashtëzakonshme (numri i madh i dëshmive, rrethanat e komplikuar për zgjidhje të mosmarrëveshjes etj).

15. Vendimi i Autoritetit (përfshirë vendimet procedurale të bëra gjatë procesit të zgjidhjes së mosmarrëveshjes) duhet të jetë në fuqi dhe të jetë detyrues nga dita e vendimmarrjes. Vendimi mbetet në fuqi dhe është detyrues edhe nëse apelohe në gjykatë, përveç në rastet kur gjykata vendos ndryshe në pajtim me procedurat e përcaktuara me ligj.

16. Vendimet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të lëshuara nga Autoriteti duhet të jenë publike deri në masën që nuk cenojnë konfidencialitetin e informatave dhe privatësinë e personave fizikë. Rregullat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në mes të ndërmarrësve të vendosura nga Autoriteti duhet të përcaktojnë procedurat e qarta për palët në konflikt, personat dhe ndërmarrësit tjerë që marrin pjesë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në të cilat duhet të specifikohet se cilat informata në tekst të vendimmarrjes mund të jenë konfidenciale. Rregullat për interpretim të ligjit të vendosura në tekst duhet të jenë publike në çfarëdo rasti. Palët në konflikt duhet të njoftohen me detajet dhe arsyeshmërinë e vendimit të lëshuar nga Autoriteti.

17. Vendimet procedurale të lëshuara nga Autoriteti gjatë procesit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, përfshirë vendimet për të refuzuar aplikacionin, vendimin për mosmarrje parasysh të lëndës, suspendimin e procesit për zgjidhje të mosmarrëveshjes, si dhe vendimet tjera procedurale, të cilat parandalojnë procesin e mëtutjeshëm për zgjidhje të mosmarrëveshjes, mund të apelohe konform dispozitave të ligjeve përkatëse në fuqi në Gjykatën kompetente në afat prej shtatë (7) ditësh nga data e dërgimit të vendimit tek personat, apo ndërmarrësit e interesuar. Aktvendimi i dorëzuar nga gjykatësi i kësaj Gjykate, sa i përket vendimit të Autoritetit nuk duhet të jetë objekt i ankesës.

18. Vendimi i Autoritetit për zgjidhje të mosmarrëveshjes, apo për ndërprerjen e procesit mund të apelohe në Gjykatën kompetente brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve nga data e marrjes së vendimit.

19. Vendimi i Autoritetit (përfshirë vendimet procedurale gjatë procesit të zgjidhjes së mosmarrëveshjes), është dokument me fuqi ekzekutive. Nëse vendimi nuk ekzekutohet me procese normale, ky vendim mund të ekzekutohet në mënyrë detyruese në pajtim me procedurën e përshkruar në ligjet perkatëse në fuqi. Vendimi mund të ekzekutohet jo më vonë se brenda afatit prej dhjetë (10) viteve nga data e marrjes së vendimit.

20. Procedura për marrje parasysh të zgjidhjes së mosmarrëveshjes nga Autoriteti mund të rinovohet konform *mutatis mutandis* me procedurën e përshkruar në Legjislacionin përkatës në fuqi.

21. Autoriteti aprovon rregullore për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në mes të ndërmarrësve nga vetë ai. Rregullat duhet të specifikojnë në mënyrë të qartë kërkesat për formën, përmbajtjen dhe skedimin e aplikacionit për zgjidhje të mosmarrëveshjes, paraqitjen dhe mbledhjen e fakteve; këto rregulla duhet ta specifikojnë kornizën, procedurat dhe kushtet për aplikim, revokim dhe ndryshim të masave të përkohshme mbrojtëse dhe vendosjen e procedurës së detajuar për zgjidhje të mosmarrëveshjes.

22. Ndërmarrësit që ofrojnë rrjeta dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike kanë të drejtë që ta ftojë Autoritetin të ndërmjetësojë apo/dhe të arrijë pajtim në mes të ndërmarrësve për të zgjidhur mosmarrëveshjen që është subjekt i këtij ligji, duke përdorur metoda kompromisi, pa marrë vendime detyruese. Autoriteti do të vendosë rregulla relevante për procedura të tilla.

KREU XIV

PROCESIMI I TË DHËNAVE PERSONALE DHE MBROJTJA E PRIVATËSISË NË SEKTORIN E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

Neni 85

Siguria, integriteti dhe besueshmëria

1. Ofruesi i shërbimit të komunikimeve elektronike publike duhet të ndërmarrë masa adekuate teknike dhe organizative për ta mbrojtur sigurinë e shërbimeve. Duke pasur parasysh vlerën dhe koston e zbatimit, këto masa duhet të sigurojnë një nivel të duhur të sigurisë për rrezikun e paraqitur. Në veçanti, masat duhet të merren që të parandalojnë dhe zvogëlojnë ndikimin e incidenteve të sigurisë në shfrytëzuesit dhe rrjetat ndërlidhëse.

2. Në rast të rrezikut të veçantë për sigurinë e rrjetit, ofruesi i shërbimit të komunikimeve elektronike publike duhet t'i informojë parapaguesit lidhur me një rrezik të tillë dhe, aty ku rreziku qëndron jashtë sferës së masave që mund të ndërmerren nga ofruesi i shërbimit, për ndonjë zgjidhje (kompensim) të mundshme, duke përfshirë indikacionin e kostos që ka mundësi të ndodhë.

3. Ndërmarrësit që ofrojnë rrjeta të komunikimeve publike duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar vazhdimësinë e shërbimeve të ofruara për këto rrjeta.

4. Autoriteti mund të vendosë kërkesat teknike dhe organizative që garantojnë siguri, integritet dhe besueshmëri për rrjetat e komunikimeve publike dhe për shërbimet komunikuese elektronike publike.

5. Ndërmarrësit që ofrojnë rrjeta për komunikime publike, ose shërbime komunikuese elektronike publike duhet të njoftojnë Autoritetin në përputhje me rregulloren e përcaktuar nga ajo për prishje të sigurisë ose humbje të integritetit që ka pasur ndikim të rëndësishëm në funksionimin e rrjetave ose shërbimeve. Autoriteti mund t'i informojë njerëzit, ose mund të kërkojnë ta bëjnë vetë ndërmarrësit, kur konstaton që zbulimi i prishjes është në interes të publikut.

6. Gjatë garantimit të sigurisë, integritetit dhe besueshmërisë së shërbimeve dhe rrjetave të komunikimeve elektronike publike, parandalimit të përhapjes së incidenteve të sigurisë, zvogëlimin të rrezikut për humbje nga ana e ofruesve të shërbimeve dhe/ose rrjetave të komunikimeve elektronike publike dhe/ose nga ana e shfrytëzuesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike, si pasojë e këtyre incidenteve, Autoriteti mund të lëshojë urdhra detyrues për ndërmarrësit që ofrojnë shërbime dhe/ose rrjeta të komunikimeve elektronike publike dhe të vendosë afate kohore për zbatimin e këtyre detyrimeve. Urdhrat detyrues që i referohen këtij paragrafi mund të përfshijnë obligimet për auditim të sigurisë që duhet të bëhet nga një organ i kualifikuar dhe i pavarur dhe që rezultatet e auditimit t'i vihen në dispozicion Autoritetit. Kostot e auditimit që i referohen këtij paragrafi duhet të barten nga ndërmarrësi.

7. Konsumatorët dhe përdoruesit tjerë fundor, nëse kërkojnë, duhet të kenë mundësin që të lidhin kontratë me ndërmarrësit tjerë që ofrojnë shërbime dhe/ose rrjete të komunikimeve elektronike ose qasje në rrjetet publike të komunikimeve elektronike.

7.1 Kontrata së paku duhet të përmbajë:

7.1.1 emrin dhe adresën e ndërmarrësit;

7.1.2 shërbimet e ofruara, duke përfshirë:

7.1.2.1 a ofrohet apo jo qasje në shërbimet emergjente dhe informacionin për lokacionin e thirrësit, dhe çfarëdo kufizimi në ofrimin e shërbimeve të emergjencës ;

7.1.2.2 informacionin për kushtet tjera që kufizojnë qasjen dhe/ose përdorimin e aplikacioneve dhe shërbimeve, aty ku këto kushtëzime janë të lejuara në bazë të legjislacionit në fuqi;

7.1.2.3 niveli më i ulët i kualitetit të shërbimit të ofruar, d.m.th. koha për iniciimin e thirrjes dhe, ku është e përshtatshme, parametrat tjerë të kualitetit të shërbimeve të definuara nga Autoriteti;

7.1.2.4 informacionin për procedurat e ndërmarra nga ndërmarrësi për matje dhe modifikim të trafikut për të shmangur mbingarkimin e rrjetit dhe informacionin se si këto procedura ndikojnë në kualitetin e shërbimit;

7.1.2.5 informatat për llojet e mirëmbajtjeve dhe përkujdesjes së ofruar ndaj konsumatorëve, si dhe mënyrat për shfrytëzim të këtyre shërbimeve;

7.1.2.6 çfarëdo kufizimi për shfrytëzim të pajisjeve fundore të ofruara nga ndërmarrësi;

7.2. detajet për çmimet dhe tarifat, mënyrën se si informatat e përditësuara për të gjitha tarifat dhe shpenzimet e mirëmbajtjes mund të merren, mënyrat e ofruara të pagesës, si dhe çdo diferencë në çmime varësisht nga mënyra e pagesës;

7.3. kohëzgjatja e kontratës dhe kushtet për përtëritje të kontratës, përfundimin e kontratës si dhe përfundimin e shërbimeve, duke përfshirë:

7.3.1. përcaktimin e kohëzgjatjes minimale për të përfituar nga ofertat promovuese;

7.3.2. çfarëdo pagese për bartshmërinë e numrave dhe identifikuesve tjerë

7.3.3. çfarëdo pagese lidhur me shkëputjen e kontratës, përfshirë këtu pagesat që kanë të bëjnë me pajisjet fundore;

7.3.4. kompensimin dhe rimbursimin në rastet kur shërbimi i ofruar nuk është në nivel të cilësisë së kontraktuar;

7.3.5. mënyrën e inicimit të procedurës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

7.3.6. llojin e veprimit të cilin mund ta marrë ndërmarrësi për të reaguar ndaj sigurisë ose cenimit të integritetit dhe kërcënimeve .

7.4. kontrata mund të përmbajë gjithashtu çfarëdo informacioni për kufizime që rrjetat dhe/ose shërbimet e komunikimeve elektronike të mos përdoren për aktivitete të jashtë ligjshme apo për shpërndarje të përmbajtjeve të dëmshme si dhe për mënyrat për tu mbrojtur nga rreziqet për sigurinë personale, privatësinë dhe të dhënat personale.

7.5. parapaguesit kanë të drejtë që të shkëpusin kontratën e tyre pa u ndëshkuar pas paralajmërimit për modifikim të kushteve të kontratës të propozuara nga ndërmarrësit që ofrojnë shërbime dhe/ose rrjete të komunikimeve elektronike. Parapaguesit duhet të informohen për të gjitha ndryshimet e propozuara në kushtet e kontratës jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para futjes së këtyre ndryshimeve. Në rast të mospajtitimit me ndryshimet e kushteve, parapaguesi ka të drejtë që, pa asnjë pasojë, të shkëput kontratën. Autoriteti duhet të specifikojë qartë formën për paralajmërimin e ndryshimit të kushteve të kontratës.

Neni 86

Fshehtësia e komunikimit

1. Fshehtësia e komunikimit dhe e të dhënave të trafikut të një rrjeti publik komunikues dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike, duhet të mbrohen nga ofruesi i shërbimit. Veçanërisht, ofruesit e shërbimit duhet ta parandalojnë përgjimin, ndërhyrjen në bisedën telefonike, ruajtjen ose format e tjera të kapjes ose të vëzhgimit të komunikimeve dhe të dhënave për trafikun lidhur me të nga personat me përjashtim të shfrytëzuesve, përveç nëse ka autorizim nga gjyqi që ta bëjë një gjë të tillë, në raste individuale, gjithmonë në përputhje me dispozitat e kodit të procedurës penale. Kjo nuk parandalon ruajtjen teknike të domosdoshme për bartjen e komunikimit pa paragjykuar parimin e fshehtësisë.
2. Paragrafi 1. i këtij neni nuk pengon regjistrimin e autorizuar të komunikimeve dhe të të dhënave për trafikun kur kjo kryhet në pajtim me praktikat ligjore biznesore me qëllim të ofrimit të dëshmisë së transaksioneve komerciale, ose për ndonjë komunikim tjetër biznesi.
3. Shfrytëzimi i rrjeteve të komunikimeve elektronike për të ruajtur informacionin ose për të fituar qasje në informacionin e ruajtur në pajisjen terminale të një parapaguesi, ose shfrytëzuesi është i lejuar vetëm me kusht që parapaguesi ose shfrytëzuesi në fjalë është i informuar qartë dhe në mënyrë të plotë me informacionin në përputhje me këtë ligj, ndër të tjera edhe me qëllimet e procesimit, dhe i ofrohet e drejta për të refuzuar një procesim të tillë nga kontrolluesi i të dhënave. Kjo nuk parandalon ndonjë ruajtje teknike, ose qasje vetëm për qëllime të kryerjes ose të lehtësimit të transmetimit të komunikimit përmes një rrjeti të komunikimit elektronik, ose si e domosdoshme në mënyrë që të ofrohet një shërbim i shoqërisë informatike i kërkuar, në mënyrë të qartë nga parapaguesi, ose shfrytëzuesi.
4. Ndërmarrësit duhet të marrin masa për sistemet e komunikimeve elektronike, si dhe sistemet e procesimit të të dhënave, për të mbajtur sekret të dhënat personale të komunikimeve elektronike, si dhe të ndalojë qasjen e paautorizuar në sistemet e komunikimeve elektronike dhe në sistemet e procesimit të të dhënave.
5. Ndërmarrësi, njerëzit e autorizuar dhe punonjësit e tij, janë të obliguar që t'i mbajnë dhe t'i mbrojnë të dhënat dhe konfidencialitetin e komunikimeve, të kryera nëpërmjet rrjetit dhe shërbimeve të tij gjatë aktivitetit, poashtu edhe pas përfundimit të tij.
6. Ndërmarrësi mund të informohet për mesazhet, ose të dhënat e transmetuara përmes rrjetit të tij/saj vetëm deri në masën e nevojshme për të paraqitur detyrimet që dalin nga shërbimi i komunikimeve elektronike.
7. Pranimi, regjistrimi, publikimi dhe përdorimi i të dhënave dhe mesazheve të transmetuara nga rrjeti i komunikimeve elektronike dhe të cilat nuk janë për publikun, po ashtu edhe dispozita për njerëzit e paautorizuar është e ndaluar, vetëm në qoftë se është definuar ndryshe në legjislacionin në fuqi.

Neni 87

Të dhënat për trafikun

1. Të dhënat për trafikun që kanë të bëjnë me parapaguesit dhe shfrytëzuesit të procesuara dhe të ruajtura nga ofruesit e shërbimeve dhe/ose rrjetave të komunikimeve elektronike publike duhet të fshihen ose të bëhen anonime kur nuk janë më të nevojshme për qëllimin e transmetimit të një komunikimi.
2. Të dhënat për trafikun të domosdoshme për qëllimet e faturimit të parapaguesit dhe pagesave për interkoneksion mund të procesohen. Një procesim i tillë është i lejueshëm vetëm deri në fund të periudhës gjatë së cilës fatura mund, sipas ligjit të kundërshtohet ose të paguhet.
3. Për qëllime marketingu të shërbimeve të komunikimeve elektronike, ose për ofrimin e shërbimeve me vlerë të shtuar, ofruesi i shërbimit të komunikimit elektronik në dispozicion për publikun mund t'i procesojë të dhënat e referuara në paragrafin 1. të këtij neni deri në masën dhe kohëzgjatjen e duhur për shërbimet e tilla, ose marketingun, nëse parapaguesi ose shfrytëzuesi me të cilin të dhënat kanë të bëjnë ka dhënë pëlqimin e tij, ose të saj. Shfrytëzuesve, ose parapaguesve duhet t'u jepet mundësia për ta tërhequr pëlqimin e tyre për procesimin e të dhënave për trafikun në çfarëdo kohe.
4. Ofruesi i shërbimit duhet ta informojë parapaguesin, ose shfrytëzuesin për llojet e të dhënave për trafikun që janë dërguar dhe që janë procesuar dhe kohëzgjatjen e procesimeve të tilla për qëllimet e përmendura në paragrafin 2. të këtij neni dhe, para marrjes së pëlqimit për qëllimet e përmendura në paragrafin 3. të këtij neni.
5. Procesimi i të dhënave për trafikun, në përputhje me paragrafët e mëparshëm në këtë nen, duhet të kufizohet për personat që veprojnë bazuar në autoritetin e ofruesve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike publike për trajtimin e faturimit ose menaxhimin e trafikut, pyetjet nga ana e konsumatorit, zbulimin e mashtrimit, shërbimet e marketingut të komunikimeve elektronike, ose ofrimin e një shërbimi me vlerë të shtuar dhe duhet të kufizohen në atë që është e domosdoshme për qëllimet e aktiviteteve të tilla.
6. Paragrafët 1., 2., 3. dhe 5. të këtij neni duhet të zbatohen pa paragjykuar në mundësinë e entiteteve kompetente për të qenë të informuara për të dhënat e trafikut në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm me synimin për të zgjidhur mosmarrëveshjet, veçanërisht mosmarrëveshjet që kanë të bëjnë me interkoneksionin dhe faturimin.

Neni 88

Paraqitja dhe kufizimi i identifikimit të thirrjes dhe linjës së lidhur

1. Në rastet kur ofrohet identifikimi i linjës thirrëse, ofruesi i shërbimit duhet t'i ofrojë thirrësit mundësinë, që në mënyrë të thjeshtë, pa pagesë parandalimin e identifikimit të linjës thirrëse për secilën thirrje veç e veç. Parapaguesi që thërret duhet ta ketë këtë mundësi për secilën thirrje.
2. Në rastet kur ofrohet identifikimi i linjës thirrëse, ofruesi i shërbimit duhet t'i ofrojë parapaguesit të thirrur mundësinë, që në mënyrë të thjeshtë, pa pagesë dhe duke

shfrytëzuar këtë funksion në mënyrë racionale parandalimin e identifikimit të linjës thirrëse të thirrjeve ardhëse.

3. Në rastet kur ofrohet identifikimi i linjës thirrëse dhe kur mund të bëhet prezantimi i linjës së identifikuar para se të vendoset lidhja, ofruesi i shërbimit duhet t'ia ofrojë parapaguesit të thirrur, në mënyrë të thjeshtë mundësinë për të refuzuar thirrjet kur identifikimi i linjës thirrëse është parandaluar nga shfrytëzuesi, apo parapaguesi thirrës.

4. Në rastet kur ofrohet identifikimi i linjës së vendosur, ofruesi i shërbimit duhet t'ia ofrojë parapaguesit të thirrur mundësinë, që në mënyrë të thjeshtë, pa pagesë ta parandalojë identifikimin e linjës së vendosur për shfrytëzuesin e thirrur.

5. Në rastet kur ofrohet identifikimi i thirrjes dhe/ose linjës së vendosur, ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike duhet ta informojnë publikun për mundësitë e paraqitura në paragrafët 1., 2., 3. dhe 4. të këtij neni.

6. Qeveria do t'ia përcaktojë procedurat transparente të qeverisjes atëherë kur ofruesi i rrjetave të komunikimeve publike dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun mund të pranojë eliminimin e prezantimit të identifikimit të linjës thirrëse në baza të përkohshme, me kërkesë të një shfrytëzuesi për gjurmimin e thirrjeve bezdisëse, apo qëllimkeqe. Në këtë rast, në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi, të dhënat që përmbajnë identifikimin e shfrytëzuesit (parapaguesit) thirrës do të ruhen dhe do të vihen në dispozicion nga ofruesi i rrjetit të komunikimit publik dhe/ose shërbimit të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun.

7. Ofruesit e rrjetave të komunikimeve publike dhe shërbimeve të disponueshme të komunikimeve elektronike nuk do të imponojnë eliminimin e identifikimit të linjës thirrëse në lidhje me linjat specifike të operuara nga institucionet që përballen me thirrje emergjente, siç janë policia, shërbimet e ambulancës, zjarrfikësit dhe shërbimet tjera të emergjencës për qëllimin e përgjigjes së këtyre thirrjeve nga parapaguesit, ose shfrytëzuesit aktual të shërbimeve të komunikimeve elektronike. Kushtet dhe procedurat e detajuara për implementimin e dispozitave të këtij paragrafi mund të caktohen në përputhje me procedurën dhe kushtet e paraqitura në paragrafin 6. të nenit 66 të këtij ligji.

Neni 89

Të dhënat për vendndodhjen të ndryshme nga të dhënat për trafikun

1. Kur të dhënat për vendndodhjen të ndryshme nga të dhënat për trafikun dhe që kanë të bëjnë me shfrytëzuesit, apo parapaguesit e rrjetave dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike publike mund të procesohen; të dhënat e tilla mund të procesohen vetëm kur ato bëhen në mënyrë anonime, ose me pëlqimin e shfrytëzuesve ose parapaguesve deri në atë masë dhe për kohën e nevojshme për ofrimin e shërbimit me vlerë të shtuar.

2. Ofruesi i shërbimit duhet t'ia informojë shfrytëzuesit ose parapaguesit, para marrjes së pëlqimit të tyre, për llojin e të dhënave për lokacionin të ndryshme nga të dhënat për trafikun që do të procesohen, për qëllimet dhe kohëzgjatjen e procesimit dhe nëse të dhënat do të transmetohen te një palë e tretë për qëllimin e ofrimit të shërbimit me vlerë të shtuar.

3. Shfrytëzuesve ose parapaguesve duhet t'iu ofrohet mundësia e tërheqjes së pëlqimit të tyre për procesimin e të dhënave për vendndodhjen të ndryshme nga të dhënat për trafikun në çfarëdo kohe.

4. Aty ku pëlqimi i shfrytëzuesve, ose i parapaguesve është marrë për procesimin e të dhënave për vendndodhjen të ndryshme nga të dhënat për trafikun, shfrytëzuesi apo parapaguesi duhet të vazhdojë të ketë mundësinë, duke shfrytëzuar një mënyrë të thjeshtë dhe pa pagesë, që përkohësisht të refuzojë procesimin e të dhënave të tilla për secilën lidhje në rrjetë, ose për secilën transmetim të një komunikimi.

5. Procesimi i të dhënave për vendndodhjen të ndryshme nga të dhënat për trafikun në përputhje me paragrafët 1., 2., 3. dhe 4. të këtij neni, duhet të kufizohet për personat që veprojnë sipas autoritetit të ofruesit të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike publike apo për palën e tretë që ofron shërbime me vlerë të shtuar dhe duhet të kufizohet në atë që është e domosdoshme për qëllimet e ofrimit të shërbimit me vlerë të shtuar.

Neni 90 **Transferimi automatik i thirrjes**

Ofruesit e shërbimeve duhet të sigurojnë që cilido parapagues të ketë mundësi, duke shfrytëzuar mënyra të thjeshta dhe pa pagesë, të ndalimit të transferimit automatik të thirrjes së bërë nga pala e tretë në terminalin e shfrytëzuesit.

Neni 91 **Numëratori Telefonik i Parapaguesve**

1. Ofruesit e shërbimeve duhet të sigurojnë që parapaguesit të jenë të informuar, pa pagesë dhe para se ata të përfshihen në numëratorin telefonik, lidhur me qëllimin e numëratorit të shtypur, ose atij elektronik të parapaguesve në dispozicion për publikun, ose të marra përmes shërbimeve të numëratorit, në të cilin të dhënat e tyre personale mund të përfshihen edhe për ndonjë shfrytëzim të mëtutjeshëm të mundësive, mbështetur në funksionet e kërkimit nga versionet elektronike të numëratorit.

2. Ofruesit e shërbimeve duhet të sigurojnë që parapaguesit të kenë mundësinë e përcaktimit nëse të dhënat e tyre personale janë të përfshira në numëratorin publik dhe nëse është kështu, cilat të dhëna dhe në çfarë niveli të dhënat e tilla janë relevante për qëllimin e numëratorit, siç është përcaktuar nga ofruesi i numëratorit dhe t'i verifikojë, përmirësojë, ose tërheqë të dhënat e tilla nga të cilat duhet të paguhen në baza të kostove reale nëse pagesat e tilla janë të aplikueshme.

3. Ofruesit e shërbimeve mund të kërkojnë që për çfarëdo qëllimi të një numëratori publik të ndryshëm nga kërkimi i detaleve kontaktuese të personave mbi bazat e emrave të tyre dhe, kur është e domosdoshme, një minimum të identifikuesve të tjerë, pëlqim shtesë nga parapaguesit.

Neni 92

Komunikimet e padëshiruara

1. Shfrytëzimi i sistemeve automatike të thirrjeve pa intervenim të njeriut (makinat automatike të thirrjes), makinat e faksimilit (faksi) ose posta elektronike për qëllimet e marketingut të drejtpërdrejtë, mund të lejohen vetëm për parapaguesit, të cilët më parë e kanë dhënë pëlqimin.
2. Pavarësisht nga paragrafi 1. i këtij neni, ku një person fizik ose juridik merr nga konsumatorët e vet detajet kontaktuese elektronike për postën elektronike, në kontekstin e shitjes së një produkti ose shërbimi, në përputhje me këtë ligj, personi i njëjtë fizik ose juridik mund t'i shfrytëzojë këto detaje kontaktuese elektronike për marketing të drejtpërdrejtë të produkteve ose të shërbimeve të ngjashme me kusht që konsumatorëve u është dhënë qartë mundësia që të bëjnë vërejtje, pa pagesë dhe në mënyrë të lehtë, për shfrytëzimin e tillë të detajeve kontaktuese elektronike kur ato janë mbledhur dhe në rastin e secilit mesazh, në rast se konsumatori fillimisht nuk e ka refuzuar shfrytëzimin e tillë.
3. Ofruesit e shërbimeve duhet të marrin masat e duhura dhe pa pagesë për të siguruar që komunikimet e padëshiruara me qëllim të marketingut të drejtpërdrejtë, në rastet e ndryshme me ato që u referohen paragrafëve 1. dhe 2. të këtij neni, nuk janë të lejuara pa pëlqimin e parapaguesit në fjalë ose për parapaguesit që nuk dëshirojnë t'i pranojnë këto komunikime.
4. Të gjitha praktikat e dërgimit të postës elektronike për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë, fshehja ose zhdukja e identitetit të dërguesit, ose në emër të të cilit është bërë komunikimi, ose pa një adresë valide në të cilën pranuesi mund ta dërgojë kërkesën për ndërprerjen e komunikimeve të tilla janë të ndaluara.

Neni 93

Karakteristikat teknike dhe standardizimi

Asnjë kërkesë obliguese për karakteristika të veçanta teknike nuk mund të imponohet në терминалет, ose në një pajisje tjetër të komunikimit elektronik që mund të pengojë vendosjen e pajisjes në treg dhe qarkullimin e lirë të pajisjes së tillë brenda dhe jashtë Kosovës.

KREU XV

RADIO-PAJISJET DHE PAJISJET TERMINALE TELEKOMUNIKUESE, KOMPATIBILITETI ELEKTROMAGNETIK

Neni 94

Radio-pajisjet dhe pajisjet terminale telekomunikuese

Kushtet dhe kërkesat themelore për lidhje të radio-pajisjeve dhe pajisjeve terminale telekomunikuese, obligimet që kanë të bëjnë me informatat për specifikat e ndërfaqeve dhe lidhjen me radio-pajisjet dhe pajisjet terminale telekomunikuese, procedurat dhe kushtet për dalje në treg, shitje dhe përdorim të këtyre pajisjeve, procedurat dhe kushtet për testim të

konformitetit, aprovimi dhe monitorimi, si dhe kërkesat përgjegjëse duhet të përshkruhen në Rregulloren Teknike për radio-pajisjet dhe pajisjet terminale telekomunikuese, të aprovuar nga Autoriteti.

Neni 95 **Kompatibiliteti elektromagnetik**

Kushtet për aplikim të kërkesave për kompatibilitet elektromagnetik, procedurat dhe kushtet për prezencën e tyre në treg dhe shfrytëzim të mjeteve dhe pajisjeve, kërkesat specifike për këto mjete dhe pajisje, kërkesat për instalim dhe shfrytëzim, procedurat dhe kushtet për testim, aprovim dhe monitorim të pajtueshmërisë me kompatibilitet elektromagnetik duhet të përshkruhen në Rregulloren teknike për kompatibilitet elektromagnetik të aprovuar nga Autoriteti, në përputhje me legjislacionin evropian.

Neni 96 **Shfrytëzimi i mjeteve dhe pajisjeve**

1. Rregullat për shfrytëzim të pajisjeve dhe mjeteve industriale, mjekësore dhe shkencore d.m.th. pajisjet dhe mjetet, operimi i të cilave gjeneron dhe konsumon energji elektromagnetike dhe të parapara për qëllime industriale, mjekësore, shkencore, vendore dhe të ngjashme, përveç përdorimit të tyre për komunikime elektronike, duhet të përgatiten dhe të aprovohen nga Autoriteti.

2. Pronari dhe/ose shfrytëzuesi i këtyre mjeteve dhe pajisjeve duhet të lejojë zyrtarët e Autoritetit të inspektojnë mjetet dhe/ose pajisjet, apo edhe t'i marrin ato.

Neni 97 **Radio Monitorimi**

1. Autoriteti do ta bëjë kontrollimin e pajtueshmërisë me aktet ligjore që rregullojnë radio komunikimet dhe do ta bëjë radio-monitorimin. Gjatë procesit të radio monitorimit duhet të bëhen edhe kontrollat dhe analizat për të përcaktuar se në çfarë mase shfrytëzohen brezet frekuencore nga radiacioni i radiostacioneve, nëse spektri i radiacionit dhe nivelet e radio-pengesave janë konform kërkesave të akteve ligjore.

2. Mbrojtja e radiostacioneve monitoruese fikse dhe mobile nga Autoriteti, prej fushave të fuqishme elektromagnetike të gjeneruara nga radio-transmetuesit duhet të zbatohet në përputhje me procedurat dhe kushtet e përcaktuara nga Autoriteti.

3. Informatat e marra gjatë procesit të radio-monitorimit mund të shfrytëzohen vetëm për aktivitetet e Autoritetit që rregullohen nga ky ligj.

4. Autoriteti monitoron brezin frekuencor në bazë të Planit Nacional Frekuencor në mënyrë që të:

- 4.1. monitorojë se shfrytëzimi i frekuencave të ndara nëpërmjet Autorizimit bëhet në pajtim me kornizën legjislative në fuqi, për implementim të kushteve nga Autorizimi;
 - 4.2. sigurohet që brezi frekuencor shfrytëzohet vetëm nga shfrytëzuesit e autorizuar në bazë të dispozitave të këtij ligji;
 - 4.3. krijohë ambient të përshtatshëm dhe pa interferenca që janë shkatërruese për punën e sistemeve dhe stacioneve radio-transmetuese, të cilët shfrytëzohen për qëllime publike, apo private.
5. Monitorimi i frekuencave duhet të bëhet në pajtim me rregulloren përkatëse të hartuar nga Autoriteti.
6. Monitorimi i frekuencave mund të bëhet me kërkesë të subjektit që posedon Autorizim të lëshuar nga Autoriteti.

Neni 98 **Eliminimi i Radio-Interferencave**

1. Të gjitha interferencat duhet të eliminohen nga pronari, ose shfrytëzuesi i pajisjeve dhe/ose mjeteve që shkaktojnë interferencat. Nëse interferenca gjenerohet në radiomarrës, apo pajisjen marrëse për shkak të ndryshimeve (keqësimeve) në parametrat teknik, apo përdorimit të papërshtatshëm, resursi i interferencave të tilla (radio-pengesave), duhet të eliminohet nga pronari, apo shfrytëzuesi i marrësit, apo pajisjes marrëse. Nëse radio-interferenca shkaktohet në pajisjet dhe/ose mjetet tjera që operojnë legalisht, pronari apo shfrytëzuesi i pajisjeve dhe/ose mjeteve që e shkaktojnë atë duhet që pas instruksioneve nga Autoriteti të eliminojë shkaktarin e interferencave (radio-pengesave), ose ta reduktojë nivelin e tyre. Procedura për eliminim apo zvogëlim të radio-interferencave, me ç'rast parametrat radioaktivë të pajisjeve që e shkaktojnë dhe e pranojnë atë janë konform kërkesave të vendosura në aktet juridike, duhet të përcaktohet nga Autoriteti.
2. Gjatë procesit të radio-monitorimit dhe hetimit për radio-interferenca, ofruesit e rrjetave dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, si dhe personat tjerë duhet të informojnë Autoritetin me informata relevante dhe të sigurojnë qasje të pakufizuar të shkaktarët e mundshëm të radio-interferencave.

KREU XVI **MBIKËQYRJA E PAJTUESHMËRISË ME KËTË LIGJ**

Neni 99 **Procedura për mbikëqyrje të pajtueshmërisë**

1. Kur Autoriteti gjen që një ndërmarrës nuk vepron në pajtueshmëri me aktet juridike të cilat specifikojnë termat dhe kushtet për përfshirje në aktivitete të komunikimeve elektronike, apo me termat dhe kushtet për shfrytëzim të resurseve të komunikimeve

elektronike, ose dështon që të plotësojë një apo më shumë obligime të caktuara, atij, si një ndërmarrës me fuqi të ndjeshme tregu në ndonjërin prej tregjeve relevante, ose si ndërmarrës i caktuar që të ofrojë shërbime universale, Autoriteti duhet që ta njoftojë ndërmarrësin për këto të gjetura dhe t'ia japë një mundësi për arsyetim, ose për rregullim të çfarëdo parregullsie brenda afatit:

1.1. një (1) muaj, pas dërgimit të njoftimit;

1.2. më të shkurtë kohor, nëse ndërmarrësi pajtohet, apo Autoriteti e përcakton në rast të parregullsive të përsëritura;

1.3. më të gjatë kohor, nëse Autoriteti vendos ashtu.

2. Nëse ndërmarrësi në fjalë nuk i rregullon parregullsitë brenda afatit kohor të përshkruar në paragrafin 1. të këtij neni, Autoriteti duhet të ndërmarrë masa proporcionale me qëllim të sigurimit të pajtueshmërisë, përfshirë këtu edhe sanksionet ekonomike të specifikuara në nenin 101 të këtij ligji. Autoriteti duhet ta njoftojë ndërmarrësin për masat dhe arsyet e ndërmarrjes së masave brenda afatit shtatë (7) ditor nga data e adoptimit të tyre dhe duhet ta përcaktojë një afat kohor të arsyeshëm që ndërmarrësi të veprojë në pajtueshmëri me masat e ndërmarra.

3. Autoriteti ka të drejtë të ndërmarrë masa në formë të sanksioneve ekonomike nëse ndërmarrësi dështon që të ofrojë informata në pajtim me nenin 34 të këtij ligji, ose dështon të ofrojë informata që i referohen nën-paragrafit 5.1 dhe 5.2 të paragrafit 5 të nenit 18 të këtij ligji, përfshirë këtu edhe pengesat e shkaktuara për qasje në informata, siç përshkruhet në nenin 100 të këtij ligji dhe/ose dështon t'i plotësojë kërkesat në bazë të nenit 100 të këtij ligji dhe pa u mbështetur në procedurën e përcaktuar në paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni.

4. Në rastet e shkeljeve serioze dhe të përsëritura të akteve juridike, të cilat specifikojnë termat dhe kushtet për përfshirje në aktivitete të komunikimeve elektronike, apo me termat dhe kushtet për shfrytëzim të resurseve të komunikimeve elektronike, ose dështon që të plotësojë një apo më shumë obligime të caktuara atij, si një ndërmarrës me fuqi të ndjeshme tregu në ndonjërin prej tregjeve relevante, ose si ndërmarrës i caktuar që të ofrojë shërbime universale dhe kur masat e ndërmarra në bazë të paragrafit 2. të këtij neni nuk kanë qenë të mjaftueshme që të rregullojnë shkeljet, Autoriteti e ka të drejtën të ndalojë ndërmarrësin të vazhdojë të ofrojë rrjeta dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike për një përudhë deri në tre (3) vjet, ose të suspendojë të drejtën për shfrytëzim të resurseve të komunikimeve elektronike deri në tre (3) vjet, ose ta tërheqë këtë të drejtë tërësisht.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1., 2. dhe 4. të këtij neni, kur Autoriteti ka dëshmi që një ndërmarrës shkel aktet juridike të cilat specifikojnë termat dhe kushtet për përfshirje në aktivitete të komunikimeve elektronike, apo me termat dhe kushtet për shfrytëzim të resurseve të komunikimeve elektronike, ose dështon që të plotësojë një apo më shumë obligime të caktuara atij, si një ndërmarrës me fuqi të ndjeshme tregu në ndonjërin prej tregjeve relevante, ose ndërmarrës i caktuar që të ofrojë shërbime universale të cilat paraqesin kërcënim urgjent dhe serioz për rendin publik, sigurinë publike ose shëndetin publik ose mund të krijojë probleme serioze ekonomike dhe operationale për ofruesit ose shfrytëzuesit e tjerë të rrjetave dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, Autoriteti ka të drejtë të ndërmarrë masa urgjente të përkohshme, përfshirë këtu bllokimin e përkohshëm të objekteve që janë shfrytëzuar si mjet, apo si objekt direkt për shkelje të këtij

ligji dhe/ose të ndërmarrë masa për ndalim të përkohshëm për të zhvilluar aktivitete ose shfrytëzuar resurset e komunikimeve elektronike. Kur masat e tilla ndërmerren, Autoriteti duhet t'i japë ndërmarrësit një mundësi për arsyetim, ose mundësi për të propozuar masa rregulluese.

6. Dispozitat e këtij kreu vlejnë për ndërmarrësit për aq sa ata janë të përfshirë në aktivitete të komunikimeve elektronike. Kur dispozitat e këtij Kreu, përveç këtij paragrafi dhe nenit 18 të këtij ligji, nuk aplikohen për suspendim, apo tërheqje dhe/ose të së drejtës për të shfrytëzuar resurset e komunikimeve elektronike për shkak të shkeljeve të akteve juridike, të drejtat për të shfrytëzuar resurset e komunikimeve elektronike duhet të suspendohen apo tërhiqen në bazë të rasteve, procedurave dhe kushteve të përshkruara në Ligjin për Konfliktet Administrative dhe rregullat për ndarje dhe shfrytëzim të resurseve të komunikimeve elektronike.

Neni 100 **Zyrtarët e Autoritetit**

1. Zyrtarët e autorizuar nga Autoriteti, pas prezantimit të dokumentit të lëshuar nga Autoriteti, që vërteton autorizimet dhe funksionet e tyre dhe me qëllim të mbikëqyrjes së pajtueshmërisë me këtë ligj, kanë të drejtë që në emër të Autoritetit të:

1.1. marrin informatat e domosdoshme në pajtim me procedurat dhe kushtet e përcaktuara me këtë ligj, me ligjet dhe me aktet tjera juridike;

1.2. pas prezantimit të lejes nga gjykata, të kenë qasje në dhe të inspektojnë lokalet, zonat dhe automjetet që shfrytëzohen nga ndërmarrësi, të shikojnë dhe analizojnë dokumentet e tij, të cilat janë të domosdoshme për hetim, të marrin kopjet e ekstrakteve të dokumenteve të tilla dhe të kenë qasje në informata të ruajtura në kompjuterët dhe në media tjera magnetike;

1.3. të marrin shpjegime të shkruara dhe me gojë nga personat që kanë lidhje me aktivitetet e ndërmarrësit që është nën hetim, të kërkojnë që sqarimet të jepen në zyrën e zyrtarit të autorizuar që e bën hetimin;

1.4. të marrin nga ndërmarrësit tjerë çfarëdo të dhëna dhe dokumente për aktivitetet ekonomike të ndërmarrësit nën hetime, pavarësisht subordinimit të ndërmarrësit tjetër, ose kopjet e dokumenteve; të marrin dokumente ose kopje të tilla nga personat, institucionet shtetërore dhe ato komunale;

1.5. të inspektojnë (auditojnë) veprimtarinë ekonomike të një ndërmarrësi, të marrin opinione nga trupat profesionale bazuar në materialin që inspektohet, të bëjnë rishikimin detal të sistemeve kontabël të kostove dhe/ose të të hyrave të ndërmarrësit;

1.6. të konfiskojnë për një përudhë kohore prej gjashtëdhjetë (60) ditësh dokumentet dhe objekte të domosdoshme për t'u shfrytëzuar si dëshmi gjatë hetimit të një shkeljeje, duke lënë vendim të arsyetuar për konfiskim dhe listën e dokumenteve dhe/ose të objekteve të konfiskuara; të kërkojë që të bëhen kopje dokumentet e tilla;

- 1.7. të shfrytëzojnë për hetime shërbimet e specialistëve dhe të ekspertëve;
 - 1.8. të shfrytëzojnë metodat teknike gjatë hetimit në pajtim me procedurat e përcaktuara me ligj;
 - 1.9. të bëjnë inspektim në vend të ngjarjes të pajisjeve dhe/ose mjeteve;
 - 1.10. të ushtrojnë të drejta të tjera të garantuara me këtë ligj dhe me ligjet tjera.
2. Gjatë ushtrimit të funksioneve të veta, zyrtarët e autorizuar nga Autoriteti mund t'i shfrytëzojnë shërbimet e nëpunësve të policisë.
 3. Gjatë ushtrimit të të drejtave dhënë atyre, zyrtarët e autorizuar të Autoritetit duhet të shkruajnë dokumente (deklarata, protokolle, kërkesa etj.). Forma e këtyre dokumenteve dhe kërkesat për skedim të tyre duhet të specifikohen nga Autoriteti.
 4. Instruksionet e zyrtarëve të autorizuar nga Autoriteti të dhëna gjatë kryerjes së veprimtarisë së tyre sipas këtij neni janë të obligueshme për të gjithë personat dhe ndërmarrësit, si dhe për menaxhmentin dhe zyrtarët e tyre administrativë, të cilët njëkohësisht duhet të jenë plotësisht kooperativë me zyrtarët e autorizuar. Sanksionet e vendosura për dështime në bazë të këtij dhe ligjeve tjera duhet të jenë në pajtim me instruksionet e dhëna.
 5. Ndërmarrësit kanë të drejtë të apelojnë tek Bordi i Autoritetit kundër veprimeve ilegale të zyrtarëve të tij. Apelimi duhet të bëhet në afat prej dhjetë (10) ditësh nga dita e ndërmarrjes së veprimit ilegal kundër të cilit apelohej. Bordi i Autoritetit duhet të marrë vendim për apelin e bërë brenda afatit prej dhjetë (10) ditësh nga dita e pranimit të apelit. Nëse personi në fjalë nuk pajtohet me vendimin e Bordit, ose Bordi dështon të marrë vendim brenda afatit dhjetë (10) ditësh, personi në fjalë ka të drejtë të apelojë në gjykatë. Skedimi apelit nuk i ndalon veprimet e zyrtarëve.
 6. Kërkesa për leje për të ndërmarrë veprime sipas nën-paragrafit 1.2 të paragrafit 1. të këtij neni, duhet të skedohet në gjykatë. Në disa raste urgjente, disa veprime mund të ndërmerren mbështetur në vendimin e Kryesuesit të Bordit. Në këtë rast, kërkesa për leje për ndërmarrje të veprimeve duhet të skedohet në gjykatë në pajtim me procedurën e lartpërmendur brenda afatit njëzet e katër (24) orësh pas marrjes së vendimit nga Kryesuesi. Nëse gjykata (gjykatësi) refuzon të japë leje, veprimet duhet të ndërpriten dhe çfarëdo informate e marrë gjatë kësaj kohe duhet të shkatërrohet menjëherë.
 7. Dëmi që i shkaktohet ndërmarrësit nga veprimet ilegale të institucioneve që rregullojnë veprimtarinë e komunikimeve elektronike, apo nga zyrtarët e tyre duhet të kompensohet në pajtim me procedurat e bazuara në ligj.

Neni 101 **Sanksionet ekonomike**

1. Në rastet kur ndërmarrësit dështojnë të jenë në pajtim me aktet juridike, të cilat specifikojnë termat dhe kushtet për përfshirje në aktivitete të komunikimeve elektronike

apo me termat dhe kushtet për shfrytëzim të resurseve të komunikimeve elektronike, përfshirë këtu të drejtat e shfrytëzuesve dhe konsumatorëve, ose dështojnë që të plotësojnë një apo më shumë obligime të caktuara si ndërmarrës me fuqi të ndjeshme tregu në ndonjërin prej tregjeve relevante, ose si ndërmarrës të caktuar që të ofrojnë shërbime universale, ose dështojnë të punojnë në bazë të vendimeve të lëshuara nga Autoriteti për zgjidhje të mosmarrëveshjeve, ose dështojnë që të jenë në pajtim me Rregulloret Teknike të Radio-Pajisjeve dhe pajisjeve terminale telekomunikuese, apo me Rregulloren teknike për kompatibilitet elektromagnetik, Autoriteti ka të drejtë që të dënojë ndërmarrësin në vlerë deri shtatë përqind (7%) nga të hyrat vjetore nga aktivitetet që kanë të bëjnë me komunikimet elektronike, por nëse kalkulimi i një shume të tillë është i vështirë apo i pamundur- Autoriteti e dënon ndërmarrësin me një shumë prej jo më shumë se tetëdhjetë e gjashtë mijë (86,000) Euro.

2. Në rast se ndërmarrësi bën shkelje dhe i përsërit shkeljet që i referohen paragrafit 1. të këtij neni, Autoriteti ka të drejtë ta dënojë ndërmarrësin deri në dhjetë përqind (10%) nga të hyrat vjetore nga aktivitetet që kanë të bëjnë me komunikimet elektronike, por nëse kalkulimi i një shume të tillë është i vështirë apo i pamundur- Autoriteti e dënon ndërmarrësin me një shumë prej jo më shumë se njëqind e pesdhjetë mijë (150,000) Euro.

3. Kur të ardhurat vjetore të ndërmarrësve që iu referohen paragrafëve 1. dhe 2. të këtij neni janë më të vogla se tetëdhjetë e pesë mijë (85,000) Euro, dënimi i shqiptuar duhet të jetë deri në tremijë (3,000) Euro dhe në rastet e shkeljeve të përsëritura dënimi i shqiptuar mund të jetë deri në dhjetë mijë (10,000) Euro.

4. Nëse ndërmarrësi dështon që t'i zbatojë obligimet e vendosura nga ana e Autoritetit për ndërprerje të aktivitetit ilegal, nuk paraqet informatat në pajtim me procedurën dhe kushtet në bazë të këtij ligji (dhënia e informatave të pasakta konsiderohet, gjithashtu si dështim i dhënies së informatave), pengon zyrtarët e autorizuar nga Autoriteti për të zbatuar detyrat e veta apo nuk iu përgjigjet kërkesave të Autoritetit, përfshirë këtu të gjitha masat e ndërmarra përkohësisht, Autoriteti ka të drejtë të shqiptojë dënim deri në pesëmbdhjetë mijë (15,000) Euro dhe në rastet e përsëritjes së shkeljeve – dënimi mund të jetë njëmijë e pesëqind (1,500) Euro për secilën shkelje të përsëritur.

5. Përveç sanksioneve ekonomike të paraqitura në paragrafët 1. deri 4. të këtij neni dhe në paragrafin 4. të nenit 103 të këtij ligji, Autoriteti mund të urdhërojë konfiskimin e objekteve që janë shfrytëzuar si mjet apo kanë qenë mjet i shkeljeve direkte të dispozitave të këtij ligji dhe/ose urdhërojë të bëhen pagesa për dëmet e shkaktuara nga aktivitetet ilegale.

6. Kur ndonjë ndërmarrës vepron si grup personash, anëtarët e grupit që bëjnë shkelje, të cilët veprojnë si njësi të veçanta ekonomike merren parasysh si shkelës.

Neni 102

Shqiptimi i sanksioneve ekonomike dhe përcaktimi i lartësisë së tyre

1. Sanksionet ekonomike ndërmarrësve iu shqiptohen nga Autoriteti. Autoriteti duhet ta aprovojë rregulloren për procedurat e vendosjes së sanksioneve ekonomike.

2. Procedura për vendosjen e sanksioneve ekonomike sipas paragrafëve 2., 3. ose 4. të nenit 101 të këtij ligji inicohet nga ndonjë zyrtar i Autoritetit. Propozimi duhet të sqarohet

rrethanat e shkeljeve të këtij ligji dhe sanksionet ekonomike të propozuara. Pas pranimit të njoftimit zyrtar nga ndonjë zyrtar i autoritetit, Kryesuesi i Bordit/ Bordi, apo ndonjë person i autorizuar nga Bordi duhet të mbajë takim për vendosjen e sanksioneve ekonomike. Ndërmarrësi që është subjekt i sanksioneve të mundshme ekonomike duhet të informohet për takimin. Ndërmarrësi duhet të paraqesë dëshmi mbështetëse për të faktuar se nuk ekziston bazë për shkelje të këtij ligji, si dhe fakte për rrethana lehtësuese ose çfarëdo fakti tjetër relevant për të mbështetur sanksionet ekonomike adekuate, para mbajtjes së takimit.

3. Në takimin që mbahet për vendosjen e çfarëdo sanksioni ekonomik mund të marrin pjesë dhe ka të drejtë të prezantojë sqarime, ndërmarrësi ndaj të cilit shqiptohen sanksionet ekonomike, ndërmarrësit dhe palët tjera të interesuara, si dhe personat pjesëmarrja e të cilëve kërkohet në mënyrë që rasti të përpunohet në mënyrë adekuate dhe sanksionet ekonomike të shqiptohen (dëshmitarët, ekspertët, specialistët ose personat tjerë). Dështimi për të marrë pjesë në takim i ndërmarrësit ndaj të cilit shqiptohen sanksionet, ose i personave dhe ndërmarrësve tjerë nuk mund të parandalojë mbajtjen e takimit. Takimi duhet të jetë publik, përveç në rastet kur Autoriteti vendos që të ekzaminojë rastin në takim të mbyllur me qëllim të garantimit të sigurisë shtetërore, sekreteve biznesore, ose komerciale, ose për të siguruar privatësinë e personave.

4. Takimi duhet të fillojë me raportim të zyrtarit të Autoritetit që ka bërë propozimin. Përfaqësuesit e ndërmarrësve dhe personat pjesëmarrës të takimit mund t'i prezantojnë sqarimet e veta. Pjesëmarrësit tjerë të takimit mund të bëjnë pyetje cilitdo person që e ka përpiluar raportin, ose që ka ofruar ndonjë sqarim.

5. Procesverbalët duhet të mbahen dhe të shpërndahen jo më vonë se pesë (5) ditë nga dita e mbajtjes së takimit. Procesverbalët duhet të nënshkruhen nga Kryesuesi i Bordit, apo nga ndonjë person i autorizuar nga ai dhe nga procesmbajtësja e takimit.

6. Ndërmarrësi ndaj të cilit vendosen, ose janë vendosur sanksionet ekonomike, si dhe personat dhe ndërmarrësit tjerë të interesuar kanë të drejtë që të kenë qasje në materialet e mbledhura nga Autoriteti, përveç materialeve që janë sekret shtetëror, komercial, biznesor dhe në ato materiale zbulimi i të cilave do të shkelte privatësinë e personave fizikë. Ndërmarrësit, ndaj të cilit vendosen sanksionet ekonomike, duhet gjithmonë t'i sigurohet qasja në tekstin e propozimit të përpiluar nga zyrtari i Autoritetit dhe në minutat e takimit për vendosjen e sanksioneve ekonomike.

7. Pas takimit për shqiptimin e sanksioneve ekonomike Bordi i Autoritetit, ose ndonjë person i autorizuar nga Bordi duhet të marrë vendimin përfundimtar. Ndaj vendimit për shqiptimin e ndonjë sanksioni ekonomik pala ka të drejtë apeli në Gjykatën Kompetente në pajtim me procedurën dhe kushtet e vendosura në legjislacionin në fuqi.

8. Bordi i Autoritetit, ose ndonjë person i autorizuar nga Bordi, kanë të drejtë, në çfarëdo momenti gjatë zhvillimit të procedurës për vendosjen e sanksioneve ekonomike, të kërkojnë plotësimin e dokumenteve të mbledhura. Pas plotësimit të dokumenteve nga zyrtarët e Autoritetit, propozimi i plotësuar me këto materiale duhet të krijojë bazë për fillim të procedurës së re që nga fillimi.

9. Gjatë shqiptimit të sanksioneve ekonomike ndaj ndërmarrësve duhet të kihet parasysh:

9.1. niveli i dëmit i shkaktuar nga shkelja;

9.2. kohëzgjatja e shkeljes;

9.3. rrethanat lehtësuese, ose rënduese për përgjegjësinë e ndërmarrësit;

9.4. sasinë e të ardhurave që ndërmarrësi ka marrë si rezultat i shkeljes;

9.5. kur shkelja është bërë nga disa ndërmarrës, pjesa e shkeljes e bërë nga secili ndërmarrës.

10. Në rrethana lehtësuese duhet të përfshihen veprimet e ndërmarrësve në fjalë, të ndërmarra me vetiniciativë për t'i parandaluar pasojat e dëmshme të shkeljeve, si dhe ndihma e ndërmarrësve dhënë Autoritetit gjatë hetimit të shkeljeve, kompensimi i humbjeve, ose eliminimi i dëmeve të shkaktuara.

11. Në rrethana rënduese duhet të përfshihen veprimet e ndërmarrësve në fjalë që janë bërë për ta penguar procedurën hetimore, fshehur shkeljen, vazhduar me shkelje edhe pse Autoriteti ua ka bërë me dije se duhet t'i ndërpresin veprimet ilegale, si dhe për rastet e shkeljeve të përsëritura, për të cilat është vendosur shqiptimi i sanksioneve ekonomike në bazë të këtij ligji.

12. Gjatë përcaktimit të nivelit të sanksionit ekonomik, Autoriteti mund të marrë parasysh edhe rrethana tjera si rrethana lehtësuese.

Neni 103

Zbatimi i sanksioneve ekonomike

1. Ndërmarrësi duhet ta zbatojë sanksionin ekonomik të shqiptuar nga Autoriteti, duke bërë pagesën e dënimit në llogarinë e Autoritetit në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 86 të këtij ligji dhe/ose duke bërë transferin gratis të objekteve të konfiskuara jo më vonë se tre (3) muaj nga data e pranimit të vendimit.

2. Me kërkesë të arsyetuar të ndërmarrësit, Autoriteti mund ta shtyjë afatin e pagesës së dënimit, apo një pjesë të dënimit deri në gjashtë (6) muaj.

3. Vendimi i Autoritetit për sanksion ekonomik është dokument ekzekutiv. Kur vendimi nuk zbatohet, procedura për ekzekutim të këtij vendimi bëhet në bazë të legjislacionit për Procedurë Penale në fuqi. Vendimi mund të dërgohet për ekzekutim jo më vonë se tre (3) muaj nga data e lëshimit të tij.

4. Çfarëdo konfiskimi i objekteve duhet të bëhet në pajtim me procedurat e përshkruara në legjislacionin përkatës.

5. Autoriteti ka të drejtë të përcaktojë termat dhe kushtet për kompensim të dëmit të shkaktuar nga veprimet ilegale të ndërmarrësit.

6. Kur merret vendimi për sanksionim të ndërmarrësit, i cili vepron si grup i shoqëruar ndërmarrësish, të gjithë anëtarët e grupit bashkërisht duhet ta mbajnë përgjegjësinë për

zbatim adekuat të sanksionit ekonomik, duke marrë parasysh dispozitat e paragrafit 6 të nenit 101 të këtij ligji.

KREU XVII

MBIKËQYRJA DHE MONITORIMI I TRAFIKUT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

Neni 104

Mbikëqyrja dhe Monitorimi

1. Ndërmarrësit që ofrojnë rrjeta dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike kanë të drejtë të regjistrojnë dhe ruajnë të dhënat teknike të komunikimeve elektronike dhe të pjesëmarrësve në komunikime vetëm për aq sa është e domosdoshme që të sigurohet veprimtaria ekonomike e ndërmarrësve në fjalë. Ndërmarrësit që ofrojnë rrjeta dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike duhet t'iu ofrojnë dhe në pajtueshmëri me procedurat ligjore të institucioneve kryesore që kryejnë shërbime hetimore operacionale dhe institucioneve tjera që kryejnë hetime para procesit gjyqësor, prokurorëve, gjykatave, ose gjykatësve informatat që i posedojnë dhe të cilat janë të domosdoshme për të parandaluar, hetuar ose zbuluar veprimet kriminale. Informatat e tilla duhet të ofrohen menjëherë dhe pa pagesë nga ndërmarrësit që ofrojnë rrjeta dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike tek institucionet kryesore që kryejnë shërbime hetimore operacionale dhe institucioneve tjera që kryejnë hetime para procesit gjyqësor të caktuara nga Qeveria, në formë elektronike si përgjigje ndaj kërkesës së tyre. Institucionet hetimore që bëjnë hetime para procesit gjyqësor të caktuara nga Qeveria duhet që t'u ofrojnë vartësve të tyre dhe/ose institucioneve tjera që kryejnë hetime para procesit gjyqësor qasje në informata të tilla në pajtim me procedurat të përcaktuara nga Qeveria. Të gjithë personat që marrin pjesë në shkëmbim të informatave duhet të ndërmarrin hapa të domosdoshëm për të garantuar sigurinë e të dhënave në pajtim me procedurat dhe kushtet të vendosura nga Qeveria; pajisjet shtesë të domosdoshme për këtë qëllim duhet të sigurohen dhe mirëmbahen nga fondet e Qeverisë. Nëse informata e ofruar nga ndërmarrësit që ofrojnë rrjeta dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike nevojitet që të konfirmohet për qëllime hetimi para procesit gjyqësor, zyrtari hetues para procesit gjyqësor duhet që kërkesën ta adresojë në mënyrë direkte me shkrim ndërmarrësit dhe ndërmarrësi duhet që të përgjigjet, gjithashtu me shkrim.

2. Ndërmarrësit që ofrojnë rrjeta dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike duhet të ruajnë informatat teknike që janë shfrytëzuar gjatë transmetimit të trafikut të komunikimeve elektronike vetëm për një periudhë kohore e cila është e domosdoshme për të siguruar veprimtarinë ekonomike të ndërmarrësve, por jo më gjatë se gjashtë muaj, përveç rasteve që i referohen në nenin 68 të këtij ligji; kur informatat e tilla janë të domosdoshme për qëllime hetimi, iu nevojiten institucioneve që bëjnë hetime para procesit gjyqësor, prokurorëve, gjykatave, ose gjykatësve për të parandaluar, hetuar dhe zbuluar aktivitetet kriminale, ndërmarrësit që ofrojnë rrjeta dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike pas instruksioneve të marra nga ndonjë institucion (institucione që kryejnë shërbime hetimi) i autorizuar nga Qeveria duhet të ruajnë ato informata për një periudhë më të gjatë kohore, por jo më gjatë se gjashtë (6) muaj të tjerë. Ruajtja e tillë e informatave

duhet të paguhet nga fondet shtetërore në përputhje me procedurat e vendosura nga Qeveria.

3. Kur ekziston vendim i arsyetuar nga gjykata, ndërmarrësit që ofrojnë rrjeta dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike duhet t'iu ofrojnë në pajtueshmëri me procedurat ligjore organeve hetimore dhe në pajtueshmëri me procedurat e bazuara në legjislacionin për Procedurë Penale në fuqi organeve që kryejnë hetime para procesit gjyqësor, mundësi teknike për të bërë kontroll në përmbajtjen e informatave të transmetuara nëpërmjet rrjetave të komunikimeve elektronike. Pajisjet e domosdoshme për këtë qëllim duhet të sigurohen dhe mirëmbahen nga fondet e buxhetit të Kosovës.

4. Institucioni i autorizuar qeveritar (organ hetimor) duhet të organizojë dhe ofrojë, në pajtueshmëri me procedurat e vendosura nga Qeveria, të gjitha organeve tjera hetimore dhe në rastet e ndjekjeve penale, të gjitha organeve që bëjnë hetime para procesit gjyqësor, me mundësitë teknike që të bëjnë kontroll të pavarur të përmbajtjes që është transmetuar nëpërmjet rrjetave të komunikimeve elektronike.

5. Ndërmarrësit që ofrojnë rrjeta dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike duhet të informojnë organin e autorizuar qeveritar (organ hetimor) dhe Autoritetin për çfarëdo ndryshimi që do të ndërmarrin në rrjetat e veta, apo në pikat e ndërlidhjes me operatorët tjerë të komunikimeve elektronike që mund të ndikojë në operimin e pajisjes që iu referohet paragrafëve 1. dhe/ose 3. të këtij neni, si dhe volumin e prezantuar të informatës sa më shpejt që është e mundur pas dëgjimit për të.

6. Komandat teknike të dërguara nga një rrjetë e komunikimeve elektronike për të filluar apo ndërprerë përgjimin, apo çfarëdo kontrolli tjetër të informatave të transmetuara nëpërmjet rrjetave të komunikimeve elektronike, duhet të mbahen të sigurta në lokalet e institucionit të autorizuar qeveritar (organ hetimor) në mënyrë të tillë që do të pamundësojë komandën e dërguar të modifikohet nga institucioni i autorizuar qeveritar, i cili e ka dërguar një komandë të tillë, ose nga ndërmarrësi, i cili e ka pranuar atë. Prokurori i Përgjithshëm, ose prokurori i autorizuar nga ai duhet të bëjë kontroll për pajtueshmërinë me dispozitat e këtij paragrafi.

Neni 105

Rrethanat e jashtëzakonshme dhe rregullat speciale për sigurimin e komunikimit

1. Qeveria, apo institucioni i autorizuar nga ajo duhet ta aprovojë programin për zbatimin e masave në situata të jashtëzakonshme dhe skemën për organizim të komunikimeve në situata të jashtëzakonshme. Ndërmarrësit duhet të marrin pjesë në përgatitjen e këtyre akteve juridike dhe duhet të sigurojnë funksionimin efektiv të tyre.

2. Në rastet e forcës madhore, gjendjes ekstreme, situatës së jashtëzakonshme, ose për qëllime të përgatitjes për mobilizim të përgjithshëm apo të mbrojtjes kombëtare, ose për të siguruar mbrojtjen kombëtare dhe rendin publik, qeveria apo institucioni i autorizuar nga ajo mund, që në pajtueshmëri me procedurat ligjore dhe aktet tjera juridike, të lëshojë urdhra obligues, detyrime apo obligime ndaj ndërmarrësve që ofrojnë rrjeta dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike, si dhe ndaj pronarëve, ose shfrytëzuesve të pajisjeve dhe mjeteve për të mbrojtur dhe mirëmbajtur rrjetat e rëndësishme të

komunikimeve elektronike, si dhe të ndërlidhë ato dhe nëse është e domosdoshme, kufizojë shfrytëzimin publik të rrjetave të komunikimeve elektronike.

3. Ofruesit e rrjetave dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike duhet ndërmarrë çfarëdo mase të domosdoshme për sigurimin e funksionimit të rrjetave dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike në rast të dështimit katastrofal të rrjetës, ose forcës madhore siç janë kushtet e jashtëzakonshme klimatike, tërmetet, vërshimet, rrufeve apo zjarreve, si dhe në rastet tjera të jashtëzakonshme. Në raste të tilla, ndërmarrësit dhe institucionet relevante duhet ndërmarrë të gjitha masat e mundshme për mirëmbajtje të nivelit më të lartë të shërbimit bazuar në prioritetet e përcaktuara nga Qeveria, ose institucioni i autorizuar prej saj.

4. Ofruesit e rrjetave dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike duhet t'i japin prioritet absolut komunikimeve me shërbime emergjente dhe me institucionet që ofrojnë shërbime dhe iu përgjigjen thirrjeve emergjente, përfshirë këtu çfarëdo telekomunikimi që ka të bëjë me sigurinë e jetës në tokë, ajër ose hapësirë, por gjithashtu edhe telekomunikimeve epidemiologjike të rasteve me urgjencë ekstreme, siç janë definuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë. Shfrytëzuesit e radiostacioneve duhet të sigurojnë pranimin e sinjaleve dhe mesazheve për fatkeqësitë nga cilido resurs i sinjalit dhe duke iu dhënë atyre prioritet absolut, duke u përgjigjur në mënyrë të njëjtë dhe duke ndërmarrë veprim imediat në këtë aspekt.

5. Ofruesit e rrjetave dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike duhet dhënë prioritet në krahasim me telekomunikimet tjera, telekomunikimeve që bëhen nga krerët e shtetit, ose qeverisë, anëtarët e qeverisë, komandantët e forcave tokësore, ose ajrore, përfaqësuesit konsullor apo diplomatik të Republikës së Kosovës dhe shteteve tjera anëtare të Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikimeve, Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, udhëheqësve të organeve kryesore të Kombeve të Bashkuara dhe Tribunalit Ndërkombëtar, ose telekomunikimeve tjera deri në masën e domosdoshme për të marrë parasysh kërkesat specifike nga dërguesi i informatave relevante.

6. Autoriteti ka të drejtë të vendosë procedura dhe kushte për zbatim të obligimeve që i referohen paragrafëve 4. dhe 5. të këtij neni.

7. Është i ndaluar dërgimi, ose transmetimi i sinjaleve të rrejshme, ose mashtruese për fatkeqësitë, urgjencat, sigurinë apo identifikimin.

8. Informatat që përmbajnë në vete sekrete shtetërore dhe/ose zyrtare duhet të transmetohen nëpërmjet radio-kanaleve komunikuese të koduara.

Neni 106 **Dispozitat kalimtare**

1. Qeveria dhe Autoriteti do të miratojnë të gjithë legjislacionin sekondar që ka të bëjë me menaxhimin e frekuencave jo më vonë se gjashtë (6) muaj nga data që është theksuar në nenin 110 të këtij ligji. Qeveria, Ministria dhe Autoriteti do të miratojnë legjislacionin sekondar tjetër nga ai i përmendur në pjesën e parë të këtij paragrafi, duke zbatuar këtë ligj në periudhën prej dymbëdhjetë (12) muajve nga data që është theksuar në nenin 110 të këtij ligji.

2. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Ligji i Telekomunikacionit do të shfuqizohet ashtu siç përcaktohet në nenin 109 të këtij ligji, megjithatë ndërmarrësit që janë identifikuar nga Autoriteti, para se të hyjë ky ligj në fuqi, si ndërmarrësit me fuqi të ndjeshme tregu, duhet të vazhdojnë t'i përmbushin obligimet që i imponohen, duke përfshirë obligimet që u detyrohen ndërmarrësve me fuqi të ndjeshme tregu, brenda fushëveprimit dhe kushteve që i përcakton Ligji i Telekomunikacionit dhe aktet nënligjore të dala nga ai ligj, derisa Autoriteti, pas përfundimit të analizimit të tregut në përputhje me procedurën e përshkruar në këtë ligj, të vendosë që të revokojë dhe/ose modifikojë këto obligime.

3. Të dhënat personale që janë të përfshira në direktoriumet publike (numërorët) të përdoruesve para se ky ligj të hyjë në fuqi, mund të mbahen në këto direktorime derisa përdoruesit të paraqesin dëshirën për t'i fshirë këto të dhëna. Ofruesit e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike do të informojnë publikisht përdoruesit, të dhënat e të cilëve janë përfshirë në numërorët përkatës për të drejtat e garantuara për ta, të dala nga ky ligj.

4. Aktet nënligjore që janë miratuar para se të hyjë në fuqi ky ligj vlejnë deri në atë masë që nuk janë në kundërshtim me këtë ligj. Një dispozitë nuk do të konsiderohet kundërshtuese vetëm se zbatohet në ndërmarrësit që kanë fuqi të ndjeshme tregu të identifikuar në pajtueshmëri me procedurat e përcaktuara nga Ligji mbi Telekomunikacionin.

5. Çfarëdo mosmarrëveshje ndërmjet ndërmarrësve që duhet të zgjidhet në bazë të nenit 84 të këtij ligji dhe çfarëdo mosmarrëveshje e bazuar në ankesat e përdoruesve fundorë që duhet të zgjidhet në bazë të nenin 72 të këtij ligji, e që janë pranuar për shqyrtim para ardhjes në fuqi të këtij ligji duhet të shqyrtohet dhe apelohe në bazë të normave ligjore të vlefshme para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

6. Procedurat (siç janë analiza e tregjeve dhe ndarja e resurseve të komunikimeve elektronike, përfshirë këtu edhe tenderët dhe ankandet) që janë bazuar në Ligjin e Telekomunikacionit, si dhe aktet ligjore për zbatimin e tyre duhet të përfundohen në bazë të normave juridike të vlefshme para hyrjes në fuqi të këtij ligji. Marrja e vendimit nga Autoriteti që tregon rezultatet e procedurës duhet të konsiderohet si përfundim i procedurës; në rast se lëshohet ndonjë autorizim pas kompletimit të procedurës; lëshimi i këtij autorizimi duhet të konsiderohet si përfundim i procedurës.

7. Licencat dhe lejet për shfrytëzim të radio-frekuencave dhe numrat e dhënë para datës së specifikuar në nenin 110 të këtij ligji duhet të konsiderohen si autorizime për t'i shfrytëzuar radio-frekuencat dhe numrat në bazë të këtij ligji dhe janë të vlefshme deri në afatin e skadimit, apo deri në afatin e ripërtëritjes.

8. Kryesuesi dhe anëtarët e Bordit të emëruar para ardhjes në fuqi të këtij ligji duhet të ushtrojnë detyrat e veta deri në përfundim të mandatit të tyre, përveç rastit kur shkarkohen më herët në bazë të dispozitave të specifikuara në këtë ligj.

9. Aktet ligjore të BE-së dhe që rregullojnë subjektin e këtij ligji do të zbatohen në përputhje me dispozitat e këtij ligji (duke përfshirë edhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve përkatëse dhe vendosjen e sanksioneve), pa cenuar kushtet e akteve të tilla ligjore dhe kompetencat e institucioneve të BE-së.

10. Institucionet shtetërore që zbatojnë këtë ligj brenda kompetencave të tyre do të marrin parasysh rekomandimet përkatëse të Komisionit Evropian.

11. Autoriteti do të jetë pasardhësi ligjor i Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit dhe do t'i marrë përsipër të gjitha asetet e luajtshme (pajisjet) dhe të paluajtshme, arkivin dhe dokumentet e tjera dhe llogaritë, si dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit.

Neni 107
Përfundimi nga fusha e zbatimit

Ky ligj nuk rregullon marrëdhëniet shoqërore që kanë të bëjnë me shërbimet e kryera, duke përdorur rrjetet dhe shërbimet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, si dhe përmbajtjet që transmetohen përmes rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe shërbimet e lidhura me përmbajtje të tilla.

Neni 108
Zbatimi i ligjit

Për zbatimin e këtij ligji, Qeveria, Ministria dhe Autoriteti nxjerrin akte nënligjore të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 109
Shfuqizimi

Shfuqizohet Ligji Nr. 2002/7 mbi Telekomunikacionin i datës 12.5.2003 si dhe Ligjin nr. 03/L-085 – për ndryshimin e Ligjit për Telekomunikacionin i datës 13.06.2008.

Neni 110
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/ L-109
4 tetor 2012

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI